




Koha

www.koha.mk



Dibra, qytet
pa muze

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3206 • E premte 27 tetor 2017

15 DEN

Fushata dominohet nga imazhi i liderëve



Shkup, 26 tetor - Fushata zgjedhore për rrethin e dytë është në ditët e fundit dhe e fokusuar në takimet mes liderëve të koalicioneve - atij të LSDM-BDI dhe ASH-BESA, si dhe luftës së pa kompromis në terren. Kandidatë për kryetarë të komunave në tabarin shqiptar i shmangen debateve dhe

tubimeve të mëdha duke preferuar takime kokë më kokë me qytetarët lagje për lagje e fshat për fshat. Edhe në këto zgjedhje, ndonëse bëhet fjalë për pushtet lokal e jo atë qendror, sigla partiake dhe figura e liderit të partisë po bëhen imazhi dominues i fushatës, duke lënë në hije figurat e kandi-

datëve për kryetarë të komunave. Aq më pak nuk kemi një qartësi të Programeve zgjedhore të kandidatëve për kryetar komune, ndërkaq premtimet në shumë komuna mbeten të njëjta të përsëritura në fletushka të shtypura dhe me shpresën se pushteti qendror - tani që LSDM...

FAQE 3

Ligjin për arsim fillor i ashpër me shkollat, drejtorët dhe mësimmshënësit

Kur shkollat dënohen me mbi 26.000 euro!



Ndëshkimi me vlerë shumë të lartë në para, sipas personave të cilët merren me çështje të arsimit, është edhe arsyeja kryesore për moszbatimin e atyre predispozitave. Dhe meqë paga mujore e një mësimmshënësi, për shembull është 370 euro, Këshilli i shkollës, drejtori dhe organe tjera të shkollës shumë normal që do të japin maksimumin për të mbrojtur mësimmshënësit nga ndëshkimet

FAQE 2

S'ka përgjigje për autostradën Shkup-Bllacë!



Shkup, 26 tetor - Përpilimi i Buxhetit për vitin 2018, është nga fundi dhe janë duke u shqyrtuar detajet për precizimin e projekteve makroekonomike. Ministria e Financave, me projeksionet që parashihen më buxhetin e vitit të ardhshëm, pret rritje më të lartë ekonomike. "Lidhur me deficitin

buxhetor - qëllimi kryesor është që shteti të harxhojë më shumë para që ekonomia të del nga aktiviteti i ulët ekonomik. Me Buxhetin e vitin 2018 do të shkurohen harxhimet për projekte joproduktive që t'ju jepet përparësi projekteve produktive me efekte multiplikative që të lëvizin ekonominë e vendit", informojnë

nga Ministria e Financave. Mirëpo, as nga Ministria e Financave e as nga Ministria e Transportit, nuk morëm përgjigje në pyetjen se me Buxhetin 2018 nëse parashihen para për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, për të cilin plot 8 vite asesi të sigurohen mjete financiare. Pas miratimit...

FAQE 4

IGLOBI Indiferenca përballë gjenocidit



Javën e kaluar, një grua Rohingya u tha gazetarëve se si ushtarët e Mianmarit e kishin prerë me thikë në fytyrë, ia kishin marrë foshnjën që qante me dhunë nga krahët dhe e kishin hedhur në zjarr; ndërsa fëmija digej, ata e përdhunonin në grup. Ne nuk mendojmë se ia vlen kostoja për të bërë...

FAQE 15

RAJON Absurde lëvizja nëpër Serbi, e jo nëpër BeH

FAQE 14

RAJON Schmid ia rikujton Haradinajt demarkacionin

FAQE 14

RAJON Orët luksoze të gjykatësve shqiptarë



FAQE 14



Grupi punues i arsimit klasor në nivelin e arsimit fillor, që përfshin klasat nga viti I deri V, ka kërkuar gjithashtu largimin e lëndës së arsimit teknik nga klasa IV dhe postimin e kësaj lënde në klasë VI

Përcaktohet dinamika e reformave arsimore

Në nëntor, paketa e propozimeve të reformës në arsim

"Bazuar në disponimin e deritanishëm të MASH-it, respektivisht impenjimin institucional të kësaj ministrie, jam i sigurt se shtatori i vitit të ardhshëm do ta gjejë arsimin e reformuar", shprehet Jasin Reka, përfaqësues i arsimit fillor në grupet punuese të reformave në arsim. Ai pret që të jetë përmbyllur komplet faza e ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për arsim fillor para fillimit të vitit akademik 2018/2019



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 26 tetor - Shkarkimi i nxënësve dhe mësimdhënësve nga numri i orëve dhe lëndëve të mësimit dhe paralelisht kësaj - shkarkimi i paraleleve nga numri aktualisht i nxënësve në klasë duket se do të jenë kryefjala e reformave në arsim, veçanërisht në arsimin klasor. Problemi i sensibilizuar shpeshherë në gazetën KOHA, është artikulluar tanimë edhe zyrtarisht në grupet punuese për reforma në sistemin arsimor në kuadër të iniciativës përkatëse që ka ndërmarrë Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). "Nxënësit dhe mësimdhënësit janë ngarkuar aq shumë me lëndë dhe orë mësimore sa është bërë vërtetë e pakuptime të vazhdohet në këtë formë. Ngarkestat e nxënësve dhe mësimdhënësve, në fakt e kanë ngarkuar së tepërmi vetë procesin e realizimit të mësimin nëpër shkolla dhe ka shumë çështje problematike në këtë drejtim", thotë Jasin Reka, mësues në shkollën fillore "7 Marsi" të fshatit Çolepek.

Reka është njëri prej përfaqësuesve të arsimit fillor në grupet punuese të reformave në arsim dhe që beson fort në ndryshimet pozitive, të cilat pritet të ndodhin vitin e ardhshëm. "Bazuar në

disponimin e deritanishëm të MASH-it, respektivisht impenjimin institucional të kësaj ministrie, jam i sigurt se shtatori i vitit të ardhshëm do ta gjejë arsimin e reformuar", shprehet ai. Konkretisht, në drejtim të reformës, ai pret të jetë përmbyllur komplet faza e ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për arsim fillor para fillimit të vitit akademik 2018/2019. Në muajin nëntor, grupet e punës do të mbledhen sërish në një takim tjetër, ku sipas dinamikës së paraparë të punës, do të diskutohen dhe shqyrtohen të gjitha kërkesat dhe propozimet e mbërritura deri në këtë kohë lidhur me reformat në arsimi. Secili grup punues, veç e veç do të bëjë më pas përmbledhjen përfundimtare të ndryshimeve ligjore të cilat ia propozojnë MASH-it. Pas kësaj, fillon faza e dytë e ndryshimeve, ajo e përgatitjes së propozim-ligjit për ndryshimet ligjore, të cilat mund të jenë ose në formën e përpilimi të një Ligji komplet të ri, ose të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit aktual. Kjo do të varet nga koncepti i reformave të cilat duhet ti menaxhojë vetë institucioni i

MASH-it në bashkëveprim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit, Qendrën për Arsim të Mesëm Profesional dhe Inspektoratin Shtetëror të Arsimit. Në ndërkohë, deri në përfundim e plotë të fazës së parë, e cila po zhvillohet aktualisht me propozime, vërejtje dhe sugjerime për reformën mund të dalin edhe organizata dhe shoqata të ndryshme arsimore, shkolla, mësimdhënës, ekspertë, prindër dhe çdonjëri që konsideron se mund të jep kontributin individual për përmirësimin e legjislatives arsimore në Maqedoni. Në dispozicion të kësaj, Qeveria ka hapur një link të posaçëm "enter.gov.mk", ku të interesuarit mund të japin propozimet e tyre. Deri tani, nga grupi punues i reformave në arsimin fillor, grupi klasor janë artikulluar ndryshime të klasifikuar në tetë kapituj. Kapitulli i parë ka të bëjë me çështjen e orës së bashkësisë të klasave, apo me orën e kujdestarisë siç njihet ndryshe. Kërkohej që kjo orë të integrohet në ndonjë orë tjetër mësimore, pasi edhe ashtu trajton tema shoqërore të cilat mund të elaborohen në lëndët e karakterit shoqëror. Me këtë, nxënësit

do të kenë një orë mësimi më pak. Kapitulli i dytë, ai i ditëve të mësimit brenda një viti, mes tjerash kërkon që të mos tejkalohet për asnjë arsye masa e 180 ditëve ditë mësimi në vit, përdërisa në kapitullin e tretë parashihet formimi i paraleleve nga 20 deri 25 nxënës, për dalim prej limiteve të tanishme të cilat sillen nga 24 deri 34 nxënës në klasë. Një kapitull në vetë u kushtohet paraleleve të kombinuara. Për rregullimin e tyre kërkohej që në rastet e kombinimit të nxënësve me dy klasë të ndryshme (për shembull, I me III) paralelja mos ketë më shumë se 15 nxënës në klasë, në rastet e kombinimit me tre klasë të mos ketë më shumë se 12 nxënës dhe në rastet e kombinimit me tre klasë të mos ketë më shumë se 10 nxënës. Formimi i paraleleve të kombinuara me më tepër se tre klasë nuk duhet të lejohet për asnjë rrethanë. Grupi punues i arsimit klasor në nivelin e arsimit fillor, që përfshin klasat nga viti I deri V, ka kërkuar gjithashtu largimin e lëndës së arsimit teknik nga klasa IV dhe postimin e kësaj lënde në klasë VI. Është kërkuar gjithashtu që numri i lëndëve të mësimit deri klasën IV të mos tejkalohet fondin prej 22 orë mësimi në javë. Kjo, sikurse thuhet në kapitullin VI do të arrihet me largim e lëndës mësimi i bazave kompjuterike dhe programimit në klasë III dhe IV. Ndërkaq për arsimin lëndor, respektivisht arsimtarët e angazhuar me nxënësit e ciklit të lartë të arsimit fillor, nga klasa VI deri IX, arsimtarët të mos kenë më tepër se 21 orë mësimi në javë. Ndëshkimet e shkollave, drejtorëve dhe mësimdhënësve për arsye të ndryshme duhet të përsojnë gjithashtu ndryshime rrënjësore. Për këtë çështje ka një kapitull të veçantë ashtu sikurse edhe për çështjen e mësimdhënësve të angazhuar me mirëmbajtjen e EMIS-it dhe projekteve të tjera shkollore.

Rrahja e studentëve, paditet Çavkovi

Shkup, 26 tetor - Prokuroria Themelore Publike ka proceduar padinë e ngritur nga Komiteti i Helsinkit ndaj ish-drejtorit të Byrosë për Siguri Publike, Mitko Çavkov dhe Njësitit për Intervencion të Shpejt. Prokuroria nuk jep detale në lidhje me procedimin e padisë, por thotë se po ndërmarrin masa për zbardhjen e rastit të dhunës ndaj studentëve. Është dorëzuar kërkesë tek institucionet kompetente për dorëzim të të dhënave, mes tjerash janë thirrë edhe shtatë persona për të dhënë deklarata para prokurorit publik. "Numrin e personave për të cilët ekziston dyshimi se kanë kryer vepra penale, për momentin nuk jemi në gjendje ta ndajmë me ju. Veprimet ndërmëren në drejtim të konstatimit të ekzistimit të elementeve të veprave të kryera penale "Parandalim ose pengim të tubimit publik" nga Neni 155 dhe "Keqtrajtim në kryerjen e detyrës" në bazë të nenit 143 të Kodit Penal", thuhet në njoftimin e Prokurorisë Publike Themelore. "Në mëngjes e morra ftesën që më 6 nëntor, si dëshmitare dhe pjesëmarrës direkt në ngjarje. Nuk e di deri ku është procedura, por më gëzon fakti që hapet procedurë për këtë ngjarje, që është me rëndësi për bashkësinë akademike, para se gjithash për studentët që në mënyrë brutale janë tërhequr nga hapësirat dhe që tentuan të ndërprejnë zgjedhje të parregullta, ku dhe gjithashtu u sulmuan fizikisht", ka thënë për TV Nova, Ivana Tufegxhiq, atëkohë studente, por tani deputete në Parlamentin e Maqedonisë. Mes dëshmitarëve të brutalitetit ndaj studentëve të propozuar janë edhe kryetarja e Komitetit të Helsinkit, Uranija Pirovska, aktorja Ivana Pavloviç dhe gazetari Borjan Jovanovski.

Ndëshkimi me vlerë shumë të lartë në para, sipas personave të cilët merren me çështje të arsimit, është edhe arsyeja kryesore për moszbatimin e atyre predispozitave. Dhe meqë paga mujore e një mësimdhënësi, për shembull është 370 euro, Këshilli i shkollës, drejtori dhe organe tjera të shkollës shumë normal që do të japin maksimumin për të mbrojtur mësimdhënësit nga ndëshkimet

Shkup, 26 tetor - Dënime astronomike janë të përfshira në Ligjin aktual të arsimit fillor në Maqedoni, të cilat mund të shkojnë deri në 8 mijë euro për mos respektim të predispozitave të caktuara. Ndërkaq në total - vlera e dënimeve për të gjitha kategoritë është 26.150 euro, ku më e kërçenuar nga kundërvajtjet

Ligjin për arsim fillor i ashpër me shkollat, drejtorët dhe mësimdhënësit

Kur shkollat dënohen me mbi 26.000 euro!

e mundshme është shkolla si subjekt juridik me 9000 euro gjithsej, pastaj vijnë në radhë drejtorët, mësimdhënësit, personit juridik, mësimdhënësit dhe prindërit. Ndëshkimi me vlerë shumë të lartë në para, sipas personave të cilët merren me çështje të arsimit, është edhe arsyeja kryesore për moszbatimin e atyre predispozitave. Që të mos shmangin dënimet, të cilat për shkollat në total shkojnë deri në 9000 euro, për drejtorët deri në 6000 apo mësimdhënësit deri në 4600 euro, të ardhurat mujore të këtyre personave që Ligji i atakon me ndëshkimin në para - duhet të jenë vërtetë të larta. E meqë paga mujore e

një mësimdhënësi - për shembull është 370 euro, Këshilli i shkollës, drejtori dhe organe tjera të shkollës shumë normal që do të japin maksimumin për të mbrojtur mësimdhënësit nga ndëshkimet. Konkretisht, nuk do të bëjnë raporte dhe procesverbale për mësimdhënësit, të cilët mund të kenë shkelur nene të caktuara të Ligjit, për moszbatimin e të cilëve janë caktuar sanksionet në para. Për shembull, mësimdhënësit - sipas nenit 72-b, do të dënohen me 500 euro në kundërvlerë të denarit në rast se nuk paraqesin orar për mësim plotësues dhe shtesë për çdo lëndë mësimore dhe të njëjtin nuk e

vendosin në vend të dukshëm të shkollës. Faktikisht, në asnjë shkollë nuk gjen të shpalosur oraret e këtilla dhe në të njëjtën kohë - nuk është shqiptuar asnjë dënim për mësimdhënësit për këtë arsye. Por, ata mund të dënohen edhe me 1000 euro gjombë nëse "nuk e realizojnë numrin vjetor dhe javor të orëve për mësim në pajtim me plan-programin mësimor" apo "nuk e realizojnë mësimin në mënyrë interaktive", si dhe për disa raste tjera të ngjashme, të cilat përkrahohen në nenin 172-v. Dënimi i drejtorëve për të njëjtat arsye është 1500 euro, kurse i shkollës 3000 euro. Në të vërtetë, gjohet më të larta janë vendosur

për mënyrën e organizimit të shkollës, procesit mësimor dhe mekanizmave të kontrollit, respektivisht për mos zbatimin e normave të caktuara me këtë Ligj. Kështu, shkollat do të gjohin nga 3500 deri në 4000 euro në kundërvlerë me denarë, drejtorët me 2500 dhe mësimdhënësit me 1500 nëse në shkollë "organizohet organizim dhe veprim politik dhe fetar dhe vendosen shenja partake dhe fetare". Të njëjtat dënime janë edhe në rastin e ushtrimit të dhunës psikike apo maltremit fizik të nxënësit nga ana e mësimdhënësit, ose drejtorët bëjnë "zgjedhjen e mësimdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë në kundërshtim me

dispozitat e caktuara ligjore". Por dënime me nga 1000 euro janë të parapara edhe për prindit, përkatësisht kujdestarin e fëmijëve, nëse fëmija keqtrajton psikikisht apo fizikisht. Mosrealizimi i procesit të vetë evaluimit të shkollës gjithashtu është i dënueshëm me Ligjin për arsim fillor edhe atë me 4000 euro për shkollën dhe 2500 për drejtorët. Dënime, gjegjësisht gjoha në para janë caktuar të shqiptohen edhe për mosrelizimin e lëndëve të obligueshme dhe zgjedhore mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta edhe atë me 2500 euro për shkollën, 1500 euro për drejtorin dhe 500 euro për mësimdhënësin. (L.P)



Takime derë më derë, shmangen tubimet

Kandidatë për kryetarë të komunave në taborin shqiptar i shmangen debateve dhe tubimeve të mëdha duke preferuar takime kokë më kokë me qytetarët - lagje për lagje e fshat për fshat. Edhe në këto zgjedhje, ndonëse bëhet fjalë për pushtet lokal e jo atë qendror - sigla partiake dhe figura e liderit të partisë po bëhen imazhi dominues i fushatës duke lënë në hije figurat e kandidatëve për kryetar të komunave

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 26 tetor - Fushata zgjedhore për rrethin e dytë është në ditët e fundit dhe e fokusuar në takimet mes liderëve të koalicioneve - atij të LSDM-BDI dhe ASH-BESA, si dhe luftës së pa kompromis në terren. Kandidatë për kryetarë të komunave në taborin shqiptar i shmangen debateve dhe tubimeve të mëdha duke preferuar takime kokë më kokë me qytetarët lagje për lagje e fshat për fshat. Edhe në këto zgjedhje, ndonëse bëhet fjalë për pushtet lokal e jo atë qendror, sigla partiake dhe figura e liderit të partisë po bëhen imazhi dominues i fushatës, duke lënë në hije figurat e kandidatëve për kryetarë të komunave. Aq më pak nuk kemi një qartësi të Programeve zgjedhore të kandidatëve për kryetar komune, ndërkaq premtimet në shumë komuna mbeten të njëjta të përsëritura në fletushka të shtypura dhe me shpresën se pushteti qendror - tani që LSDM është bartës i tij, do të bëjë më shumë për vendbanimet shqiptare. Habit fakti as vetë kryeministri Zoran Zaev dhe as partitë politike që flisin para zgjedhjeve parlamentare për rritjen e TVSH-së deri në 14 për qind, e cila në vendet e BE-së shkon deri në 40 për qind, tanimë askush nuk e zë në gojë, dhe po aq të heshtur janë edhe për decentralizmin e pushtetit qendror në dobi të atij lokal, duke shtuar kompetenca për komunat.

Harrohen projektet e mëdha

Fatkeqësisht, nga kryeministri Zaev nuk shihet një Strategji për zhvillimin e komunave dhe daljen e disa komunave nga statusi i komunave të varfra me mundësinë që ato ti bashkëngjiten komunave me qendër qytetin. Nga ana tjetër, partitë opozitare bëjnë premtime për joshur qytetarët, por tek ata nuk shohim të dalin

Fushata dominohet nga imazhi i liderëve



KSHZ E SHPËRNDAU MATERIALIN ZGJEDHOR

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) dje filloi me shpërndarjen dhe pranim-dorëzimin e materialit të besueshëm zgjedhor deri te komisionet komunale zgjedhore (KKZ) për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale që do të mbahen të dielën. Në pajtim me afatin zgjedhor, KSHZ-ja, materialin zgjedhor e dorëzon deri te KKZ-ja më së voni në afat prej 72 orëve para ditës së zgjedhjeve, ndërsa KKZ-ja është e obliguar një ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve ta dorëzojë materialin zgjedhor në këshillat zgjedhorë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale do të mbahet në 35 komuna. KSHZ njofton se qytetarët, të cilët janë të regjistruar në Listën zgjedhore, e të cilëve afati i vlefshmërisë së dokumentit për identifikim personal u skadon mes dy raundeve zgjedhore të Zgjedhjeve lokale 2017, në raundin e dytë zgjedhor që do të mbahet më 29 tetor, mund të votojnë vetëm me letërnjoftim apo dokument udhëtimi të vlefshëm. Qytetarët, siç theksojnë nga KSHZ, të cilët duan ta realizojnë të drejtën e tyre zgjedhore në raundin e dytë për zgjedhjen e kryetarit të komunës, duhet menjëherë të nxjerrin letërnjoftim apo dokument udhëtimi të ri.

me një pasqyrë reale të gjendjes buxhetore të komunave, ku shumica prej tyre janë në borxh të mëdha, si dhe të dalin me të dhëna konkrete për raste korruptive dhe nepotizmi në komuna. Rasti i fundit ku flitej për shpenzime të mëdha, kontrata mbi vepër dhe borxh të lartë publik ishte kandidati për Tetovën i Lëvizjes BESA, Bilall Kasami, që njëherësh është dhe doktor i shkencave ekonomike. Kur jemi tek fushata, një ditë pasi liderët e partive që janë në koalicion për rrethin e dytë - Ziadin Sela i ASH-së dhe Bilall Kasami i Lëvizjes BESA u takuan në Tetovë. Po në Tetovë, të enjten për në ora 18 është paraparë të takohen liderët e koalicionit tjetër BDI-LSDM, Ali Ahmeti dhe Zoran Zaev. Siç thanë për gazetë KOHA nga

Shtabi qendror BDI-së, në selinë e partisë po bëhen përgatitje për takimin që do të ketë kryeministri Zoran Zaev me liderin Ali Ahmeti, ndërsa gjatë ditës, Zaevi ka pasur takim me kandidatit e BDI-së për kryetar të Gostivarit, Nevzat Bejta. Nga Shtabi zgjedhor i BDI-së nuk mundën të konfirmojnë asgjë rreth takimit të mundshme që flitej për disa ditë të kryeministrit Zaev në Strugë me kandidatit e BDI-së për kryetar të kësaj komune, Ramiz Merko. Ndërkaq, lideri i ASH-së ishte i zëshëm të mërkurën gjatë takimit me liderin e BESËS, Bilall Kasami kundër qasjes së Zaevit për të mbështetur kandidatit e BDI-së. Nga kjo parti - burime anonime thanë për gazetën KOHA se funksionarë të lartë partiak përmes mesazheve telefonike, i

kanë bërë të qartë Zaevit se një takim i tij me Merkon në Strugë nuk do të pritej aspak mirë nga ASH dhe mund të ketë efekte negative në partneritetin qeveritar. Nga ana tjetër, sipas burimeve partiake, është e mundur që kryeministri Zaev pas takimit që do të zhvillojë me Ali Ahmetin në Tetovë, ti bëjë thirrje elektoratit të kësaj partie në Strugë që ta votojnë Ramis Merkon e BDI-së për kryetar të kësaj komune. Sa i përket fushatës së kandidatëve - garë e ashpër po bëhet për të parin e Komunës së Çairit, mes Visar Ganiut të BDI-së dhe Zeqirija Ibrahimit të Lëvizjes BESA. Të parit po i jep mbështetje çdo ditë kryetari i ri i Shkupit, Peetre Shilegov, duke kërkuar edhe votat e anëtarësisë dhe simpatizantëve të LSDM-së në këtë komunë.

Në rrethin e parë, Ganiu doli para Ibrahimit me rreth 1700 vota, gjegjësisht me 11.860 vota kundrejt 10.202 vota sa mori Zeqirija Ibrahimit. Nga partitë tjera, Faruk Abdiu i ASH-së pati 2327, ndërsa kandidatja e VMRO-së, Nermin Telovska mori 3441 vota, derisa Idris Orana i PDSH-së 769 vota. Në Likovë, ku kemi balotazh në mes kandidatit të BDI-së, Erkan Arifi, i cili edhe doli i pari me një diferencë rreth 3 mijë votave ndaj kandidatit të lëvizjes BESA, Shaban Zendeli, gjegjësisht 5618 kundrejt 2607 votave, derisa kandidatit i ASH-së mori 1901 vota, Bardhyl Destani i PDSH-së 939 dhe Hadi Osmani i LSDM-së mori vetëm 152 vota. Në Saraj, garë e ashpër në terren po aq sa në Çair po zhvillohet mes Blerim Bexhetit të BDI-së dhe Bashkim Bakiut të Lëvizjes BESA. I pari në rrethin parë mori 7963 vota, kurse i dyti 4582, derisa Ekrem Alija nga ASH mori 3191 a Sefedin Aliu i PDSH-së vetëm 278 vota.

Garë e fortë edhe në komunat rurale

Garë e fortë po zhvillohet edhe në komunat rurale të rajonit të Pollogut mes kandidatëve të BDI-së dhe atyre të Lëvizjes BESA dhe ASH-së. Në Bogovinë, në balotazh janë Berzat Bejtullahu i BDI-së që në rrethin e parë mori 3917, ndërsa Albon Xhemali i ASH-së fitoi 3118 vota, derisa Minur Asani i BESËS pati 2717, i PDSH-së Elvir Iseni 1101 vota, ndërsa Vebi Xhemali i PPD-së 226 vota. Në Tearcë, në balotazh janë Isen Asani i BDI-së që në rrethine parë mori 2952 vota dhe Amir Elezi i BESËS me 2317 vota, ndërsa Nevzat Veliji i ASH-së mori 1441, Bojo Gogovski i VMRO-së 684 vota, Bobi Petrushevski i LSDM-së 708 vota dhe Ruhan Ilazi i PDSH-së 1442 vota. Në Komunën e Zhelinës në balotazh janë Fatmir Izari i BDI-së me 4009 vota dhe Blerim Sediu i BESËS me 3979 vota, derisa kandidatit Reshat Aliu i ASH-së 668 vota, Sali Ajdini i PDSH-së 323 vota. Në Vrapçishtë, në balotazh janë Gajur Rushiti i BDI-së me 3572 dhe Isen Shabani i ASH-së me 3168 vota. Në Dibër, në balotazh janë Ruzhdi Lata i BDI-së që në rrethin e parë mori 3419 vota me Arben Agollin e ASH-së që mori 2597 vota, derisa Xhemal Çupi i BESËS mori 1271

vota, Shkëlqim Xhafa i Koalicionit UNITETI-RDK mori 328 vota, Dragan Kllopecvki i VMRO-së 685 vota. Në qytetet e mëdha, në Strugë në balotazh janë Ziadin Sela i ASH-së me 9289 vota që mori në rrethin e parë dhe Ramiz Merko me 7916 vota, ndërsa kandidatit i LSDM-së, Vasil Ashtallkoski mori 7140 vota, Sejad Sollakoski i VMRO-së 4149 vota, Lavdrim Elmazi i BESËS mori 1060 vota. Në Gostivar, Nevzat Bejta është në balotazh me Arben Taravarin e ASH-së, ndërsa në rrethin e parë Bejta mori 12.095 vota, kurse Taravari 11.600 vota. Po në Gostivar, Dafina Stojanovska e VMRO-së mori 3543 vota, Asaf Ademi i Lëvizjes BESA mori 3104 vota, Shpat Iseni i koalicionit RDK-UNITETI 1556 vota, Sebadin Izairi i PDSH-së mori 703 vota. Në Tetovë, në balotazh është Teuta Arifi, e cila në rrethin e parë mori 13.265 vota me Bilall Kasamin e BESËS që mori 8767 vota, ndërsa nga partitë tjera, Goran Manojlovski i VMRO-së mori 6457 vota, Adnan Neziri i ASH-së 4874 vota, derisa ndërsa Bardhyl Dauti i PDSH-së mori 4568 vota. Në Studeniçan, në balotazh është Azem Sadiku i PDSH-së që në rrethin e parë mori 2875 vota me Rexhep Memedin e BESËS që mori 1968, ndërkaq Fehmi Jonuzi i BDI-së mori 1812 vota, Akija Mustakovski i LSDM-së 1332 vota, ndërsa Mexhid Imeri i ASH-së mori 172 vota.

Të dielën do të votohet në 1517 vendvotime në 35 komuna

Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale në Maqedoni do të zbatohet në 1.517 vendvotime në 35 komuna, ku të drejtë vote kanë 833.710 qytetarë. Në Komunat e Shkupit, Çair, Butel, Gazi Babë, Kisella Vodë dhe Shuto Orizarë, të drejtë vote kanë 260.194 qytetarë, të cilët do të votojnë në 387 vendvotime. Në 29 komunat e tjera në Maqedoni në rrethin e dytë do të votojnë 573.616 qytetarë në 1.130 vendvotime. Fushata zgjedhore për rrethin e dytë përfundon më 27 tetor në orën 24, pas çka vijon heshtja zgjedhore e cila zgjat deri në përfundimin e zgjedhjeve në orë 19 më 29 tetor.

Në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale është zgjedhur kryetari i Qytetit të Shkupit dhe të 45 komunave.

TË DIELËN DO TË VOTOHET NË 1517 VENDVOTIME NË 35 KOMUNA

Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale në Maqedoni do të zbatohet në 1.517 vendvotime në 35 komuna, ku të drejtë vote kanë 833.710 qytetarë. Në Komunat e Shkupit, Çair, Butel, Gazi Babë, Kisella Vodë dhe Shuto Orizarë, të drejtë vote kanë 260.194 qytetarë, të cilët do të votojnë në 387 vendvotime. Në 29 komunat e tjera në Maqedoni në rrethin e dytë do të votojnë 573.616 qytetarë në 1.130 vendvotime. Fushata zgjedhore për rrethin e dytë përfundon më 27 tetor në orën 24, pas çka vijon heshtja zgjedhore e cila zgjat deri në përfundimin e zgjedhjeve në orë 19 më 29 tetor. Në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale është zgjedhur kryetari i Qytetit të Shkupit dhe të 45 komunave.



Buxheti së shpejti para Qeverisë për miratim

Nuk ka përgjigje për autostradën Shkup-Bllacë!

Nga Ministria e Financave, njëjtë sikurse në Ministrinë e Transportit - thonë se ende po punohet në përgatitjen e Buxhetit për vitin 2018 dhe se për momentin - nuk mund të dinë se për cilat projekte infrastrukturore parashihen të ndërtohen me para buxhetore

Shkup, 26 tetor - Përpilimi i Buxhetit për vitin 2018, është nga fundi dhe janë duke u shqyrtuar detajet për precizimin e projekteve makroekonomike. Ministria e Financave, me projeksionet që parashihen më buxhetin e vitit të ardhshëm, pret rritje më të lartë ekonomike. "Lidhur me deficitin buxhetor - qëllimi kryesor është që shteti të harxhojë më shumë para që ekonomia të del nga aktiviteti i ulët ekonomik. Me Buxhetin e vitin 2018 do të shkurtohen harxhimet për projekte joproductive që t'ju jepet përparësi projekteve produktive me efekte multiplikative që të lëvizin ekonominë e vendit", informojnë nga Ministria e Financave. Mirëpo, as nga Ministria e Financave e as nga Ministria e Transportit, nuk morëm përgjigje në pyetjen se me Buxhetin 2018 nëse parashihen para për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, për të cilin plot 8 vite assesi të sigurohen mjete financiare.

Pas miratimit të rishikimit të Buxhetit të vitit 2017, ministri i Transportit, Goran Sugarovski, deklaroi se me Buxhetin e vitit 2018, do të sigurohen mjete buxhetore për përgatitjen e projekt-dokumentacionit të saktë, sepse studimi fizibiliteti i fundit i përgatitur nga "Western Balkan Investment" ka rezultuar se përmban shumë mangësi dhe paqartësi.

"Me buxhetin e vitit 2018 do të parashihen mjete buxhetore për përgatitjen e studimit fizibiliteti dhe pasi të kemi gati studimin, atëherë do të mund të parashohim dhe mjetet financiare që do të nevojiten për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë", kishte deklaruar Sugarevski. Mirëpo, në pyetjen që ia drejtua Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve lidhur me këtë çështje, nga atje thanë se "kjo do të dihet vetëm atëherë kur Buxheti për vitin e ardhshëm të miratohet nga Qeveria e Maqedonisë. Për informata të sakta, mirë është t'i drejtoheni Ministrisë së Financave".

Njëherësh, nga Ministria e Financave, njëjtë sikurse në Ministrinë e Transportit - thonë se ende po punohet në përgatitjen e Buxhetit për vitin 2018 dhe se për momentin - nuk mund të dinë se për cilat projekte infrastrukturore parashihen të ndërtohen me para buxhetore. "Nuk mund të japim shifra të sakta se cilat projekte infrastrukturore do të ndërtohen me para buxhetore, sepse ende po punohet në përgatitjen e Buxhetit për vitin 2018. Vetëm kur të jetë gati Buxheti 2018, do të dihet saktë se a do të parashihen mjete për autostradën Shkup-Bllacë apo do të vazhdohet të kërkohet modalitetit i partneritetit publiko-privat", thonë nga Ministria e Financave.

(Z.V)

Maqedonia para reformës tatimore



Analistët ekonomik vlerësojnë se nuk duhet nxituar me reformat tatimore, të cilat nevojitet mirë të analizohen dhe të shqyrtohen që të mos sjellin më shumë dëme për ekonominë, biznesin dhe popullatën

TVSH nuk lëviz, shqyrtohet rritja e tatimit personal

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 26 tetor - Qeveria në të ardhmen nuk planifikon të rrisë shkallën e Tatimit të Vlerës së Shtuar, ndërsa në muajt në vijim do të ketë një debat më të gjerë lidhur me përfitimet, por edhe humbjet nga rritja eventuale e tatimit në të ardhura për qytetarët me paga më të larta. Jozyrtarisht pritet që shteti të ndërmarrë reformë më të gjerë tatimore për të mbuluar mungesën kronike të parave si dhe mbulimin e borxheve të mëdha të shtetit. Përflitet se ndër zgjidhjet e shtrëngimit të financave publike, janë edhe kontributet më të larta për punëtorët, tatimi më i lartë në paga, tatimi më i lartë në fitim apo edhe rritja e TVSH-së.

Problem edhe paga e pensioneve

Rishqyrtimi i politikës tatimore apo mbushjes dhe harxhimit të arkës së shtetit imponohet edhe nga niveli i lartë i borxhit publik prej më shumë se pesë miliardë euro, faktit se shteti vite me radhë ka deficit buxhetor negativ prej disa për qind, për shkak se të ardhurat e shtetit janë më të vogla se shpenzimet e tij, andaj edhe bilanci buxhetor është negativ. Me fjalë të tjera, shpenzimet publike për një vit kalendari janë më të larta se të ardhurat publike. Gjithashtu problem për financat e shtetit paraqesin edhe harxhimet e mëdha për pagesën e pensioneve për shkak të rritjes së numrit të pensionistëve nga njëra anë dhe ulje së numrit e të punësuarve që e mbushin arkën e shtetit përmes pagesës së tatimeve dhe kontributeve sociale. Vetëm sivjet për pagesën e pensioneve janë parashikuar mbi 830 milionë euro, ndërsa prej tyre më shumë se 450 milion euro do të mbulohen nga buxheti i shtetit. Në ndërkohë, analistët ekonomik vlerësojnë se nuk duhet nxituar me reformat

tatimore, të cilat nevojitet mirë të analizohen dhe të shqyrtohen që të mos sjellin më shumë dëme për ekonominë, biznesin dhe popullatën.

"Pjesë e analizës janë edhe efektet dhe përfitimet nga rritja eventuale e tatimit personal në 18 për qind për të ardhurat më të larta, si dhe shkalla e pandryshuar prej 10 për qind për pagat më të ulëta", thotë eksperti ekonomik Pavle Gacov. Sipas konsulentit ekonomik, Goran Rafajllovski, nuk duhet të ketë rritje të shkallës së tatimit personal, ndërsa nëse eventualisht një masë e tillë është e domosdoshme, ai duhet të rritet për vetëm 2 për qind. Rafajllovski rekomandon rritjen e butë të TVSH-së.

"Nevojitet të rritet shkalla e TVSH-së nga 18 në 20 për qind, që nuk do të sjellë luhajtje më të mëdha të kufimeve ose rritja do të jetë e vogël për nevojat e përditshme të jetesës. Nga ana tjetër, rritja e TVSH-së mund të sjellë në buxhet 200 milionë euro që paraqet shumë serioze për mbushjen e gropave të arkës shtetërore", shton më tej Rafajllovski.

Nga ana tjetër, nga Ministria e Financave, i kanë hedhur poshtë informacionet për rritjen e Tatimit të Vlerës së Shtuar për 2-3 për qind, duke i cilësuar thjeshtë si spekulime. "Shkalla e TVSH-së nuk do të ndryshohet. Një gjë e tillë nuk është parashikohet as me plan programin qeveritar. Deri në fund të vitit do të hapim debatin për vendosjen eventuale të shkallës progresive të tatimit personal në të ar-

hura. Gjithashtu, të gjitha ndryshimet do të miratohen në mënyrë transparente dhe me përfshirjen e opinionit të gjerë", thonë nga Ministria e Financave.

Lidhur me efektet e pritshme të reformave tatimore, analistët ekonomik thonë se jo çdo herë rritja e tatimeve nënkupton edhe të ardhura më të mëdha në buxhet për shkak të mundësisë që obliguesit tatimor t'i ikin evazionit fiskal apo thjeshtë të fshehin tatimin.

"Ndryshimet në shkallën e tatimit personal në të ardhura, nëse rriten për të gjithë të punësuarit, përkundër nivelit të pagës, mund të sjellin ulje të pagave të punëtorëve që do të ulë konsumin dhe do të ndikojë në arkën shtetërore. Nevojitet të shikohet se sa do të realizohen paralajmërimet lidhur me kufirin, prej të cilit do të rritet shkalla e tatimit personal. Nëse ai vlen vetëm për ato që kanë paga prej 60 mijë denarë, që si pranues të pagave nuk janë të shumtë në numër, dyshoj se çfarë efekti do të ketë një rritje e tillë", thotë analisti ekonomik, Slobodan Najdovski.

Sipas tij, rekomandohet që të ketë rritje të shkallës tatimore vetëm te tatimi në pronë që do të sjellë të ardhura më të mëdha për komonat, më shumë të holla do të mbesin në arkën shtetërore që nënkupton edhe më pak mjete shtesë të transferuara nga buxheti qendror për financimin e komunave.

Edhe një pagë shtesë!

Ndryshe, në plan pro-

gramin e LSDM-së, "Plani për jetë", parashikohet që çdo qytetar të fitojë nga 15 për qind të TVSH-së së paguar nga llogaritë fiskale, që nënkupton se në fund të vitit edhe një pagë shtesë për çdo familje. Parashikohet vendosja e sistemit të drejtë tatimor ku të varfrit do të paguajnë më pak, ndërsa të pasurit më shumë. Pesë për qind të qytetarëve me bazë më të lartë vjetore tatimore do t'u vendoset shkallë tatimore prej 18 për qind, për shumën e të ardhurave shtesë. Pragu do të definohet në bazë të shumës absolute në bazë të paraqitjeve tatimore për vitin 2016. Për shumicën e qytetarëve do të mbetet shkalla ekzistuese e tatimit personal në të ardhura prej 10 për qind. Investitorët dhe biznesi kërkojnë parashikueshmëri dhe stabilitet të ligjeve dhe ambientit afarist, andaj nuk do të rrisin shkallën unike prej 10 për qind të tatimit në fitim. Do të vendoset mundësia e shkallës tatimore për tatimin në pronë për patundshmëritë rezidente dhe jorezidente, me vlerë më të lartë se 400 mijë euro që do të rritet për 0.1 për qind.

Qytetari që posedon një shtëpi apo banesë ku jeton me familjen e tij, shkalla e tatimit në pronë do të jetë 0.05 për qind e vlerës së banesës apo shtëpisë. Për posedim e banesës apo shtëpisë së dytë, shkalla e tatimit do të jetë 0.1 për qind, ndërsa për shtëpinë e tretë shkalla e tatimit do të jetë 0.15 për qind. Shkalla e akcizës për veturat më të shtrenjta se 40 mijë euro pritet të jetë 25 për qind.

SHTYHET AFATI PËR DORËZIMIN E FLETËPARAQITJEVE TVSH DERI MË 27 TETOR

Drejtoria për të Ardhura Publike e vazhdoi afatin për dorëzimin e fletëparaqitjeve të TVSH-së deri më 27 tetor të vitit 2017. "Në pajtim me Ligjin për procedurë tatimore, për shkak të dorëzimit të vështirësuar të fletëparaqitjeve tatimore përmes sistemit e-Tatime më 24 dhe 25 tetor 2017, njoftohen obliguesit tatimorë dhe kontabilitetët se afati për dorëzimin e fletëparaqitjes TVSH-04 shtyhet. Afati përfundimtar për dorëzimin e fletëparaqitjes TVSH prej 25 tetor 2017 shtyhet për dy ditë pune, gjegjësisht afati përfundimtar do të llogaritet 27 tetori 2017", qëndron në kumtesën e DAP.



Ish agjentët e DSK mund të kërkojnë azil politik në Greqi

Policia i nje ndihmësit e Grujoskit dhe Boshkovskit

Ekspertët ligor thonë se mos shqyrtimi i këtij rasti të iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike, mund të paraqes shkak kryesor që organet gjyqësore të Greqisë, të pranojnë kërkesën eventuale për azil politik të dyshes Grujoski dhe Boshkovski

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 26 tetor - Dyshja shumë e përfolur si "koka" e përgjimeve, Goran Grujoski dhe Nikolla Boshkovski, gjatë arratisjes nga Maqedonia kanë pasur mbështetje të fort logjistike. Lajmin se një grup prej dhjetë personash kanë qenë të angazhuar në dhënie e ndihmës ndaj dy ish agjentëve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, të enjten nuk e ka demantuar ministri Oliver Spasovski. Me këtë rast, ai vetëm ka theksuar se për hir të procedurës që zhvillohet para Ministrisë për Punë të Brendshme dhe Prokurorisë Publike, nuk mund të shpalojë të dhëna më të hollësishme për përfshirjen e pjesëtarëve të policisë në këtë skenar.

"Ne posedojmë shumë informacione. Në këtë drejtim jemi duke punuar së bashku me Prokurorinë, megjithatë të njëjtat nuk mund të publikohen në këtë fazë të hetimit", tha shkurt për gazetaret ministri Spasovski. Ndaj ish pjesëtarëve të policisë sekrete, në Selanik është



iniciuar një procedurë gjyqësore nën akuzën e falsifikimit të dokumenteve të udhëtimit. Megjithatë, dy seanca e fundit u prolonguan me arsyetim të mungesës së përkthyesve. Nga ana tjetër, Gjykata Penale e Shkupit, pas pranimit të kërkesës për kompletim të dokumentacionit për ekstradimin e Goran Grujoskit dhe Nikolla Boshkovskit, është prononcuar se do ta respektojë afatin ligjor prej 40 ditëve për shqyrtim të kësaj kërkesë. Ky vendim i Këshillit Penal, rastësisht ose jo, përputhet me vendim e Gjykatës së Selanikut, e cila seancën e ardhshme për gjykimin e dy ish agjentëve të policisë sekrete të Maqedonisë, e ka caktuar për datë 1 dhjetor, respektivisht deri atëherë përbushet afati prej 40 ditëve.

Aktakuza e bashkuar për rastet "Target dhe Fortesa", ndonëse është dorëzuar në fund të muajit qershor, ajo deri më tani ende nuk është vlerësuar nga Gjykata Penale e Shkupit. Ekspertët ligjorë dhe njohësit e rrethanave, duke i komentuar këto zhvillime, thonë se mos shqyrtimi i këtij rasti ta iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike, mund të paraqes shkak kryesor që organet gjyqësore të Greqisë, të pranojnë kërkesën eventuale për azil politik të dyshes Grujoski dhe Boshkovski. Duke ju referuar Sistemit të automatizuar të informacioneve për menaxhim me lëndët gjyqësore (SAIGJ), vlerësimin për lëndën e bashkuar "Target dhe Fortesa", duhet ta bëjnë gjykatësit Goran Boshevski dhe Ivica Stefanovski. Në përshkrimin e ak-

takuzës për këtë lëndë (edhe pse në faqen e PSP-së për dallim nga rastet tjera, për këtë lëndë gjyqësor nuk janë publikuar provat), thuhet se në procesin e mëtutjeshëm gjyqësor pritet të vërtetohet se cilët kanë qenë motivet kryesore të përgjimit të qindra oponentëve politik të VMRO-DPMNE-së, përfshirë edhe gazetaret, afaristët, aktivistët qytetarë, por edhe një pjesë të vetë funksionarëve të DPMNE-së, me përjashtim të Nikolla Gruevskit dhe Sasho Mijalkovit.

Ndryshe, me fillim e procesit gjyqësor për këto raste, njëherit do të vërtetohet se kush ka urdhëruar për asgjësimin e pajisjeve për përgjime dhe dokumenteve nga procesverbalet në Drejtorinë e Pestë. Pavarësisht faktit se në sistemin aktual të DSK, në mënyrë të jashtëligjshme u tentua të pastrohen gjurmët nga përgjimet masive, prokurorja speciale, me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtar, arriti t'i kthejnë dëshmitë për përgjimin e mbi 5 mijë qytetarëve. Ndërkohë, Kompania "Telekom", deri më sot nuk ka dhënë asnjë dëshmi për procesin e jashtëligjshëm të përgjimeve që, sipas PSP-së, është realizuar nga viti 2008 deri në vitin 2015.

Kronikë

42 vjeçari kapet me lëndë narkotike

Të mërkurën pas mesnate, pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, stacioni policor në Gostivar, kanë arrestuar 42vjeçarin me iniciale Z.S nga fshati Çegran i Gostivarit. Pas arrestimit që është realizuar në rrugën "Mara Ugrinova" në Gostivar, i janë gjetur dhe konfiskuar 6 qese plastike me një materie të panjohur pluhuri, të cilat do të analizohen. Për shkak të dyshimeve se ka kryer veprën penale, prodhim të paligjshëm dhe lëshim në qarkullim gjegjësisht tregtimin me lëndë narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, çegranasi me iniciale Z.S është mbajtur në stacionin policorë për procedurë të mëtejshme dhe do të përballet me padi adekuate.

Aksident me tre të lënduar

Mëngjesin e ditës së enjte, rreth orës 5.30, në udhëkryqin e rrugëve "Vidoja Smilevski Bato" dhe "29 nëntori" në Tetovë, ka ndodhur një aksident komunikacioni, në të cilin janë aksidentuar dy vetura, edhe atë një veturë e tipit "Shevrolet Matiz" me targa të Gjermanisë, e drejtuar nga 31-vjeçari me iniciale E.K nga Gostivari si dhe një tjetër veturë e tipit "Hundai", me targa të Tetovës, të cilën e ka drejtuar 40-vjeçari me iniciale B.Z nga Tetova. Në këtë aksident tre bashkudhëtarët të cilët janë gjendur në veturën e tipit "Hundai" të moshës 15, 26 dhe 31 vjeçare për pasojë kanë marrë lëndime trupore dhe me anë të një veture tjetër janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës. Pas marrjes së ndihmës janë lëshuar që dalin nga ekspertiza e kryer në vendngjarje, shkak për këtë aksident është mospërshtatja e shpejtësisë, përderisa dëmi i shkakuar material vlerësohet që të jetë rreth 80 mijë denarë.

Dy të lënduar në Trebosh

Të mërkurën mbrëma, rreth orës 19, në rrugën lokale Tetovë-Trebosh, një veturë e tipit "Golf", me targa të Tetovës, e drejtuar nga 22-vjeçarja me iniciale A.A nga fshati Gajre, ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe për pasojë ka dalë nga rruga. Nga dalja prej rrugës vozitësja si dhe një bashkudhëtar i moshës 77-vjeçare, për pasojë kanë marrë lëndime trupore dhe janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, nga ku pas marrjes së ndihmës janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Si shkak edhe për këtë aksident, është mospërshtatja e shpejtësisë, përderisa dëmi i shkakuar material në total vlerësohet të jetë rreth 30 mijë denarë.

Sulmohet një 15-vjeçar në autobus

Një minoren 15 vjeçar, dje në autobus në Shkup është sulmuar nga ana e disa nxënësve, me ç'rast ka marrë lëndime. Siç kumtoi MPB-ja, në orën 19:34 dje në Spitalin e përgjithshëm të qytetit "Naumi i Ohrit" është denoncuar se tek ata ka ardhur një 15-vjeçar nga f. Nigishtan, i Shkupit nga Shkolla e mesme "Cvetan Dimov" me lëndime të marra nga një sulm fizik, i cili ka ndodhur në bul. Aradhat Partizane", në numrin 22. I dëmtuari në autobus është sulmuar nga disa nxënës. Nga ana e mjekut janë konstatuar lëndime të lehta dhe është lëshuar në mjekim shtëpiak, theksojnë nga MPB-ja.

Dhjetë aksidente në Shkup, dy të lënduar rëndë

Dhjetë aksidente kanë ndodhur 24 orët e fundit në Shkup, ndërsa në dy prej tyre janë lënduar rëndë dy persona. Në dy aksidente tjera janë lënduar më lehtë dy persona, ndërsa në gjashtë të tjerat është shkakuar vetëm dëm material. Siç informoi MPB-ja, gjatë ditës së djeshme, policia rrugore ka zbuluar numër të madh të kundërvajtjeve. Janë larguar nga qarkullimi katër persona, të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, tetë persona kanë drejtuar automjetin pa patentë shoferi ose me patentë të skaduar. Janë sanksionuar edhe katër shoferë, të cilët kanë kaluar në udhëkryqe në dritë të kuqe. Janë hasur edhe 58 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special karrotrec janë larguar 70 automjete. (U.H)

RIBAREV JEP DORËHEQJE NGA DREJTIMI I GJPSH-së

Ushtuesi i detyrës kryetari i Gjykatës Penale të Shkupit, Stojançe Ribarev, dirë më parë e ka dorëzuar dorëheqjen e tij para Këshillit Gjyqësor. Ky lajm, përmes një kumtesë për mediat, është publikuar në adresën zyrtare të GJPSH-së, ku mes tjerash thuhet se ai para disa ditëve e ka shfrytëzuar pushimin mjekësor, ndërkohë në postin e tij, si zëvendës, do të ulet gjykatësja Diana Gruevska Ilievska. "Me datë 25 tetor u.d kryetari i GJPSH-së, Stojançe Ribarev, e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor se jep dorëheqje nga posti i tij dhe se pas shkarkimit të tij, ai do të vazhdojë të kryer punën e gjykatësit në Gjykatën Supreme të Maqedonisë", thuhet në kumtesën e Gjykatës. Arsyet e kësaj dorëheqje mendohen të jetë për shkaqe private. Drejtuesi i deritanishëm i GJPSH-së, gjykatësi Stojançe Ribarev, kohë më parë u morë në pyetje nga ana e hetuesve të Prokurorisë Speciale Publike, e që ka të bëjë me një procedurë parahetimorë që kjo prokurori e udhëheq nën dyshimin se nga gjykata janë nxjerr dëshmi në interes të personave të dyshuar dhe atyre të akuzuar.

Rreth 70 për qind e romëve nuk kanë shtetësi

Shkup, 26 tetor - Në Maqedoni disa qindra qytetarë janë apartidë (persona pa shtetësi) prej të cilëve mbi 70 për qind janë romë, tregon raportin "Romët përkasin - Joshtetësi, diskriminim dhe marginalizim të romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë", i prezantuar sot në Shkup. Shoqata e Maqedonisë e juristëve të rinj me punë në terren nga viti 2010 e deri tani ka identifikuar 664 raste të persona pa shtetësi, si

lindje dhe emër personal të paregjistruar dhe personat të cilët nuk e kanë të rregulluar shtetësinë, prej të cilëve rreth 70 për qind janë romë, thuhet në raportin. Sipas Nina Marij nga Rrjeti evropian i joshtetësisë, në Evropë ka mbi 600.000 persona pa shtetësi, ndërsa nëpër gjithë botën numri i tyre është mbi 10 milionë persona. "Për shkak të mungesës së dokumenteve një numër i madh i popullatës rome jeton pa shtetësi dhe nuk

mund ta dëshmojnë identitetin dhe kombësinë e tyre. Joshtetësia do të thotë të jetohej pa kombësi, pa shtet dhe paraqet anomali juridike. Personat pa shtetësi ballafaqohen me vështirësi të mëdha që t'i realizojnë të drejtat e tyre fundamentale për arsim, mbrojtje shëndetësore, punë dhe liri të lëvizjes", tha Marij. Në raport thuhet se në Maqedoni sipas statistikave zyrtare jetojnë 53.879 romë ose 2,7 për qind e popullatës së

përgjithshme. Raporti është përgatitur nga ana e Qendrës evropiane për të drejta rome, Instituti për joshtetësi dhe inkluzion dhe rrjeti evropian për joshtetësi, në bashkëpunim me projekt partnerët kombëtar Shoqëri për ndihmë juridike nga Shqipëria, shoqata Të drejtat e Jua nga BeH, Shoqata e Maqedonisë e juristëve të rinj, Romë të Rinj nga Mali i Zi, Praksis nga Serbia dhe Dhjetë prilli nga Ukraina.



Arkitektët thonë se është koha e fundit për rigjenerimin gradual të hapësirës publike urbane përmes njëfarë lloj moratoriumi, ku në shumicën e vendbanimeve duhet të shqyrtohet mundësia e ndalimit të ndërtimeve, si dhe të fillohet me riparimin e gabimeve

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 26 tetor - Ndërtimi vend e pavend shpesh edhe në hapësirat publike të parqeve ka shkaktuar kaos urbanistik në shtet, që si dukuri nuk shqetëson vetëm Shkupin, por edhe një pjesë të madhe të vendbanimeve urbane dhe rurale në pjesën më të madhe të Maqedonisë.

Arkitektët komentojnë se për dallim prej më parë, kur kishte një kontroll të centralizuar të punëve ndërtimore, tani në garën për profit - shpesh anashkalohet edhe profesionalizimi dhe zëri i profesionistëve, zvogëlohen hapësirat e gjelbërta, nuk respektohen standardet për vendet e nevojshme të parkingut, ndërsa me ndërtesat e larta pengohet edhe qarkullimi i ajrit. Gjithashtu, kemi edhe rritje të ndotjes në Shkup, si rrjedhojë e numrit në rritje të veturave të vjetra, mos-ndërtimi i tramvajit, si dhe djegjes në vend se me gaz. Arkitektët thonë se

është koha e fundit për rigjenerimin gradual të hapësirës publike urbane përmes njëfarë lloj moratoriumi, ku në shumicën e vendbanimeve duhet të shqyrtohet mundësia e ndalimit të ndërtimeve, si dhe të fillohet me riparimin e gabimeve. Kjo nënkupton rimodelimin e qyteteve, në veçanti në Shkup - pasi kryeqendra mbetet tejet e ngarkuar, ndërsa urgjentsisht duhet të fillohet me rimodelimin ku do të lejohet zona e ndërtimit në zona periferike, aty ku ka hapësirë ose tokë ndërtimore, si dhe të ndalohen objektet shumë të larta.

Njohësit e kësaj sfere thonë se nëse urbanizimi si shkencë nënkupton planifikim dhe rregullim të hapësirës, atëherë në praktikë - qytetarët edhe vetë mund të shohin se në tërë shtetin mungon një rend në vendbanimet e ndryshme, ka probleme me furnizimin me ujë dhe rrymë në shumë lagje, me ujërat e zeza e kështu me radhë. Arkitektët thonë se jo vetëm Shkupi, por edhe vendbanimet e tjera në Maqedoni mund të duken ndryshe, ndërsa shtojnë se qytetarët kanë bindjen se hapësira në vend si resurs

Kërkohet revizion i planeve të detajuara urbanistike

Moratorium për ndërtesat e larta



kuptohej si mall për profit. Pritet që në të ardhmen, me masa të ndryshme të realizohet përqindja e ndërtimit në bazë të dendësisë së popullatës dhe infrastrukturës.

“Nevojitet të realizohen urgjentsisht revizion dhe moratorium i të gjitha planeve të detajuara urbanistike. Një gjë e tillë nevojitet të ndërmerret për shkak se në të kundërtën - do të humbin shtetin. Një nga veglat apo mjetet kryesore me të cilat ndërtohet shteti është urbanizimi dhe planifikimi. Për fat të keq, tek në vitet e fundit praktikohet urbanizimi pa plan-

ifikim”, thotë arkitektja Dijana Mishkoviç. Sipas ekspertëve, për zgjidhjen afatgjate dhe korigjimin e gjendjes, nevojitet të fillohet me planifikimin hapësinor ku do të definohen të gjitha qëllimet strategjike të lidhura me zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë. “Së pari duhet të përgatiten planet hapësinore që do të japin informacione dhe udhëzime për përgatitjen e planeve të reja urbanistike gjenerale, dhe më tej për përgatitjen e planeve të reja të detajuara urbanistike.

Kjo nuk vlen vetëm për Shkupin, por për të gjithë vendbanimet dhe tërë shtetin”, thekson Mishkoviç. Nga ana tjetër, njohësit e urbanizimit vlerësojnë se lë për të dëshiruar gjendja në Shkup, por edhe në më shumë qendra të tjera urbane në Maqedoni, çështja se sa kriteret e ndërtimit i plotësojnë kriteret minimale për mbrojtjen e shëndetit publik, mirëqenies së përgjithshme, ndriçimit, strukturës mbrojtëse nga zhurma, etj.

Andaj, thonë arkitektët, është koha e fundit për rigjenerimin gradual të hapësirës publike urbane përmes njëfarë lloj moratoriumi, ku në shumicën e vendbanimeve - urgjentsisht të shqyrtohet mundësia e ndalimit të ndërtimeve, si dhe të fillohet me riparimin e gabimeve.

Në ndërkohë, partia DOM ka propozuar Ligjin për gjelbërim urban që pritet të sigurojë mbrojtje efektive të gjelbërimit ekzistues, edhe përmes ndalimit për prerjen e drunjve shumëvjeçar dhe përpunimin e obligueshëm të kadastrës të gjelbër apo regjistrit të drunjve.

Njëherazi, gjelbërimi do të inkorporohet edhe në dokumentacionin e urbanizimit sipas normativave dhe standardeve të rrepta. Vlerësohet se më të gjelbërta janë qytetet e Evropës Perëndimore me 40 për qind gjelbërim. Pastaj vijnë shtetet e Evropës Lindore me 15 për qind dhe në fund janë shtetet ballkanike me më pak se 10 për qind gjelbërim. Ligji i ri parashikon vendosjen e standardit prej 25 metra katror hapësirë të gjelbër për banor tek të gjitha planet e përgjithshme urbanistike, si dhe përqindje të obligueshme të gjelbërimit në parcelën ndërtimore prej 10-30 për qind në varësi prej dedikimit dhe lokacionit. Në blloqet e ndërtuara, me ligj do të imponohet kompensimi i gjelbërimit me vendosjen e rrezeve të drunjve dhe zhardinjerave në fasada dhe kulme. Parashikohet edhe mbrojtja e rreptë e gjelbërimit ekzistues. Me Ligjin për gjelbërim do të përcaktohen standardet dhe normativat për planifikim, projektim dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit si dhe titullarin që do të përkujdesen për mirëmbajtjen e gjelbërimit.

Publicitet



KRYETARI I KOMUNËS –
Nr. /.../ prej/.

Kryetari i Komunës së Čairit, Shkup, gjatë shqyrtimit të kërkesës së personit **Xhemo Ferat, Kemal Luçi, Sabit Fera, Nehat Mjaki, Beqir Osman, Agron Qaili dhe Sejhan Latifi** nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, nën numër **08-3366** nga data **13.07.2011**, në bazë të nenit 21 paragrafi (2) nga Ligji për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, nr. 44/14, nr. 115/14, nr. 199/14, nr. 124/15, 129/15, 217/15 dhe 31/16), e në bazë të nenit 205, paragrafi 1 dhe neni 209 nga Ligji për procedurë të përgjithshme juridike (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 38/2005 11/08 dhe 6p. 51/2011), e miraton këtë:

AKTVENDIM për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm

1. Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm:
Objekt banimi me servis,

që gjendet në PK 3955/1, KK Qendër 1, i regjistruar në Fletë pronësinë nr. 99165 dhe PK 3955/3, KK Qendër 1, e regjistruar në fletë pronësinë nr. 96926, objekt i cili është shënuar si:

numri i objektit 3, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **servis**, sipërfaqja e brendshme **126 m2**.

numri i objektit 3, Kati 1, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **133 m2**.

numri i objektit 3, Kati 1, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **5 m2**.

numri i objektit 3, Kati 2, hyrja 1, banesa 2, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **133 m2**.

numri i objektit 3, Kati 2, hyrja 1, banesa 2, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **5 m2**.

numri i objektit 3, Kati 3, hyrja 1, banesa 3, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **133 m2**.

numri i objektit 3, Kati 3, hyrja 1, banesa 3, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **5 m2**.

numri i objektit 3, Nënkulim, hyrja 1, banesa 4, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **128 m2**.

numri i objektit 3, Nënkulim, hyrja 1, banesa 4, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **17 m2**.

numri i objektit 3, Përdhese, hyrja 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **korridor - shkallë**, sipërfaqja e brendshme **65 m2**.

3. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Elaborat gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 291/17 të datës 22.09.2017, i përpiluar nga **“GEO AS GRUP” SHPKNJ-P**-Shkup.

4. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i njëjti paraqet bazë juridike për regjistrimin e të drejtës të pronësisë së objektit në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive ndërsa gjatë regjistrimit shënohet se objekti ka fituar status juridik në pajtueshmëri me Ligjin për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme.

Arsyetimi

1.a Kërkesit **Kemal Luçi** nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, dorëzoi kërkesë nën numër **08-3366** nga data **13.07.2011**, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

Pjesë të objekti banesor me servis,

e shënuar si: PK 3955/1, KK Qendër 1, i regjistruar në Fletë pronësinë nr. 99165 dhe PK 3955/3, KK Qendër 1, me sipërfaqe të përgjithshme për legalizim **126 m2**.

numri i objektit 3, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **magazin**, sipërfaqja e brendshme **126 m2**.

Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet personi: **Kemal Luçi** nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, me NVAQ 0903967450006.

2.a Kërkesit **Kemal Luçi, Sabit Fera** nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, dorëzoi kërkesë nën numër **08-3366** nga data **13.07.2011**, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

Pjesë të objekti banesor me servis,

e shënuar si: PK 3955/1, KK Qendër 1, i regjistruar në Fletë pronësinë nr. 99165 dhe PK 3955/3, KK Qendër 1, me sipërfaqe të përgjithshme për legalizim **138 m2**.

numri i objektit 3, Kati 1, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **133 m2**.

numri i objektit 3, Kati 1, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **5 m2**.

Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet personi: **Kemal Luçi** nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, me NVAQ 0903967450006 (1/2 pjesë të patundshmërisë).

Sabit Fera nga Shkupi, rr. “Brigada Maqedonase Kosovare” nr. 16, me NVAQ 2203961450085 (1/2 pjesë të patundshmërisë).

3.a Kërkesit **Nehat Mjaki, Beqir Osman** nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, dorëzoi kërkesë nën numër **08-3366** nga data **13.07.2011**, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

Pjesë të objekti banesor me servis,

e shënuar si: PK 3955/1, KK Qendër 1, i regjistruar në Fletë pronësinë nr. 99165 dhe PK 3955/3, KK Qendër 1, me sipërfaqe të përgjithshme për legalizim **138 m2**.

numri i objektit 3, Kati 2, hyrja 1, banesa 2, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **133 m2**.

numri i objektit 3, Kati 2, hyrja 1, banesa 2, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **5 m2**.

Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet personi:

Nehat Mjaki nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 23, me NVAQ 0405973450034 (1/2 pjesë të patundshmërisë)

Beqir Osman nga Shkupi, rr. “3” nr. 30, me NVAQ 2509977450028 (1/2 pjesë të patundshmërisë).

4.a Kërkesit **Agron Qaili dhe Sejhan Latifi**, nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, dorëzoi kërkesë nën numër **08-3366** nga data **13.07.2011**, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

Pjesë të objekti banesor me servis,

e shënuar si: PK 3955/1, KK Qendër 1, i regjistruar në Fletë pronësinë nr. 99165 dhe PK 3955/3, KK Qendër 1, me sipërfaqe të përgjithshme për legalizim **138 m2**.

numri i objektit 3, Kati 3, hyrja 1, banesa 3, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **133 m2**.

numri i objektit 3, Kati 3, hyrja 1, banesa 3, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **5 m2**.

Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet personi:

Agron Qaili nga Shkupi, rr. “Pere Toshev” nr. 56, me NVAQ 1609993450128 (1/2 pjesë të patundshmërisë)

Sejhan Latifi nga Shkupi, rr. “2” nr. 43, Kondovë, Saraj, me NVAQ 0305994455015 (1/2 pjesë të patundshmërisë).

5.a Kërkesit **Xhemo Ferat**, nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, dorëzoi kërkesë nën numër **08-3366** nga data **13.07.2011**, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

Pjesë të objekti banesor me servis,

e shënuar si: PK 3955/1, KK Qendër 1, i regjistruar në Fletë pronësinë nr. 99165 dhe PK 3955/3, KK Qendër 1, me sipërfaqe të përgjithshme për legalizim **145 m2**.

numri i objektit 3, Nënkulim, hyrja 1, banesa 4, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **hapësirë banimi**, sipërfaqja e brendshme **128 m2**.

numri i objektit 3, Nënkulim, hyrja 1, banesa 4, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **17 m2**.

Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet personi: **Xhemo Ferat** nga Shkupi, rr. 391” nr. 19, me NVAQ 0901979450084

6.a Kërkesit **Xhemo Ferat, Kemal Luçi, Sabit Fera, Nehat Mjaki, Beqir Osman, Agron Qaili dhe Sejhan Latifi** nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, dorëzoi kërkesë nën numër **08-3366** nga data **13.07.2011**, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

Pjesë të objekti banesor me servis,

e shënuar si: PK 3955/1, KK Qendër 1, i regjistruar në Fletë pronësinë nr. 99165 dhe PK 3955/3, KK Qendër 1, me sipërfaqe të përgjithshme për legalizim **65 m2**.

numri i objektit 3, Përdhese, hyrja 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **korridor - shkallë**, sipërfaqja e brendshme **65 m2**.

Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet personi:

Kemal Luçi nga Shkupi, rr. “Prohor Pçinski” nr. 141a, me NVAQ 0903967450006

Agron Qaili nga Shkupi, rr. “Pere Toshev” nr. 56, me NVAQ 1609993450128

Sejhan Latifi nga Shkupi, rr. “2” nr. 43, Kondovë, Saraj, me NVAQ 0305994455015

Xhemo Ferat nga Shkupi, rr. 391” nr. 19, me NVAQ 0901979450084

Beqir Osman nga Shkupi, rr. “3” nr. 30, me NVAQ 2509977450028

Sabit Fera nga Shkupi, rr. “Brigada Maqedonase Kosovare” nr. 16, me NVAQ 2203961450085.

Kërkesi me kërkesën parashtrio:

-Elaborat gjeodezik nr. 291/17 të datës 22.09.2017, i përpiluar nga **“GEO AS GRUP” SHPKNJ-P**-Shkup.

- Fotokopje e letërnjoftimit nr. G1249836 e dhënë nga MPB – Shkup

- Fotokopje e letërnjoftimit nr. G0288486 e dhënë nga MPB – Shkup

- Fotokopje e letërnjoftimit nr. G0288486 e dhënë nga MPB – Shkup

- Fotokopje e dokumentit të udhëtitimit nr. H0373651 e dhënë nga MPB – Shkup

- Fotokopje e letërnjoftimit nr. G1250310 e dhënë nga MPB – Shkup

- Ekstrat nga Libri amë i të lindurve nr. 09-204/26295 Shkup.

-Fletë pronësinë nr. 99165 nga data 27.09.2017.

-Fletë pronësinë nr. 96926 nga data 27.09.2017.

- Akt i noterizuar - Deklaratë nr. PLA 2478/2017 në Shkup me datë 28-09-2017.

- Akt i noterizuar - Deklaratë nr. RPA 496/17 në Shkup me datë 28-09-2017.

- Akt i noterizuar - Deklaratë nr. RPA 510/17 në Shkup me datë 05-10-2017.

- Pasqyrë për kontroll historik të regjistrimeve të kryera për PK 3955/3, KK Qendër 1 me numër 1107-6847/2017 në Shkup, 11.09.2017

Toka në të cilën është ndërtuar objektit është në pronësi të RM-së për PK 3955/1, KK Qendër 1, dhe në pronësi të MPC-SPE Manastrii Shën. Iljia f. Banjani për PK 3955/3, KK Qendër 1.

Gjatë procedurës sjellë:

- Procesverbal nga këqyrja në vend me nr. **08-3366** nga data 02.10.2017;

- Pëlqim urbanistik me nr. **08-3366** nga data 18.10.2017;

- Konkluzion për përcaktimin e kompensimit me nr. **08-3366** nga data 18.10.2017.

-Konkluzion për përcaktimin e kompensimit nga Qyteti i Shkupit dhe Komunës së Čairit nr. **17/13-7629/2** nga data 18.10.2017; Vërtetim për pagesë të kompensimit nga Qyteti i Shkupit nr. **17/13-7629/2-P** të datë 20.10.2017 dhe Vërtetim për pagesë të kompensimit nga Komuna e Čairit paguar më datë 19.10.2017

Dedikimi i objektit të paligjshëm është shtëpi banimi ndërsa sipas dokumentacionit të planit urbanistik në fuqi, PK 3955/1 dhe PK 3955/3; KK Qendër 1, në të cilën është ndërtuar objekti është parapare për banim me dedikim të kombinuar.

Konstatohet se janë plotësuar kushte për përputhje të objektit të ndërtuar në mënyrë të paligjshëm në dokumentacionin e planit urbanistik në pajtim me standardet për përputhjet të objekteve të ndërtuar në mënyrë të paligjshëm në dokumentacionin e planit urbanistik.

Kryetari i Komunës së Čairit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, realizimin e këqyrjes në vend, këqyrjen në pajtueshmërinë urbanistike, konstaton se janë përmbushur kushtet për miratimin e aktvendimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm.

Në bazë të asaj që u theksua më lart, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIM PËR KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Čairit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm dhe për refuzimin e kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm, mund të dorëzohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit e aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës.

Ankesa taksohet me taksë administrative prej 250,00 denarëve

Dorëzuar dent te:

- Kërkesi

- Arkivi

Kryetar, Izet Mexhiti



Kultivuesit e mollëve në Tetovë dhe rajonin e Tetovës ankohen edhe për atë se edhe kur kanë pasur rendiment të lartë të mollëve të, njëjtat nuk kanë pasur plasma dhe për pasojë janë prishur për shkak se shteti, blerësit vendor dhe të huaj të mollëve, gjithmonë i ka adresuar në Resnjë dhe Ohër, duke anashkalluar prodhuesit e mollëve në Tetovë

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 26 tetor-Ngricat pranverore dukshëm kanë ndikuar që këtë vit të kemi rendiment më të ulët të mollës në treg, por edhe çmim më të lartë për dallim nga vitet e kaluara. Kultivuesit e mollëve në Tetovë dhe rajonin e Tetovës, thonë se këtë vit për shkak të ngricave pranverore kanë pësuar shumë dëme dhe për pasojë ka pasur prodhim më të ulët. "Gjatë pranverës kur kishte ngrica, kishte temperatura të ulëta, të gjithë lulet që kishin çelur, madje edhe disa kokrra të imëta, kanë rënë poshtë. Kjo ka bërë që të kemi shumë pak rendiment, dyfish më pak se vitin e kaluar. Kërkesa është e madhe për molla, por shumë pak prodhimtari kemi këtë vit, prandaj edhe ka rritje të çmimit të tyre", shprehet Mehas Adili, prodhues i mollëve. Sipas tij, arsytet për rritjen e çmimit të mollëve janë kushtet klimatike gjatë muajve të parë të këtij viti. Dëmet ata i kanë paraqitur në Njësinë territoriale të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Komisionet përkatëse të kësaj njësie kanë dalë në teren dhe kanë bërë veri-

Kultivuesit presin kompensim

Rendimenti i ulët rrit çmimin e mollëve



fikimin, vlerësimin e dëmeve, mirëpo deri më tani dëmet e shkaktuar nuk janë kompensuar.

"Ne kemi paraqitur dëmet që na janë shkaktuar. Kanë qenë komisioni në vendngjarje, por prej atëherë nuk kemi asnjë përgjigje. Presim kompensim prej shtetit, por vështirë se do të bëhet, nuk kemi shpresa", thotë Mehas Adili, prodhues i mollëve.

Sipas agronomëve dëmet që janë shkaktuar, janë të pa riparueshme. "Këto dëme që janë shkaktuar nga ngricat dhe temperaturat e ulëta nuk mund të evitohen, pra nuk mund që të rimbjellen

apo të bëhet diçka për t'i shpëtuar. Prandaj, do të ishte mirë që shteti të gjejë mundësi që të kompensojë këta bujq", thonë agronomët.

Ndryshe kultivuesit e mollëve në Tetovë dhe rajonin e Tetovës ankohen edhe për atë se edhe kur kanë pasur rendiment të lartë të mollëve, të njëjtat nuk kanë pasur plasma dhe për pasojë janë prishur për shkak se shteti, blerësit vendor dhe të huaj të mollëve, gjithmonë i ka adresuar në Resnjë dhe Ohër, duke anashkalluar prodhuesit e mollëve në Tetovë.

Përndryshe, Qeveria e

Republikës së Maqedonisë në një seancë të jashtëzakonshme në muajin prill vendosi të formojë komision për regjistrimin e dëmeve të pemëve dhe vreshtave nga temperaturat e ulëta. Bujqit e Tetovës janë shprehur të revoltuar dhe indinjuar ngase ata janë më të dëmtuarit pasi që, siç thonë ata, dhjetëra hektarë me patate nga bryma dhe i ftohti janë dëmtuar tërësisht. Bujqit thonë se këtë situatë e kanë paraqitur deri te Njësia rajonale e Ministrisë së Bujqësisë në Tetovë dhe minimum që kërkojnë është t'ju kompensohen së paku shpenzimet e tyre.



Policia sërish me apel për zgjedhje korrekte

Tetovë, 26 tetor-Para mbajtjes së rrethit të dytë të zgjedhjeve lokale që pritet të mbahen të dielën, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, sërish apelon deri te qytetarët nga rajoni i Tetovës dhe Gostivarit që para dhe në ditën e zgjedhjeve deri në fund të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe përgjegjshme dhe në kushte fer dhe demokratike të realizojnë të drejtën e tyre të votës të garantuar me kushtetutë. Përveç kësaj, qytetarët këshillohen që të mos iu nënshtrohen çfarëdo prej presioni, frikësimit ose formave të tjera të ndikimit negative nga individë të caktuar, struktura politike dhe të ngjashme.

"Qytetarët gjithashtu të përmbahen nga veprimet provokative, nga incidentet e ndryshme dhe lloje të ndryshme të prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Në rast të ekspozimit të qytetarëve në çfarëdo prej presioni, kërcënimi ose të ndonjë sulmi eventuale fizik para dhe gjatë kohës së votimit, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë rekomandon qytetarët që menjëherë të informojnë pjesëtarët e policisë, të cilët do të jenë të angazhuar në afërsi të vendotimeve ose këto raste t'i paraqesin në stacionin më të afërt policor", thuhet në njoftimin e lëshuar nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë në tërësi është i përgatitur për të parandaluar dhe për të vepruar në mënyrë ligjore për të gjitha prishjet eventuale të procesit zgjedhor, me qëllim që zgjedhjet të kalojnë në një atmosferë të qetë dhe demokratike.

Vitin e ardhshëm, 11 ditë jo pune me katër fundjava të vazhduara

Shkup, 26 tetor - Në vitin 2018 qytetarët e Maqedonisë do të kenë katër fundjava të vazhduara. Nga gjithsej 11 ditë jo pune për të gjithë qytetarët, katër lidhen me fundjavën, për dallim nga ky vit i cili ka shtatë fundjava të vazhduara festive. Fundjava e parë e vazhduar, vitin e ardhshëm do të jetë menjëherë pas pritjes së Vitit të Ri sepse 1 janari është e hënë. E dyta është për Krishtlindje, sepse ditë jo pune është 7 janari e diel, por zhvendoset për më 8 janar e hënë. E ngjashme është situata edhe me festën krishtere, Pashkët e cila vitin e ardhshëm si ditë jo pune është 9 prilli e hënë, si dhe Fitër Bajrami, sepse festa është më 15 qershor e premte. Për të gjithë qytetarët, ditë jo pune është edhe 1 maji - Dita e punës, 24 maji "Shën Cirili dhe Metodi" Dita e Iluministëve, 2 Gushti - Dita e Republikës, 8 Shtatori - Dita e Pavarësisë, 11 Tetori - Dita e

kryengritjes popullore, 23 Tetori - Dita e luftës revolucionare të Maqedonisë dhe 8 Dhjetori - "Shën Klimenti i Ohrit". Qytetarët e fesë ortodokse më së shumti do të pushojnë për festën e madhe krishtere Pashkët sepse për ta përveç të dielës - 9 prilli, ditë jo pune do të jetë edhe e premte - 6 prill. Fundjavë të vazhduar do të kenë edhe për Ujin e Bekuar e cila festohet më 19 janar të premtën. Ditë jo pune për besimtarët ortodoksë janë edhe 6 janari Nata e Buzmit - e shtunë, Dita e shpirtave 25 maj - e premte dhe Shën Mëria, 28 gusht - e martë. Për qytetarët e fesë katolike ditë jo pune janë edhe 2 prilli - e hënë Pashkët, dita e dytë e Pashkëve, 1 nëntori - festa e të gjithë shenjtorëve - e enjte, si dhe 25 dhjetori, Dita e parë e Krishtlindjeve - e martë. Për qytetarët e fesë myslimane ditë jo pune është edhe 21 gushti, Kurban Bajrami - e martë.

EVN përfundoi përshtatjen e njehsorëve për tarifën e lirë

Shkup, 26 tetor - EVN në kumtesën për media njofton se ekipet e saj kanë përfunduar me implementimin e tarifës së lirë ditore për të gjithë njehsorët ndaj të cilëve kishin qasje. Në pajtueshmëri me planin, përshtatja e njehsorëve u realizua në periudhë prej katër javëve lexuese, duke filluar më 25 shtator dhe përfunduar më 24 tetor. Në ekranin e çdo njehsori të përshtatur shfaqet indikator T2 gjatë periudhës nga



ora 14:00 deri 16:00 çdo ditë pune dhe të shtunën. Edhe pse ekipet e EVN-së i vizitu-

mentimin e tarifës së lirë ditore për njehsorët ndaj të cilëve nuk kishin qasje. Kjo do të thotë që njehsorët deri tek të cilët nuk kishin qasje akoma nuk janë të përshtatur, ndërsa ata më shpesh janë shtëpi pushimi dhe konsumatorë të zhvendosur. EVN Maqedoni, në javët në vijim do të vazhdojë me përshtatje të njehsorëve të tjerë tek të cilët nuk kishin qasje, si plan shtesë për implementimin e tarifës së lirë ditore.

Prezantohen programet Erasmus në UT

Tetovë, 26 tetor - Përfaqësues të Agjencisë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet të enjten në Universitetin Shtetëror të Tetovës i prezantuan mundësitë e programeve "Erasmus plus" dhe "Europas". Drejtuesi i Sektorit për arsim të lartë në Agjencinë nacionale, Aleksandar Bogojevski,

theksoi se programi "Erasmus plus" zgjat shtatë vjet, nga viti 2014 deri në vitin 2020, respektivisht në vitin 2021 dhe se pas kësaj periudhe do të avancohet edhe nën emër tjetër me qëllim që të mundësohet mobilitet më i madh për studentët dhe kuadrin akademik nga universitetet. "Nga USHT-ja çdo vit rritet

numri i paraqitjeve nga ana e studentëve dhe nga ana e profesorëve për trajnime në vendet e huaja. Nga buxheti për këtë qëllim në vlerë prej mbi 14 miliardë eurove në nivel të Unionit, rreth 40 për qind janë dedikuar për arsim sipëror që duhet të mundësojë bashkëpunim evropian në fushën e arsimit dhe tra-

jnimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendeve partnere në fushën e arsimit të lartë", sqaroi Bogojevski. Të pranishmit në amfiteatrin e USHT-së kishin mundësi të parashtronjë pyetje rreth mundësive për pjesëmarrje në programet "Erasmus plus" dhe "Europas". (u.h.)



Tragjedia e studentëve të Liceut Korçë

Nga auditorët europianë në humnerën e diktaturës

Sot 100 vjet nga krijimi i Liceut Francez të Korçës, një homazh për liceistët që kaluan nga auditorët europianë në fatin tragjik të diktaturës. Një prej tyre, në të njëjtën klasë me Enver Hoxhën, Abdulla Rami pas laurimit në jurisprudencë në Montpellier dhe punës si gjyqtar në Shqipëri e Kosovë vuajti kalvarin nën diktaturë; 18 vite burg dhe më pas internim...

Emira XHOMAQI

100-vjetori i Liceut Francez të Korçës përbën një ngjarje të shënuar në historinë e shkollës shqipe, sepse që në vitet e para pas Pavarësisë, ky lice luajti një rol sa të veçantë aq edhe të rëndësishëm në formimin e elitës shqiptare të kohës dhe përhapi në Shqipëri kulturën franceze dhe vlerat e saj. Frekuentimi i këtij liceu për pjesën më të madhe të atyre të rinjve arsimdashës nuk ishte një rastësi, por konsiderohej si një portë e hapur drejt Europës. Dhe prej këtu merr udhë një histori e gjatë dhe e pambarrimë të intelektualizmit shqiptar, gjurmët e të cilit me gjithë dramën e pësuar nën diktaturë mbërritën të gjalla deri në ditët tona! A ishte vallë zgjedhja e këtij liceu, ajo që do të udhëhiqte e do të përcaktonte në vitet e mëpasshme fatin e jetës së asaj rinie të pasionuar pas dijes e kulturës perëndimore?

Duke reflektuar këtë pyetje ndoshta shumëkush prej nesh sjell ndërmend atë institucion arsimor të shquar i cili funksionoi gjatë gjithë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, nga viti 1917 deri në 1942. Asokohe koloneli francez Descoins, me urdhër të gjeneralit Maurice Sarrail, komandant i ushtrisë së Lindjes dhe i forcave të Antantës, nënshkruan protokollin që shpallte krijimin e Republikës Autonome të Korçës, me president Themistokli Gërmenjin, nën mbrojtjen ushtarake të ushtrisë franceze. Në të njëjtën kohë Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve i ripërcaktoi Shqipërisë kufijtë e vitit 1913 dhe më 25 tetor 1917, Franca bëri të mundur hapjen në Korçë të një Liceu Francez. Menjëherë pas formimit, ky lice i cili më vonë do të quhej edhe Lice Kombëtar, do të bëhej një nga më të njohurit në Ballkan, për cilësinë e programeve mësimore dhe të mësimdhënies, ndërkohë që krijimi dhe funksionimi i tij u bë pjesë e një historie të lidhur pazgjidhshmërisht me peripecitë politike që kalonte Shqipëria dhe qyteti i Korçës në ato vite. Sipas Jacques Bourcartit, një gjeolog i Armatës Franceze të Lindjes i cili ka je-



tuar ato vite në Korçë, Franca ishte lëkundur fillimisht për hapjen e Liceut, dhe kjo që të mos provokonte zemërimin e qeverisë greke, e cila synonte kontrollin e plotë të kësaj zone të Shqipërisë. Megjithatë koloneli Descoins këmbënguli deri në instancat më të larta franceze dhe paraqiti projektin e krijimit të këtij liceu, programet shkollore të të cilit ishin krejtësisht të njëjta me ato franceze dhe për këtë arsye Ministri francez i Arsimit, Edouard Herriot, vendosi që diplomat e maturanteve të Liceut Francez të Korçës të ishin të barasvlershme me diplomat e bakaloreatëve në Francë.

Pikërisht aty, në bankat e këtij liceu, qindra të rinj shqiptarë u mbrujtën me idetë e iluminizmit dhe të së drejtës, të barazisë, të pluralizmit e të demokracisë, nisën projektet e tyre të para plot shpresa e dëshira për të ardhmen, lexuan për herë të parë pamfletet e Hygoit, admiruan Volterin në vlerësimin e tij për Gjergj Kastriot Skënderbeun, si edhe mësuan për gjithë ata shkrimtarë francezë që kishin ngritur lart figurën e heroit tonë kombëtar. Një frymë e re u ndje në gjeneratën e tyre dhe në kreu të shoqërisë shqiptare, një entuziazëm i ri i mbartur nga ata studentë të talentuar, të etur për dije e kulturë, të cilët studiuan më pas në mbarë qytetet europiane: në Romë, Paris, Montpellier, Toulouse, Grenoble, Lyon etj., duke krijuar kështu atë plejadë të çmuar të elitës shqiptare, ëndrra e së cilës për një Shqipëri të re, do të zhytej shpejt dhe dhimbshëm në terrin që i ofroi diktatura.

Pjesa më e madhe e studentëve shqiptarë të ardhur në Francë në vitet në vitet 20'-30, kishin mbaruar Liceun Francez të Korçës dhe kjo edhe për faktin se vetëm studentët e këtij liceu pranoheshin pa kryer studime plotësuese në universitetet franceze dhe integrimi i tyre në to ishte i menjëhershëm. E ndërsa për disa prej këtyre liceistëve jeta pasuniversitare vazhdoi një rrjedhë relativisht të qetë e të patrazuar, për shumë të tjerë vorbulla e saj i përfshiu dhe i flaku ata në një tragjedi të paparë. Sigurisht ky shkrim merr për-

sipër jo të relatojë kalvarin nëpër të cilin u rrokullis jeta e të rinjve ish-liceistë të Korçës, të cilët pa dyshim, nëse do të jetonin, do të kishin qenë shtylla të forta në fusha të ndryshme të mendimit ligjor dhe të drejtësisë shqiptare, të shkencave politike dhe filozofisë, të ekonomisë dhe letërsisë, të mjekësisë, inxhinierisë dhe agronomisë, të cilët do të ngrinin e do të ndërtonin bazat e një shteti shqiptar europian e demokratik, por gjithsesi këta rreshta janë një përpjekje për t'iu bërë homazh këtyre personaliteteve, jeta e të cilëve mori rrapëllimën e mbrapshtë dhe humbi e u shkatërrua në vitet e regjimit totalitar. Ata u shuan mizorisht në kulmin e shkëlqimit të tyre dhe ende nuk kanë gjetur vendin që u takon në panteonin e mendimit intelektual shqiptar. Historia e ish-liceistëve të Korçës, dëshmon për energji të tëra njerëzore të pafajshme, mbytur me një lehtësi kriminale nga "fitimtarët", nën diktaturë, ndërkohë që kontributi i tyre intelektual do të kishte qenë aq i çmuar dhe i vyer për Shqipërinë e pasluftës.

I referohem këtu, pikërisht viteve kur menjëherë pas çlirimit të vendit, idetë perëndimore dhe republikane të një elitë të përgatitur në nivelet më të larta të universiteteve europiane do të binin në shpatull me konceptin absurd stalinian dhe ideologjinë bolshevikë të Lindjes. Ideologji e cila u diktua Shqipërisë në atë periudhë nga Enver Hoxha, një ish-vitet e liceut u kryqëzuan me diktatorin Hoxha, do të ishte tragjik. Ky pikëtakim dhe përplasja e tyre ideologjike, do t'u kushtonte shtrenjtë, shumë shtrenjtë mjaft prej liceistëve të Korçës. Sepse shumë prej tyre që e kishin njohur nga afër Hoxhën, miq dhe shokë, por edhe ata që e njohën në mënyrë të rastësishme, u bënë pjesë e një vargu të gjatë eliminimesh dhe ekzekutimesh. Të konsideruar si kundërshtarë politikë, edhe pse me një potencial intelektual të padiskutueshëm, ata përfunduan pafajësisht në gjyqin, u internuan, u burgosën, u torturuan, u vranë dhe u zhdukën,

menjëherë pas vendosjes të diktaturës në Shqipëri. Dhe lista e tyre është e gjatë pafund...

Midis tyre edhe Sabiha Kasimati (1912-1951), vajza e parë shqiptare e diplomuar në Liceun Francez të Korçës, e cila përfundoi studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Biologjike në Universitetin e Torinos në Itali. Megjithëse nuk u angazhua në politikë, ajo mbajti një qëndrim protestues ndaj regjimit diktatorial. U arrestua në vitin 1951, pas incidentit të bombës në Ambasaden Sovjetike në Tiranë dhe u pushkatua pa gjyq më 26 shkurt 1951, së bashku me 21 intelektualë të tjerë. Në vitet e gjata të internimit, pas lirimimit nga burgu, Abdulla Rami (1908-1973), bashkëliceist e në të njëjtën klasë me Kasimatin e Hoxhën në Liceun Francez të Korçës dhe i laureuar në jurisprudencë në Universitetin e Montpellier, do t'i kushtonin homazhit të Kasimatit për kthimin e një prej poemave më të njohura të poetit francez André Chénier. Në dorëshkrimet e Ramit kam lexuar mes vargjeve edhe këta rreshta shqipëruar prej tij:

Ç'përbuzje fisnike shprehë buzë e tua

Kur hakmarrësi xhelat erdh e t'u afrua

Me kërcënim e vdekje që s'të tundën fije...

Vet xhelati u zbeh me gjyqtarët e zi

E senatori i pështirë me ministrat e tij

Kur ti e pambrojtur as që njohe frikë

Fjala jote e ëmbël, e thjeshtë me bujari

Ju mësoi që krimi sado llahtari

At' që braktis jetën s'e trëmb asnjë çikë.

Menjëherë pas përfundimit të studimeve në Francë dhe kthimit në atdhe, Rami shërbeu si jurist e gjyqtar në jugun e Shqipërisë dhe më pas në Kosovë. Ai aderoi në radhët e nacionalistëve shqiptarë të Ballit Kombëtar, me ëndrrën për një Shqipëri të lirë dhe Etnike. Arrestohet në dhjetor të vitit 1944 dhe vuan 18 vjet burg në buricat e Burrelit së bashku me vëllain e tij të idealeve Hasan Rami (1905-1988), kujdestar konvikti në vitet 1927-1928 në Liceun Francez, më pas drejtor shkollë në Krujë e në Vlorë

dhe nacionalist në radhët e Ballit Kombëtar. Ai u arrestua në vitin 1945 dhe vuajti 10 vjet burg.

Historia e liceistëve të Korçës vazhdon më tragjedinë e mjekut Enver Zazani (1908-1947), bashkëliceist edhe ai në të njëjtën klasë me Hoxhën, Ramin dhe Kasimatin në Liceun Francez. Pas studimeve për mjekësi në universitetin e Lyonit në Francë, Zazani kthehet në atdhe. Ai u lidh në ato vite me lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe u zgjodh deputet pas zgjedhjeve të para në Shqipëri. Por nuk vonoi shumë dhe arrestohet me grupin e parë të deputetëve, me akuzën "veprimtari armiqësor ndaj pushtetit popullor", dhe pushkatohej më 4 shtator 1947. Po kështu pushkatohej edhe juristi Qenan Dibra (1910-1946), i cili pas mbarimit të Liceut të Korçës përfundoi studimet e larta në fakultetin e Drejtësisë në Sorbonë-Francë, e më pas shërbeu si atashë në Legatën Shqiptare në Paris. Menjëherë pas kthimit në atdhe ai punoi si jurist duke qenë njëkohësisht edhe përkrahës e përfaqësues i organizatës së Legalitetit. Arrestohet në vitin 1946 dhe pushkatohej së bashku me 6 shokë të tjerë. I njëjti fat tragjik me të do të ndiqte edhe Hilmi Hysin (1913-1947), i pushkatuar në moshën 35-vjeçare. Pas përfundimit të Liceut Francez të Korçës, në profilin e filozofisë, ai diplomohet në Fakultetin Juridik të Sorbonës dhe pas kthimit në atdhe shërbeu si Gjyqtar Paqtues në Burrel, Berat e Tiranë dhe njëkohësisht aderoi në radhët e Organizatës Balli Kombëtar. Arrestohet në gusht të vitit 1947, për "veprimtari kundër regjimit diktatorial" të sapoardhur në pushtet dhe pushkatohej në janar të vitit 1948.

Këtë faqe historie e plotëson edhe emri i Foto Balës (1908-1991), i cili pas Liceut Francez të Korçës studioi filologji dhe filozofi në Universitetin e Montpellier. Pas kthimit në Shqipëri ai emërohet mësues i filozofisë dhe i gjuhës frënge në Liceun Francez të Korçës. Arrestohet menjëherë pas zgjedhjeve të vitit 1945 dhe dënohet me burgim të përjetshëm, nga të cilat vuajti 17 vjet. Atëherë ai i shkroi një letër Enver Hoxhës, shokut të liceut, ku e kritikonte për veprimet e tij dhe si pasojë e kësaj, familja e tij u dërgoi në internim. Fati tragjik i bashkëliceistëve të liceut të Korçës do të ndiqte edhe Myslim Çarçanin (1908-1987), një nga liceistët më të talentuar në matematikë, i cili pas liceut shërbeu si kryetar komune në disa qytete të vendit. Gjatë luftës, edhe ai u përfshi në Organizatën e Ballit Kombëtar të Delvinës. Më 15 prill të vitit 1945 arre-

stohet për veprimtari antikomuniste dhe prangoset. Dënohet me vdekje, por dënimi i tij u kthye në burgim të përjetshëm e së fundi vuajti 7 vjet në burgun e Burrelit.

Golgota e kësaj tragjedi liceane do të përfshinte edhe mjaft personalitete të tjerë. Mes tyre edhe Aleko Turtulli (1910-1988), i cili pas mbarimit të Liceut Francez të Korçës, përfundoi studimet në shkollën e Lartë të Tregtisë në Montpellier. Pas kthimit në atdhe ai i kushtohet marrëdhënive tregtare, por shumë shpejt arrestohet dhe burgoset për veprimtari armiqësore e vuan 10 vjet në burgjet dhe kampet e punës. Po ashtu edhe inxhinieri Adem Beli (1909-1998), i cili pas mbarimit të Liceut përfundoi studimet e larta për agronomi në Toulouse. Pas kthimit në atdhe, me titullin e inxhinierit agronom, ai shërbeu si Drejtor i Përgjithshëm i Bujqësisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe aderoi në Organizatën Balli Kombëtar. Arrestohet në vitin 1946 me grupin e deputetëve dhe dënohet me 20 vjet burg nga të cilat vuajti 8 vjet. Vetëm pak vite më vonë bashkëliceisti me të i Liceut Francez të Korçës Mustafa Kadilli (1914-1990), pushohet nga puna si mësues për motive politike dhe megjithëse në një gjendje shumë të rëndë shëndetësore, detyrohet të punojë punë krahu të rëndomta. Tragjedive të liceistëve të mësipërme do t'ju shtoheshin edhe plot emra të tjerë. Mes tyre edhe Nedim Kokona (1908-1998), Xhevdet Kapshtica (1906-1993), Aziz Vrioni (1914-1993), Asllan Ypi (1911-1980), Felatun Vila (1908-1967), Fetih Selenica (1906-1961), Xhelal Shënapremte (1913-1979), Alqi Nushi (1915-1995), të cilët pas mbarimit të Liceut Francez të Korçës, studiuan për Drejtësi në Francë dhe plot ëndrra e dëshira me valixhen e iluzionëve në duar, u kthyen në Shqipëri, por shumë shpejt ata u dënuan, u burgosën dhe u internuan famllarisht. Golgota e jetës së tyre pulson ende sot dhe gjurmët që ata lanë në auditorët e dijes i dhanë shpresë e forcë një gjeneratë të re... Sa europianë ishin ata, po aq atdhetarë mbetën deri në fund të jetës së tyre, një jetë e gatuar në një shesh paradoksesh, dhimbjesh, furtunash dhe padrejtësish, ku përzihen së bashku komeditë dhe tragjeditë, vendet dhe gjuhët, idealet dhe kulturaturat, shpresat dhe ëndrrat, vuajtjet dhe filozofitë... Ndaj dhe historia e tyre më sjell ndërmend një shprehje të famshme të Hygoit të madh që thotë: "Rruga e dijes shpesh kalon mes qelive"... madje edhe më tej, në Shqipëri për mjaft nga studentët liceistë të Korçës, ajo kaloi përmes tragjedi-ve... (Paris, tetor 2017)



Ngjarje të veçanta

Revolucioni që solli elektrifikimi

47 vjet më parë, më 25 tetor 1970 përfundoi elektrifikimi i plotë i Shqipërisë. Përmasat e punës që u bë, shifra, krahasime dhe fakte. Një prizë, një çelës elektrik dhe mandej një radio ishin një mrekulli e paparë që linte pas shekujt e errësirës dhe do të ndryshonte standardin e jetës në të gjitha drejtimet...

Xhevdet SHEHU

Mungesa e energjisë elektrike në ditët e sotme për një a dy orë, ngjan si një hata e madhe dhe qytetarët fillojnë me të drejtë menjëherë ankesat dhe kritikën për strukturat përkatëse shtetërore. Ku janë premtimet që na keni bërë? Përtej një ankese, ka më shumë revoltë. Sepse në errësirë mungojnë shumë gjera: një film, një telenovelë, një ndeshje sporti, nuk ka internet, nuk ka lajme... Nuk ka parlament e qeveri...


Nuk ka disko dhe Facebook, anulohen kushedi sa takime dashurore, dhe kushedi se sa zemra lëndohen dhe nervozohen. Thjeshtë, vetëm se mungon energjia e elektrike. Nga mungesa e kësaj energjie mund të vdesin njerëz nëpër spitale dhe të bllokohen kompjuterët në kalimet kufitare... Mungon komunikimi, domosdoshmëria e të cilit nuk mund të vihet në dyshim. Bota shurdhohet dhe qeniet njerëzore ndihen pa asnjë vlerë.

Vetëm atëherë e kuptojmë mrekullinë e rrymës elektrike dhe të kuptojmë revolucionin që ka ndodhur në jetën tonë, jo shumë larg po gjysmë shekulli më parë...

Në të vërtetë ky është një revolucion pozitiv që ka ndodhur këtu e afro gjysmë shekulli më parë në Shqipëri. Shekulli i kaluar është quajtur me të drejtë si shekulli i dritës në rang botëror. Pa energjinë elektrike nuk ka kuptim asnjë arritje shkencore dhe qytetëruese. Por, le të ndalem se si ka ndodhur tek ne:

Më 25 tetor të vitit 1970, në fshatin Agim (Çiflik) të rrethit të Fierit, u festua përfundimi i elektrifikimit të të gjithë Shqipërisë. Entuziazmi ishte i jashtëzakonshëm pasi ky fakt ishte jo vetëm i mahnitshëm për kohën, por edhe në kufijtë e pabesueshmes. Ky entuziazëm reflektohet në elektrifikimin dhe që shikonin me sytë e tyre të mirat që u sillte.

Jeta e tyre e përditsh-



me paskëtaj nuk do të ishte më e njëjta, ndërsa do të shtoheshin kërkesa të reja që ndryshuan rrënjësisht standardin e jetës dhe kulturën e tyre. I kishite ardhur fundi epokës së kandilit dhe pishës proverbiale në jetën e tyre.

Për ta kjo ishte "drita e partisë", ishin "telat e partisë" që shtriheshin fshat më fshat dhe radiot bucinin nga këngët për partinë dhe udhëheqësinë e saj. Në fillim të fushatës, Mehmet Shehu, në atë kohë kryeministër bënte thirrje: "Duhet ta trajtojnë vazhdimisht gjatë 4 viteve këtë aksion të madh, për të mbajtur gjallë frymën e kësaj lëvizje masive revolucionare".

Për të kuptuar rëndësinë e kësaj ngjarjeje, si dhe për t'u dhënë një mesazh të fuqishëm bashkëkomabsve të tij, Enver Hoxha shkoi vetë dhe

preu shiritin e një ekspozite mbi elektrifikimin e përfunduar në Pallatin e Kulturës në Tiranë më 4 nëntor, 1970.

Janë shkruar libra nga shkrimtarët më të mirë të kohës për këtë ngjarje, janë bërë kantata dhe vepra artistike të pafundme në artet figurative në atë kohë me një entuziazëm të paparë. Mund t'i kritikosh ato vepra për një entuziazëm të tepruar në ato vepra, por duhet të vendosesh, qoftë dhe për pak çaste në atë kohë që t'i kuptosh dhe t'i arsyetosh, jo t'i kritikosh apriori.

Sepse drita elektrike nuk ishte komuniste! Ishte vetë qytetërimi modern që po vinte me hapa galopantë dhe të pashmangshëm. Shqipëria kurrsesi nuk mund të bënte përjashtim. Për më tepër, regjimi i kohës e shfrytëzoi maksimalisht në favor të

tij, duke qenë njëkohësisht i përgjegjshëm për pasojat që do të sillte kundër tij.

Po të mos ishte energjia elektrike, shqiptarët e izoluar nuk do të mund të dëgjonin Zërin e Amerikës dhe të kuptonin realitetet ku jetonin... Pa dritën e 1970-s, shqiptarët do ta vononin edhe shumë e shumë vitin '90...

Elektrifikimi i Shqipërisë ishte ndër projektet më ambicioze e më prestigjioze të regjimit komunist të Enver Hoxhës. Krahas një sërë politikash zhvillimore, ndërtuese dhe transformuese, që përfshinin luftën kundër analfabetizimit, mbrojtjen e vendit, emancipimin e gruas, arsimimin e të gjitha niveleve, luftën për higjienizimin, kanalizimin, hapjen e tokave të reja, zhvillimin e infrastrukturës, apo sjelljen e ujit të pijshëm në shtëpi.

sot janë ende në funksionim. Më tej kemi ngritjen e një kompleksi të madh uzinash e fabrikash, të cilat nuk mund të funksiononin pa energjinë elektrike.

E kur kujtojmë këto vepra, është e pamundur të kujtohet edhe fakti që në atë kohë Shqipëria komuniste ishte në kulmin e miqësisë me Kinën e largët. Pa ndihmën e madhe dhe kontributin e kinezëve në atë kohë, ky projekt madhështor zor se do të realizohej në ato përmasa dhe në atë kohë rekord.

Le t'u referohemi shifrave zyrtare për dimensionet e kësaj arritjeje: 1759 fshatra u elektrifikuan, u lidhën 6500 kablo elektrike të kapacitetit 6\10 kv, u shtrinë 12 000 km linja elektrike të tensionit të ulët, u instaluan 2000 kabina elektrike, u ngritën më shumë se 50 mijë shtylla betoni dhe 330 000 druri, u elektrifikuan 140 000 shtëpi.

Elektrifikimi i plotë i Shqipërisë u paralajmërua përmes elektrifikimit të qendrave urbane si Saranda, Gjirokastra, Durrësi, Tirana, Korça dhe Elbasani që ishte nisur që para Luftës së Dytë Botërore.

Elektrifikimi rural i Shqipërisë kulmoi në kohën e regjimit komunist, përmes një fushate të fuqishme gjatë viteve '67-'71. Kjo fushatë ishte objektivi më i rëndësishëm i një plani pesëvjeçar sikurse bëheshin në atë kohë dhe ishte menduar të përfundonte në ditën që do të hapej Kongresi i 6-të i PPSH. Në të vërtetë përfundoi një vit më herët.

Kjo ndodhi pothuajse 100 vjet pasi Thomas A. Edison shpiku llampën inkandeshente (viti 1879). Ndërkohë elektrifikimi rural kishte ndodhur tashmë në shumë vende, si p.sh në BS (1920-1932), në SHBA (1935-1955), në Irlandë (1946-1959).

Krahasuar me mjaft shtete të tjera, elektrifikimi shqiptar shënon një rekord. Greqia, fjala vjen e përfundoi elektrifikimin një vit më vonë, ndërsa Bullgaria që e kishte filluar këtë proces në fillim të viteve '40 e përfundoi në një vit me Shqipërinë. Një prizë, një çelës elektrik dhe mandej një radio ishte një mrekulli për çdo shtëpi fshati që linte pas shekujt e errësirës. Më vonë me shpejtësi do të hynin televizorët dhe frigoriferët që përbënin një luks të paparë. Prandaj dhe me këtë edukatë të re qytetare që u kultivua hap pas hapi, mungesa e energjisë sot duket për cilindo si një fatkeqësi, si një dramë e paimagjinueshme, sidomos për të rinjtë që nuk mund ta imagjinojnë jetën pa internetin dhe lehtësirat që ka krijuar rryma elektrike. (dita)



George FRIEDMAN

Marksii, Lenini, Stalini dhe historia e një revolucioni

100-vjetori i Revolucionit Rus po afrohet. Ishte një revolucion i bazuar jo vetëm në shpresën, por në sigurinë që gjendja njerëzore mund të mbushej me barazi, bollëk dhe liri. Ai krijoi një regjim që ishte i gatshëm dhe ndihëj i detyruar të bënte çdo gjë për të krijuar atë përsosmëri, por ai regjim përfundoi në vitin 1991, i rraskapitur nga mjerimi që kishte krijuar. Revolucioni rus u frymëzua nga vepra e Karl Marksit dhe kjo vepër ishte një reduktim deri në absurd, i Iluminizmit francez. Iluminizmi kishte argumentuar se njerëzimi ishte i angazhuar për progresin – dija po akumulohet vazhdimisht dhe, bashkë me të, gjendja njerëzore po përmirësohej vazhdimisht. Në qendër të këtij procesi ishte arsyeja, e cila do të nxiste përparimin. Dhe ideja e saj kryesore, ishte se qeveria më e përsosur ishte ajo që promovonte parimin e barazisë njerëzore. Agjenti i gjithë kësaj ishte intelektualit, i cili e vendoste arsyen në qendër të gjitha gjërave, prandaj ishte ai që do të ofronte përparimin. Intelektuali do ta kuptonte domosdoshmërinë e përmirësimit të gjendjes njerëzore, dhe prandaj ishte e vetëkuptueshme se, kushdo që pengonte këtë, ishte armik. Intelektuali u bë

Intelektualët krijojnë idetë. Për t'i imponuar me forcë duhen banditët

një politikan që kërkonte pushtet dhe pastaj udhëhiqte masat drejt një transformimi të jetës njerëzore. Por iluminizmi paraqiste një paradoks. Nëse përparimi njerëzor ishte i sigurt, atëherë pse intelektualët duhet të bënin përpjekje dhe të ndërmerren rreziqe për ta çuar përpara? Por kishte edhe një paradoks tjetër. Intelektuali ishte gjithashtu i uritur për një peshë, përtej atyre me të cilët ndante jetën. Ai kishte uri për pushtet dhe njohje, prandaj vizioni që ishte ai që do të siguronte progresin njerëzimit, ishte jashtëzakonisht joshës. Paradoksi kishte nevojë për ekzaminimin e mendimtarëve. Por mendimtarët e anashkaluan paradaksin dhe udhëhoqën Revolucionin Francez. Dhe ata që pengonin progresin duhet të eliminoheshin. Intelektualët shfaqën pamëshirshmërinë e logjikës së pastër, një logjikë që i shihnte njerëzit si vegla, të cilave u duhej dhënë formë.

Një parti revolucionare

Marksii e shpuri impulsin e Iluminizmit në



përfundimin e tij logjik. Ai besonte jo vetëm në progresin, por në një progres që do të rezultonte në përsosjen e njerëzimit. Kjo përsosmëri do t'i jepte fund pamjaftueshmërisë, dhe do të sillte barazinë e vërtetë njerëzore. Kjo ishte e pashmangshme, sepse kontradiktat e brendshme të kapitalizmit në fund do ta shkatërronin atë, duke e çliruar proletariatin që të impononte një diktaturë, e cila do ta krijonte këtë realitet.

Problemi ishte, megjithatë, se proletariati, i dërrmuar nga kapitalizmi, nuk do të ishte në gjendje të ngrihej dhe të ndërtonte rendin e ri. Përsëri, shfaqet tensioni ndërmjet të pashmangshmes dhe domosdoshmërisë së veprimit njerëzor. Marksii u përpoq ta zgjidhë problemin duke argumentuar se një parti revolucionare do të dilte

nga proletariati, dhe do të vendoste një diktaturë që do të ishte agjenti për organizimin e punëtorëve dhe për të krijuar një njerëzim të ri.

Vladimir Lenini u përqendrua në ndërtimin e një partie komuniste. Problemi, argumentonte ai, ishte se klasa punëtorë vuante nga "vetëdija e rreme". Nuk e dinte se cilat ishin interesat e veta për shkak të gjendjes së saj, dhe prandaj nuk mund të çlirohej. Partia Komuniste duhej të ndërtohej nga ata që kishin shpuar velin e ndërgjegjes së rreme, dhe shihnin qartë se çfarë duhej bërë. Nuk do të ishte thjesht udhëheqëse e klasës punëtorë; do t'i shpinte punëtorët drejt progresit. Dhe njerëzit që mund të shihnin mes përmes vetëdijes së rreme ishin intelektualët, të cilët u bënë udhëheqës të bolshevikëve.

bashkua me një krenari në logjikën e pamëshirshme dhe politikën e pamëshirshme. Ajo krijoi një kulturë, në të cilën mëshira ishte një dobësi kundër-revolucionare. E vërteta ishte se intelektualët e njihnin terrorin vetëm si abstraksion. Ata e zbatuan atë, por jo me mëshirë e plotë të një banditi. Ata mendonin shumë dhe e mbanin dorën.

Mishërimi i pamëshirshëm

Ajo çfarë doli nga kjo ishte Josef Stalini, i cili veproi përsosmërisht si bandit – e vetmja gjë në fakt që e bënte përsosmërisht. Njerëz si Trocki dhe udhëheqësit e tjerë të bolshevikëve shkruan për persekutimin e pamëshirshëm të revolucionit, por Stalini ishte personifikimi i pamëshirshmërisë. Ai nuk ishte si intelektualët; ai nuk kishte interes në teoritë dhe deluzionet e tyre. Ai zhvendosi intelektualët që kishin udhëqur revolucionin dhe në fund i vrau ata, bashkë me miliona të tjerë. Kur Bashkimi Sovjetik kishte nevojë për modernizimin e industrisë së vet në pritje të luftës, ai i siguroi paratë duke shitur grurë – pothuajse të gjithë grurin e prodhuar nga ukrainasit – duke krijuar kështu zi buke masive dhe duke çuar në vdekjen e milionave. Misioni i parë i Partisë Komuniste, sipas doktrinës, ishte se që duhej të mbijetonte, dhe për këtë, Bashkimi Sovjetik duhej të mbijetonte – me çdo mjet. Lenini ishte një teoricien i terrorit dhe praktikues i tij. Por i hapi derën jo çlirimit të njerëzimit, por Stalini, një njeri që e praktikoi terrorin si qëllim, dhe jo si

Si mund të zhbllokojë paraja bisedimet për Brexit



Anatole KALETSKY

Si shumë procedura divorci, bisedimet e Britanisë me Bashkimin Europian kanë mbërritur në një bllokim që mund të thyhet vetëm me një kompromis. Zgjidhja për të dyja palët është të pranojnë se nuk mund të bihet dakord menjëherë për një marrëdhënie e re e përhershme dhe dukshëm jo brenda afatit të përcaktuar të marsit 2019.

Kështu, në vend që të lejohet dalja me përplasje e Mbretërisë së Bashkuar nga BE, bisedimet duhet

Ndërsa bisedimet mbi tërheqjen e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Europian janë bllokuar, negociatorët duhet të zhvendosen te "tranzicioni" i përkohshëm të cilin kryeministria Theresa May e kërkoi zyrtarisht muajin e kaluar. Mbi të gjitha, negociatorët duhet të përqendrohen menjëherë te kontributet Britanike te buxheti, kontribute që do të kërkohen për ta bërë të mundur një tranzicion të menaxhuar me rregull.

tashmë të zhvendosen te "tranzicioni" i përkohshëm që kryeministria Theresa

May zyrtarisht e kërkoi muajin e kaluar – dhe me për të cilën ka një konsensus të fortë mes udhëheqësve të biznesit dhe publikut në Britaninë e Madhe. Mbi të gjitha, negociatorët duhet tashmë të përqendrohen menjëherë te kontributet e Britanisë në buxhetin e përbashkët, të cilat do të kërkohen për ta bërë tranzicionin sa më të menaxhueshëm të jetë e mundur.

Një marrëveshje mbi një tranzicion në përfitim të dyfishtë kërkon disa kompromise nga të dyja palët. Por as Britania dhe as BE-ja nuk duhet të braktisin asnjë prej parimeve themelore.

Për Europën, zhvendosja e fokusit të bisedimeve drejt një marrëveshjeje të përkohshme, ndoshta e modeluar sipas marrëdhënies së BE-së

me Norvegjinë, duhet të përfshijë vetëm pak humbje prestigji: udhëheqësit e BE-së mund të duhet të pranojnë se hapat që ata kanë propozuar fillimisht për bisedimet Brexit do të duhet të riorganizohen. Në vend që të bien dakord mbi një marrëveshje financiare fillimisht, dhe pastaj të lëvizin drejt marrëdhënieve tregtare, financiare dhe tregtia do të duhet të pranohen si fusha me ndërvarësi – dhe rrjedhimisht duhet të diskutohen në mënyrë simultane.

Për Britaninë, një ndryshim në fokus nga marrëveshjet e përhershme të kushtet për një tranzicion të butë mund të transformojnë çështjet buxhetore të cilat tashmë po pengojnë progresin në një çelës për zhbllokimin e bisedimeve. Në një fjalim të mbajtur në Firence muajin e kaluar, May ofroi

kontribut vjetor deri në 10 miliardë euro çdo vit për një periudhë prej së paku dy vjet pas afatit të Brexit, si dhe për të ruajtur lëvizjen e lirë të punës dhe për të zbatuar rregullat e BE-së.

May shpresoi se kompromisi i saj mund të bindë udhëheqësit Europianë – veçanërisht kontribuesit më të madh, Gjermanisë, dhe përfituesit më të mëdhenj neto, të tillë si Polonia dhe Portugalia. Por oferta e saj nuk arriti të bëjë përshtypje, ndoshta për shkak se udhëheqësit e BE-së janë më pak të shqetësuar mbi grapën financiare të krijuar nga Brexit në vitet 2019 dhe 2020 se sa janë të shqetësuar për ciklin e ardhshëm buxhetor, nga 2021 më 2026.

Që të sugjerosh që Britania duhet të paguajë kontributet buxhetore

edhe për pjesën më të madhe të dekadës së ardhshme, atëherë duhet të jesh tërësisht jorealit, nëse shohim kundërshkrimin masiv të çdo pagese për BE-në nga euroskeptikët në Partinë Konservatore të May. Por, nëse bëjmë një inspektim më nga afër, bërja e një oferte buxhetore afatgjatë mund të ofrojë dy avantazhe të mëdha për May.

E para, kontributi për buxhetin tranzicional mund të prezantohet si pagesa tregtare në mbështetje të programeve Europiane nga të cilat Britania përfiton, në vend që të pranohet si "marrëveshje divorci" që tingëllon si ndëshkuese. BE aktualisht ka kërkuar 50-60 miliardë euro. Nëse pagesat tranzicionale të Britanisë vijojnë pranë nivelit aktual prej 10 miliardë për pesë apo gjashtë vjet, kohë

mjet. Është e paqartë nëse Stalini ishte në të vërtetë marksist, apo e përdorte marksizmin si një justifikim për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit. Por pavarësisht kësaj, Stalini besonte se partia nuk mund të mbijetonte pa shtypje të pamëshirshme, me qëllimin për të çliruar. Dhe kjo do të thoshte që Stalini duhej të qëndronte në pushtet për të menaxhuar shtypjen. Besimet e Stalinit dhe interesat e Stalinit ishin të njëjta, dhe vogëlsirat pak rëndësi kishin. Pas marrjes së pushtetit, Lenini firmosi një traktat paqesje me Gjermaninë, i cili u dha gjermanëve zona të mëdha të Bashkimit Sovjetik të ri. Ai ndihmoi në sigurinë e Bashkimit Sovjetik, por Lenini u mbajti pas mundësisë, që kjo do të sillte diçka më të mirë. Kur Stalini mori pushtetin, Bashkimi Sovjetik u bë një komb si gjithë të tjerët, duke ndjekur interesat gjeopolitike të BS, në një mënyrë të natyrshme dhe të pamëshirshme. Në teori, qëllimi ishte mbrojtja e partisë së punëtorëve dhe përhapja e doktrinës së komunizmit në botë, me çfarëdo mjeti të nevojshëm. Por vizioni i Iluminizimit për progresin njerëzor ishte i vjetruar tashmë. Pamëshirshmëria ishte bërë qëllim në vetvete. E keqja e domosdoshme u bë rrjedha normale e ngjarjeve.

Shndërrimi i mjetit në qëllim

Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania naziste

ishin njësoj të pamëshirshme. Hitleri nuk ishte intelektual në kuptimin e të qenit dije-tar, por ai jetonte në një botë idesh, dhe në atë botë qëllimi nuk ishte komunizmi, por ngritja sa më lart e racës ariane. Hitleri e konsideronte këtë si të pashmangshme, por ashtu si komunistët, ai duhej të vepronte me brutalitet të pamëshirshëm për ta bërë që të ndodhte. Pse arianët nuk e kishin caktuar më parë nëse ishin superiorë, ishte po aq e parëndësishme, sa edhe pyetja pse proletarietet kishin nevojë për intelektualë që t'i udhëzojnë, kur fitorja e tyre ishte e pashmangshme. Ky ishte një lloj problemi që duhet ta mendojnë mendimtarët. Por, duke qenë burra të veprimit dhe jo njerëz të mendimit, Stalini dhe Hitleri ndoqën ëndrrat e tyre me një saktësi shkencore, që u përçdrua vetëm në marrjen parasysh të domosdoshmërisë dhe jo të njerëzimit. Distanca mes mendimtarëve dhe arsyes së shëndoshë, nuk ka qenë kurrë më e madhe, se sa në shekullin e 20-të. Në vend që t'i zgjidhnin tensionet në mendimet e tyre, ata i hoqën mënjanë, me qëllim që të veprojnë. Dhe për t'i hequr mënjanë, ata i kthyen mjetet – pamëshirshmërinë – në qëllim.

Iluminizmi ishte epoka e ideve

Idetë që lihen në "punë të tyre", pa u

mbështjellë me një sens mirësie, nuk njohin kufij. Kjo ishte historia e pjesës më të madhe të shekullit të 20-të, formësuar nga Hitleri, Himmleri, Lenini dhe Stalini. Logjika është si një lojë shahu. Ti nuk shqetësohesh për fatin e një ushtari. Kështu edhe ideologjitë e shekullit të 20-të. Vdekja e një ushtari, nuk do të thoshte asgjë, krahasuar me ëndrrat. Dhe sa më të mëdha ishin ëndrrat për njerëzit, aq më pak të rëndësishëm ishin vetë njerëzit. Mendimtarët mishërojnë logjikën, dhe logjika e lëshuar nga frerët nuk njih mëshirë. Ata që dolën pas Stalinit nuk ishin më tiranë, por të mbijetuar, njerëz që i mbijetuan Stalinit duke bërë atë që duhej të bëhej, pa ëndrra dhe vetëm me frikë. Nikita Hrushovi dhe Leonid Brezhnevi ishin njerëz që donin të jetonin dhe të përparonin, por që nuk kishin ëndrra të mëdha, përtej mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik. Me idenë të humbur mes lumenjve të gjakut, mbijetesa ishte gjithçka që kishte mbetur; dhe këtu hyn në lojë gjeopolitika – arti ku mbijetojnë shtetet. Por gjeopolitika e lindur nga vizionet e mëdha është një gjë e cekët, dhe ajo nuk mund të mbante në këmbë Bashkimin Sovjetik. Bashkimi Sovjetik u rrëzua për shumë arsye, por më së shumti ishte nga lodhja dhe cinizmi. Me asgjë të mbetur për të besuar, ai u bë një version i dobët i një kombi të vërtetë. Ajo që doli në fund ishte

Nëna Rusi e Vjetër, e lodhur nga ëndrrat e saj, që as nuk besonte shumë në gjeopolitikë. Mësimi që duhet nxjerrë prej kësaj, është rreziku që paraqesin idetë kur hidhen si të vërteta absolute që kërkojnë logjikë të plotë, duke penguar kështu zbutjen prej mirësisë. Nëse idetë duhet të ndiqen me çdo kusht, atëherë çdo gjë që qëndron në rrugën e tyre duhet të shkatërrohet. Problemi është se në atë botë, njeriu që shtyp më fort, fiton. Kështu Marksit, intelektual i pafat, i cili e vuri në lëvizje gjithë këtë, u zëvendësua nga Lenini, gjysmë intelektual dhe gjysmë bandit, i cili u zëvendësua nga Stalini, tërësisht bandit. Distanca mes Marksit dhe Stalinit duket e madhe. Por në të vërtetë, ka një lidhje mes të dyve. Intelektualët mendojnë dhe kanë ide. Të vëna në praktikë, këto ide e humbasin paqartësinë e librarisë apo klasës dhe marrin një qartësi, e cila kërkon bindje. Intelektualit në fund i mungon vullneti për të imponuar frikën, që nevojitet për bindjen. Dhe kjo kërkon futjen në skenë të banditit. Revolucioni Rus ishte mishërimi i një ideje – një ide që u shndërrua në parti politike, sunduar nga një njeri që pretendonte autoritetin e logjikës dhe që vriste këdo që i dilte para. Shekulli i 20-të ishte i mbushur me njerëz të tillë. Sot, banditët kanë më pak ide, dhe kjo i bën më pak ambiciozë. Në shumicën e rasteve. (bota.al)

Kosova, Rusia, BE-ja dhe rikthimi i SHBA-së



Gurakuq KUÇI

Përfundimi i Luftës së Ftohtë, shpërbërja e BRSS-së, shkatërrimi i Jugosllavisë, vetëm sa përfundoi luftën ideologjike duke lënë vend për përplasje të reja gjeostrategjike dhe identitare. Luftërat që pasuan në vitet e '90, sidomos nga Serbia ndaj shteteve dhe krahinave ish-jugosllave, ishte luftë identitare e stilit nazist nga regjimi serb, e një ndihmë e plogësht nga e trullësura atëbotë Rusia për çështje gjeostrategjike. Hyrja në shekullin e ri, ishte edhe këndëllja e një Rusie të re, e cila luftoi kundër Gjeorgjisë duke ndarë dy provinca, kundër Ukrainës, duke marrë Krimenë dhe duke luftuar në Donbas, komplot për rrëzimin e pushtetit të Malit të Zi, hapjen e pikave ushtarake në Kosovën Lindore dhe furnizimi i Beogradit me artileri, forcimi i propagandës mediatike, forcimi i propagandës religjioze ortodokse, zbatimi i planeve të kaosit bazuar në idenë e gjeneralit Gerasimov, e shumë veprime të tjera.

Realisht, Rusia nuk po rikthehet, ajo vetëm po riaktivizohet, sepse ajo gjithmonë ka qenë në Ballkan, në Evropën Lindore e më gjerë, por që më shumë si humbëse se sa si fituese ndaj aleatëve dhe vendeve anëtare në NATO. Duke e kuptuar qartazi që me luftëra klasike, Rusia nuk mund të fitojë askund, me diplomaci megjithatë mbetet shumë më prapa karshi vendeve të perëndimit, me investime ekonomike prapë mbetet e dobët, dhe me sulmin ndaj Ukrainës ka dështuar South Stream-in, atëherë i është rikthyer një "diplomacie ushtarake të reprezaljes".

Para disa vitesh, kur NATO-ja fitonte terren me anëtarësime të reja, dukej se Rusia nuk kishte gjë kundër, por kur terreni filloi t'i ngushtohej, atëherë ajo u rikthye së pari me Gjeorgjinë për të ardhur deri në ditët e sotme me Krimenë dhe për pak Malin e Zi. Tani, Rusia konsideron dhe i përgjigjet çdo përfitimi të NATO-së dhe Perëndimit duke e llogaritur si humbje të Rusisë. Dhe kundërpërgjigja nëse nuk është reciproke, atëherë është edhe më fatale, pra reprezalje apo retorzion, apo siç thonë ata vetë: "Për çdo Moldavi, ka një Mal të Zi. Për çdo Ukrainë, ekziston një Serbi". Që mund ta vazhdojmë ne vetë, se "për çdo Bosnjë ka një Republika Serpska. Për çdo

ajne marrëveshjet e tyre speciale me BE-në, bashkë me kontributet përkatëse buxhetore, për së paku disa vjet përtej vitit 2021. Rezultati është që, pavarësisht se çfarë lloji Brexit dëshiron të arrijë Mbretëria e Bashkuar, çdo tërheqje e butë do të kërkojë pagesa buxhetore post-Brexit për BE-në. Pyetja e vetme është nëse këto pagesa do të kthehen të jenë të përherëshme, siç duhet të jenë nëse May kërkon me të vërtetë një "partneritet të thellë dhe special", apo do të vijojnë vetëm për 5-7 vjet, kohë që kërkohet për të negociuar marrëveshje tregtie pas një Brexit të ashpër.

Sido që të jetë, May duhet të pranojë se pagesat në buxhetin e BE-së do të jenë të pashmangshme për shumë dhe shumë vite pas Brexit. Më shumë se kaq, ajo duhet të kthejë këtë pranim në një ofertë afatgjatë financiare, të tillë që të mundësojë zhblokimin e bisedimeve për Brexit. (reporter.al)

Para disa vitesh, kur NATO-ja fitonte terren me anëtarësime të reja, dukej se Rusia nuk kishte gjë kundër, por kur terreni filloi t'i ngushtohej, atëherë ajo u rikthye së pari me Gjeorgjinë për të ardhur deri në ditët e sotme me Krimenë dhe për pak Malin e Zi

Kosovë, ka një Mitrovicë të Veriut", apo edhe më keq: "Për çdo Kosovë, ka një Estoni..."

Dhe sot ne gjendemi në mesin e ballafaqimit mes BE-së dhe Rusisë, ku përballja e këtyre të dyjave i shton kriteret Kosovës për liberalizim të vizave, për anëtarësim në BE, për anëtarësim në organizata tjera ndërkombëtare. Vendet e BE-së, kanë një diplomaci shumë më ndryshe se SHBA-ja, kjo e fundit është një motor që nuk zbrapset lehtë, detajet çdo herë punojnë në të mirë të saj, dhe përmban më shumë trimëri brenda diplomacisë së saj. Përderisa BE-ja pak ngjason me këtë dhe është një zonjë e vjetër në diplomaci, aq e vjetër dhe me përvojë diplomatike, sa diplomacia ia fut frikën vetë vendeve perëndimore dhe qendrore të BE-së, sepse vet diplomacia e tyre shpesh-herë ka qenë fatkeqësi për ta, për më keq BE-ja tani brenda vetes mban edhe "kuajt e Trojës" të Rusisë.

Këtë diplomaci erdhi koha që ta vuajë edhe Kosova, por jo e gjitha për fajin e BE-së, është faji ynë që për hir të interesave personale të disa politikanëve, për hir të amnistimit personal të disa politikanëve, për shkak të qyqarllakut dhe injorancës të shumicës së politikanëve, dhe për shkak të komplet dështimit të diplomacisë dhe gjithë MPJ-së si strukturë, që nga shpallja e pavarësisë, dhe e tillë vazhdon të mbetet edhe sot. Diplomacia nuk është shaka, e për më keq nuk fal dhe nuk ka amnisti, sepse shtetet nuk njohin Zot, mëshirë, libra të shenjtë dhe miq, por vetëm interesa.

SHBA-ja çdo herë ka qenë me ne, por kohëve të fundit më shumë ia la punët në duar BE-së, dhe kur kjo e fundit përdori plotësisht injorancën e të ashtuquajturve diplomatë dhe politikanë nga Kosova, jo rastësisht edhe mori vendimin që të bëhet pjesë e dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë. Andaj, edhe propozimi i Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, që Shqipëria të japë pasaporta për popullin e Kosovës, është një tendencë nga ai që të kërcënojë apo shpëtojë diçka nga gjithë këto veprime të gabuara që i ka bërë në kurriz të Kosovës. (tesheshi.com)

që në mënyrë realiste konsiderohet se mjafton për të arritur një marrëveshje mbi partneritetin tregtar të përherëshëm, atëherë këto kontribute do të arrijnë në të njëjtën masë me atë të kërkuar nga BE.

E dyta, oferta Britanike për mbështetje buxhetore mund të jetë një mjet i fuqishëm për krijimin e "marrëveshjes së thellë dhe speciale" me Europën të cilën May pretendon se është objektivi i saj fina. Deri muajin e kaluar, May shmangu përkufizimin e kësaj fraze, nga frika se mos krijon armiqësi me Eurofobët e vijës së ashpër brenda partisë së vet. Por në fjalimin e saj në Firence, May premtoi që bizneset Britanike të sigurojnë një nivel akese të përafërt me këtë që kanë sot në tregjet e BE-së, në shkëmbim të kontributeve kompensuese buxhetore. Dhe nëse propozimi i May për "një marrëdhënie të thellë dhe speciale" do të jetë tipari i përherëshëm i marrëdhënieve Britani-BE, kontributet

buxhetore do të duhet të jenë të përherëshme gjithashtu.

Por çfarë ndodh nëse May nuk është me të vërtetë serioze mbi këtë "marrëdhënie të thellë se speciale"? Po nëse objektivi i saj i vërtetë është që të kënaqë personat e vijës së ashpër brenda Konservatorëve duke shkaktuar një "ndarje të qartë" me BE? Edhe pas kësaj, Britania do të duhet të vijojë të paguajë kontribute për buxhetin për shumë vite, në rast se ajo dëshiron të arrijë një Brexit të rregullt dhe pa eksese.

Le të supozojmë se qëllimi final i Britanisë është të krijojë marrëdhënie krejt të reja tregtare globale pa asnjë privilegj tregtar special për BE-në. Këto marrëveshje të reja të tregtisë do të kërkojnë shumë vite që të negociohen, dhe deri sa ato të plotësohen, bizneset Britanike në mënyrë të dëshpërueshme do të përpiqen të shmangin dy trazira tepër të kushtueshme: një kur anëtarësia në BE të mbarojë në mars 2019

dhe një tjetër në cilëndo datë të ardhshme kur marrëveshjet e reja botërore të finalizohen dhe të hyjnë në fuqi.

Shmangia e trazirave të tilla të dyfishta është qëllimi i vërtetë i propozimit të Maj për një periudhë tranzicioni nga viti 2019 deri më 2021. Por arritja e këtij objektivi do të kërkojë që marrëveshjet ekzistuese të Britanisë me BE-në të vijojnë të mbeten në fuqi deri sa marrëveshjet e reja globale të jenë gati për t'u zbatuar. Kjo nënkupton që kontributet buxhetore të Britanisë të vijojnë deri sa marrëveshjet e reja globale të finalizohen.

Probabiliteti që bisedimet komplekse me disa dhjetëra vende të mund të plotësohen brenda vetëm dy viteve pas Brexit është jashtëzakonisht i vogël. Kështu, edhe nëse politikanët Britanikë dhe votuesit me të vërtetë dëshirojnë një Brexit të ashpër që përfshin ndarje të plotë me Europën, bizneset në Mbretërinë e Bashkuar do të kenë nevojë të ru-

SABIT BOCKU, PIKTOR

DIBRA, QYTET PA MUZE

Në periudhën mbi 40 vjeçare kam pasur mjaft ekspozita vetjake, mbi 25, më shumë në qytetin e Dibrës, por edhe në qytetet tjera të Maqedonisë, sidomos në atë perëndimore dhe dy ekspozita në qytetin e Peshkopisë, në Republikën e Shqipërisë. Me ekspozita kolektive kam marrë pjesë në Shkup, Gostivar, Tetovë etj. Me punimet e mia kam pasur sukses, ku edhe më kanë vlerësuar me diploma, mirënjohje, të cilat i ruaj në bibliotekën time. Jam marrë një kohë edhe me skenografi



Koha

Delvina KËRLUKU

Sabit Bocku i lindur në shkurt të vitit 1942 në Dibër, shkollën fillore e tetëvjeçare e kreu në vendlindje, në Dibër. Në vitin 1959/60 u regjistrua në shkollën e mesme Normale " Zef Lush Marku " në Shkup. Pasi e mbaroi Normalen, diplomoi në korrik të vitit 1963. Në shtator po të atij viti u punësua si mësues në fshatin Çegran të Gostivarit, ku edhe punoi një vit e tre muaj. Në vitin 1966 kthehet në Dibër dhe punësohet si mësues në fshatin Spas. Në vitin 1974 u regjistrua në Akademinë Pedagogjike të Artit Figurativ - drejtimi i pikturës. Më pastaj kalon nga shkolla periferike, në shkollën qendrore "Liman Kaba" të fshatit Sollokiç. Në vitin 1979 punësohet në shkollën tetëvjeçare "Bashkim Vëllazërim", po ashtu edhe në shkollën e mesme " Zdravko Çoçkovski ". Gjatë kësaj periudhe ka botuar dy libra: "Arkitektura karakteristike dhe veshja popullore e Dibrës të Madhe" dhe "Oraniku - Sheri i Dibrës, toponimet dhe mikrotoponimet". Si arsimtar i artit figurativ vazhdon punën deri më vitin 2005. Në shtator po të këtij viti u pensionua. Ai thotë: "Tani jam në pension, por pikturën nuk e lë kurrë".

KOHA: Çdo njeri ka historinë e vet personale dhe rrugën e vet drejt arritjeve. Cila është historia Juaj në rrugëtimin e botës së artit?

BOCKU: Shkollën fillore tetëvjeçare e mbarova në Dibër. Qysh kur isha i vogël më ka shkuar për qejfi lënda e vizatimit. Më kujtohet në klasën e katërt, në fillore, në kapakët e fletoreve vizatoja fruta, shtëpi, pemë, zogj dhe kafshë. Në tetëvjeçare si arsimtar i artit figurativ, kam pasur Zhivko Sarevskin. Si fëmijë një rast më ka lënë mbresë që e kujtoj edhe sot e kësaj dite. Para shtëpisë sime në lagjen Dormallë kishte një derë të madhe të punuar me dërrasa plepi që si material është i butë, sidomos për të vizatuar. Unë, si fëmijë, ndoshta kam qenë në klasën e gjashtë, aty e vizatova një figurë nga mitologjia greke, Herkulesin, që më herët e kisha pa në kinema. Ai ishte njeri i fortë, me muskulaturë të zhvilluar, me kraharor të gjerë dhe mbi të gjitha trim. Në moment kur kam qenë duke vizatuar kalon një patrullë policore. Njëri prej tyre ishte shqiptar, kaluan dy tre hapa, larg derës, mandej

njëri u kthye mbrapa e më tha: " çfarë bën aty ". Ia mbaj mend emrin policit, që tani është i ndjerë. Iu përgjigja, dukë i thënë se vizatoj. Ai me inat ma ktheu: largohu prej këtu se do të të çoj në stacionin policor. Megjithatë, unë iu përgjigja përsëri se nuk jam duke bërë gjë të keqe - vizatoj. Në vitin 1959/60 u regjistrua në shkollën normale " Zef Lush Marku ", në Shkup. Profesor të vizatimit e kam pasur Spase Kunovskin - i ndjerë tani. Në korrik të vitit 1963 diplomova. Në shtator po të atij viti u punësua si mësues në fshatin Çegran të Gostivarit. Më pastaj, në vitin 1966, në shkollën periferike në fshatin Spas, që ishte nën Shkollën qendrore "Liman Kaba", në fshatin Sollokiç. Në vitin 1975 kalova në Shkollën qendrore "Liman Kaba", pasi e mbarova akademinë pedagogjike, dega e artit figurativ, në klasën e profesor Rexhep Ferrit - dega pikturës. Këtu me rastin e patronatit të shkollës tetëvjeçare, hapa ekspozitën e parë me punimet e mia. Në vitin 1979 u punësua në Shkollën tetëvjeçare "Bashkim Vëllazërim" në Dibër, po ashtu edhe në shkollën e mesme " Zdravko Çoçkovski ", në Dibër. Në gjimnazin e Dibrës punova deri më vitin 1994. Për herë të parë hapa ekspozitë personale të artit figurativ në qytetin e Dibrës. Mandej, në

bashkëpunim me drejtorin e atëhershëm, Lutfi Marku, andej kah viti 1983/84, unë formova një koloni të piktorëve që kishin talent. Kolonia vazhdoi disa vite dhe pastaj u shua.

KOHA: Z.Bocku, sikur nuk kanë kaluar gjithë këto vite të rrugëtimin kombëtar. Sepse, Ju na e bëni më të freskët historinë e popullit tonë, duke pikturuar figurat tona kombëtare. Pse pikërisht jeni ndalur në histori. Mos vallë "luftoni" padrejtësitë e bëra ndaj historisë sonë kombëtare?

BOCKU: Pikërisht jam ndaluar në këtë drejtim, se shqiptarët janë i vetmi komb që është i vuajtur, i torturuar, i asimiluar, prandaj jam ndaluar në këtë fushë, duke paraqitur personazhe të ndryshme, që kanë luftuar për të drejtat e kombit tonë. Së pari, do të nisem nga lashtësia. Në si popull jemi më të vjetër në Gadishullin Ballkanik. Fillojmë nga Pellazgët që pasardhësit e tyre janë Ilirët. Një pjesë të historisë së tyre e përvetësojnë grekët. Këtë që e them, e kanë thënë edhe shumë shkencëtarë, arkeologë, lingvistë e shumë të tjerë që janë marrë me çështjen e Pellazgëve. Ata bazohen në fakte shkencore që kanë lenë gjurmë gjatë periudhave të ndryshme, duke filluar nga to-

ponimet, emrat, ndërtimet e objekteve me mure të trasha dhe gurë të mëdhenj, punuar thatë pa llaç (mallter), që sot e kësaj dite ato ekzistojnë dhe quhen mure pellazgjike. Pasardhësit e tyre janë Ilirët të përhapur në tërë gadishullin Ballkanik. Pastaj i tërë territori Ilir bie nën sundimin e Perandorisë Romake, edhe pse në sundimin Romak emri Ilir përdoret ILIRIA. Një nga perandorët e kësaj perandorie ka qenë me prejardhje Ilire (DIOKLECIANI). Ekziston pallati i tij DIOKLECIANIT në Split të Kroacisë. Perandoria Romake në fund të shekullit të III pas Krishtit ndahet dhe formohet edhe Perandoria Bizantine. Si perandor vjen Kostandini i Madh, kurse qendra e kësaj perandorie vendoset në Kostandinopol (Stambolli i sotëm). Gjatë kësaj periudhe 1000 vjeçare shumë fise Ilire u asimiluan. Edhe pse Justiniani andej kah fundi i shekullit të V në asnjë mënyrë nuk lejon që sllavët e ardhur nga Karpatet ta kalojnë lumin Danub, pas vdekjes të tij ata filluan të depërtojnë në jug dhe andej në fund të shekullit të VI pas Krishtit e mbuluan Gadishullin Ballkanik. Me ardhjen e tyre, filluan të asimilojnë vendasit, t'i ndryshojnë emrat e vendeve, lumenjve, maleve dhe u zëvendësua me emra sllave. Sllavët erdhën si paganë, por më vonë, nga

shekulli i VIII, kalojnë në kristianizëm - ortodoks. Një pjesë e banorëve të Gadishullit Ballkanik, sidomos pjesa veriore, i kanë takuar besimit katolik, kurse pjesa jugore asaj ortodokse. Me ardhjen - pushtimin e perandorisë osmane, Gadishullit Ballkanik, shumë fise Ilire filluan të kalonin në besimin islam. Sipas autorëve të mesjetës, emri Ilir filloi të zbehet dhe zëvendësohet me termin Arbër. Pjesa jug perëndimore e Gadishullit Ballkanik është quajtur Arbëri. Marin Barleti në veprën që ka shkruar mbi jetën dhe veprën e heroit tonë kombëtar. Jeta e Arbërisë në sundimin e Perandorisë Osmane që mjaft e vështirë. Në sundimi e pesë shekujve e gjysmë, ishim më të diskriminuar, të torturuar. Pjesa dërmuese e popullatës pranoi fenë islame. Popujve tjerë tjera në Gadishullin Ballkanik iu mundësa hapja e shkollave në gjuhën e tyre, kurse për shqiptarët ishte e ndaluar shkolla, mësimi në gjuhën amtare. Kushtet e vështira, taksat e rënda, shërbimi ushtarak me vite të tëra, e detyruan popullin të ngrihej në kryengritje për të drejtat e tyre. Duke filluar nga Lidhja e Prizrenit, ku organizator i parë që Abdyl Frashëri, ndërkaq kryetar i Lidhjes së Prizrenit Iljaz Pash Dibra - Qoku. Kryengritjen e udhëheqin shumë patriotë, si Isa Boletini, Bajram Curi, Elez Jusufi, Idriz Seferi etj. Shumë patriotë luftuan me pushkë dhe me pendë për çështjen kombëtare, si Hasan Prishtina, Mihail Grameno, Çerçiz Topulli dhe Ismail Qemali, i cili shpalli Pavarësinë e Shqipërisë, më 28 Nëntor të vitit 1912. Por, uzurpatorët fqinj dhe grabitqarët, me ndihmën e fuqive të mëdha, në atë kohë i shpëputën pjesën më të madhe të tokave shqiptare dhe i ndanë një pjesë Malit të Zi, një pjesë Serbisë dhe një pjesë Greqia. Tani nga një sundim pesë shekullor, gjysma e popullit dhe trojet shqiptare ranë në një sundim më të egër, shfarosës dhe asimilues. Greqia shoviniste arvanitasit, një pjesë të besimit musliman i vrau dhe një pjesë i shpërnguli për në Turqi. Kurse arvanitët ortodoks i asimiloi dhe gjuhën shqipe ua ndaloi. Qëllimi kryesor në tablotë e mia është të lë gjurmë e të mos harrohet e kaluara, gjeneratat e reja të njoftohen më të kaluarën tonë.

KOHA: Shqiptarët kanë një identitet të qartë, i cili krijon siguri, krenari dhe nuk e kom-



plekson popullin tonë ndaj popujve të tjerë. Sa ju bën krenar kjo dhe cila është historia e paraardhësve tuaj?

BOCKU: Në pyetjen e dytë, për këtë folë gjerë e gjatë, ne shqiptarët si popull më i vjetër në Ballkan e di gjithë bota mbarë, se jemi pasardhësit e Ilirëve, identiteti i vulltosur në mënyrë shkencore nga shumë shkencëtarë, arkeologë dhe linguistë. Shumë shkrime të lashta gjuhëtare, arkeologë i zbrërthijnë nëpërmjet gjuhës shqipe p.sh. arkeologjia dhe historia me pre-jardhje shqiptare Nermine Vlora – Falaski, shumë shkrime në pllakat e mermerit apo argjilit të pjekur të zbuluar nga Etruskët, domethënien e tyre e zbrërthente vetëm nëpërmjet gjuhës shqipe. Të marrim Iliadën e Homerit që i këndon luftës së Trojës, e shkruar në greqishten e vjetër. Aty mund të shohim se 30 për qind ka fjalë të gjuhës shqipe. Kjo të jep të kuptosh se jemi popull shumë i vjetër dhe me identitet të pa kontestueshëm.

KOHA: Maqedonia është në fazën e një reforme të thellë për të ngritur nivelin e institucioneve kulturore në nivelin e kërkesave të menaxhimit evropian të monumenteve, muzeve dhe projekteve të zhvillimit kulturor. Ne, nuk duhet të kursejmë asgjë për forcimin e institucioneve tona të kulturës (kombëtare) shqiptare, për nxitjen e talentëve të reja dhe zhvillimin e burimeve kulturore. Në fakt, si qëndrojmë në këtë sferë?

BOCKU: Reformat nuk erdhën vetvetiu, inteligjenca dhe mbarë populli shqiptar në Republikën e Maqedonisë me këmbëngulje kërkuar të reformohen 'aparartet' shtetërore. Është më se e vërtetë se edhe Bashkimi Evropian dhe SHBA kanë pasur ndikim. Tani faktori politik shqiptar duhet me fakte dhe argumente të ndikojë në zhvillimin e institucioneve të kulturës të kombit shqiptar, t'i kundërvihet " ENCIKLOPEDIË " së popullit maqedonas, ku janë paraqitur fakte të shtrembëruara, pa argumente shkencore, në mënyrë tendencioze ta nënvlerësojnë kombin më të vjetër në Gadishullin Ballkanik. Na paraqesin si ardhacakë, çështje e vërteta, ata vetë janë ardhacakët në këtë rast. Ata "historianë" nga themelet e ledheve të huaja marrin gurët dhe duan të ndërtojnë vatan. Kjo është si ajo loja e fëmijëve, nga brollet e misrit ngrinin kulla deri në një lartësi dhe në moment kur vendoseshin trarët e pullazit, kulla rrëzohej, pra... ?! Sa i përket arsimit në gjuhën shqipe, ka një thënie: "Arsimi i shëndoshë, kombi i ditur". Kam edhe një vërejtje për faktorin politik shqiptar, sidomos atij dibran. Dibra në tërësi si krahinë, një ndër me të njohurat në Ballkan, që nga mesjeta deri në Luftën e Dytë Botërore, sot është i vetmi qytet pa muze. Ky është një turp i madh për ne dibranët. Në një ligjëratë të mbajtur në Pallatin e kulturës, në vitin 1995, profesori i ndjerë Skënder Rizaj thoshte : " Për të lexuar ngjarjet që kanë ndodhur në Dibër gjatë shekujve të kaluar, në qendrat e metrolopeve si Stambolli, Roma, Ragusa, Vjena, Londra dhe Parisi, duhet të lexosh mbi gjashtë muaj dokumente, shkrime etj". Sa i përket talentëve në përgjithësi të ne shqiptarët ka mjaftë, por duhet të krijohen kushtet. Në këtë drejtim ka disa shkaqe që mungojnë : E para dhe e vjetmja faktori politik shqiptar fle. Ai duhet rininë ta nxisë dhe ta stimulojë, veçmas talentet e reja. Qoftë ministër apo zëvendës, të mos rrinë duarkryq dhe me gojë të mbyllur në dikasteret e tyre, të jenë persona që e duan artin dhe kulturën. S'është mirë të udhëheqin ato re-

sore që s'ka lidhje me vendin e punës dhe të vendoset vetëm pse është partizan i partisë. Por edhe rinia, studentët, artistët, t'i lënë kafenet se do të na shkel rrota e historisë, atëherë do të jetë shumë vonë. Pra, fajin e kemi vetë ne!

KOHA: Përmes Etnokulturës dhe gjuhës tonë është ruajtur dhe forcuar më shumë se çdo gjë tjetër identiteti kombëtar. Ndërsa, përmes pikurave tuaja është ruajtur historia dhe tradita dibrane. Ta mbash gjallë traditën dhe historinë është vlerë?

BOCKU: Elementi kryesor që dallohet nga kombet tjera është GJUHA, zakonet, tradita, veshjet që identifikohesh si komb. Edhe unë në pikturat e mia veshjen kombëtare e kam paraqitur afro 75 për qind. Është me rëndësi që brezat e ardhshme jo vetëm ta dinë, por edhe ta shohin si e ka të kaluarën kombi shqiptar. Sot ajo ndryshon, nuk përdoren në veshjet e përditshme përveç koncerteve festive - vallet popullore etj. Unë them se kjo pasuri duhet të ruhet me fanatizëm në muzetë tona.

KOHA: Z. Bocku, keni promovuar punën tuaj përmes ekspozitave individuale dhe kolektive. Na tregoni më gjerësisht mbi ekspozitat dhe ku kanë shëtitur pikturat tuaja?

BOCKU: Për periudhën mbi 40 vjeçare kam pasur mjaft ekspozita vetjake, mund të them mbi 25 ekspozita, më shumë në qytetin e Dibrës, por edhe në qytetet tjera të Maqedonisë, sidomos në atë perëndimore dhe dy ekspozita në qytetin e Peshkopisë, në Republikën e Shqipërisë. Me ekspozita kolektive kam marrë pjesë në Shkup, Gostivar, Tetovë etj . Me punimet e mia kam pasur sukses, ku edhe më kanë vlerësuar me diploma, mirënjohje, të cilat i ruaj në bibliotekën time. Jam marrë një kohë edhe me skenografi. Në vitin 1979 grupi i dramës përgariti " NITËN " e Josip Relës. Për një periudhë dy dekadash bëra mbi 23 skena të dramave që janë shfaqur në Pallatin e kulturës në Dibër, madje edhe në Tetovë, Gostivar, në Koçan, në Prizren. Këtu drama "Nita" u vlerësua si për interpretimin e aktorëve, po ashtu edhe për skenografi na ndanë çmim të posaçëm dhe diploma.

KOHA: Shumë dekada u përkushtuat në mësimdhënie. Mund të na tregoni barrierat e arsimit, por edhe atë si student dhe mësimdhënës?

BOCKU: Çdo punë ka edhe peripecitë e veta. Gjithmonë lëmuar nuk shkon, puna në arsim është specifike, por humane. Së pari duhet ta respektosh punën, sidomos në arsim. Ke punë me qenie njerëzore - fëmijët duhet t'i përgatisësh për ardhmërinë. Arsimtari duhet të përgatitë planin vjetor, mujor, javor edhe ditor. Arsimtari është i detyruar që nxënësit në orën e mësimi të jenë të kompletuar me mjete që të zhvillohet normalisht mësimi dhe detyrat e dhëna të kontrollohen, mandej zhvillon njësinë e re metodike. Si studentë, t'ua them realitetin, gjithmonë shkoja në provim i përgatitur. Studimet i mbarova në afatin e caktuar.

KOHA: Nëse kthehemi në lagjen tuaj të fëmijërisë, çfarë kujtoni dhe çfarë nostalgji keni për atë botë?

BOCKU: Me thënë të drejtën, kushtet e atëhershme me këto të sodit kanë ndryshime të mëdha. Jeta në atë kohë ishte e varfër. Me shokët kur luanim, të themi futboll, topin e bënim prej leckash të futur në një çorap grash dhe i jepnim formën e rrumbullakët, luanim "vara" që kishin formën e katërkëndëshit me plloqa (pllakë e



rrafshët prej guri), luanim symbyllas, "bilembil", "peç", "pushkaria" etj. Atëherë nuk dinim çështje radio, për televizor as që kishim dëgjuar. Kurse sot, fëmijët shohin televizor, dinë ta përdorin kompjuterin, internetin etj. Fëmija 3 - 4 vjeçar di ta përdorë celularin, me ta mund të flasësh në të katërt anët e botës. Zhvillimi teknik është në kulm.

KOHA: Populli thotë se arti është dhunti e Zotit, që ia falë njeriut. Përveçse Ju e posedoni këtë dhunti, a është trashëguar edhe te djali. A është një ëndërr e juaj që të kalojë tek pasardhësit e tuaj arti?

BOCKU: Populli thotë, por edhe shkenca - Zoti, natyra i fal 1 për qind talent njeriut. Edisoni shkencëtar thotë: 99 për qind duhet punë që ta zhvillon talentin. Unë si piktor, djalit Dritanin, e përgatita dhe e orientova ta studiojë artin figurativ - drejtimi i pikturës. Ai tani punon si profesor i artit figurativ në shkollën nëntëvjeçare "Bashkim Vellazerim", por edhe mbesa ime Lorena e adhuron pikturën, ku edhe shumë piktura të klasës së parë i ruaj si kujtim.

KOHA: Arti luan një rol të veçantë në zhvillimet kulturore. Sa jeni vlerësuar për punën tuaj shumëvjeçare nga vendi juaj?

BOCKU: Arti në përgjithësi dhe arti figurativ në veçanti, është baza e një kulture të një kombi, që lë gjurmë të pashlyeshme, qoftë arkitektura, piktura, skulptura, muzika dhe filmi, janë vepra të pazëvendësueshme. Sa i përket vlerësimit të punës time, e hapi fletoren me përshtypje për pikturat ku edhe i kam ekspozuar... Shumë ardashës më kanë lënë shënimet e tyre, përshtypjet, ku edhe shpesh i lexoj dhe më rikthejnë në një kohë të qenë. Një shënim apo përshtypje e lënë, ka qenë dhe është vlerë. Aq më shumë, kur më zgjasin dorën njerëzit për punën që kam bërë dhe ata që afrohen të dinë e ta transmetojnë te publiku, për kontributin tim, pra mediat.

KOHA: Kurbeti, plagë e kamotshme. Sa ka lëshuar rrënjë në vatrën tuaj dhe sa ndikon në vendlindje, duke pasur parasysh se artisti kërkon publik?

BOCKU: Sa i përket kurbetit, ballkanasit në përgjithësi e kanë pasur si traditë, në veçanti shqiptarët - dibranët. Më parë ata kanë shkruar të punojnë në kurbet - gjinia mashkullore. Sa i përket trevës së Dibrës, ata si kurbetçinj më së shumti shkonin në Stamboll, Selanik dhe më vonë në vendet e tjera të Greqisë, që ishte në sundimin e Perandorisë Osmane. Dibranët kanë qenë të njohur në tërë ballkanin si muratorë, drugdhendës, bojaxhi dhe zbukurime të enterierit të banesave, etj. Kurse në stinën e pranverës kanë shkruar në kurbet, kanë punuar 5 - 6 muaj, në vjeshtë janë kthyer te familjet e tyre. Kurse tani, sidomos viteve të fundit, dibranet janë shpërndarë në shumë shtete të Evropës



perëndimore me terë familjen. Por, plaga më e madhe është ajo në SHBA - atje më nuk quhet kurbet, kane formuar familjet e tyre, kanë shtëpi, dyqane, biznese - kompani, kanë formuar kapitale, pasuri të patundshme me kushtet të mira jetese, shumica e tyre nuk kthehen më kurrë në vendlindje. Unë kam tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë, Antigonën,

e cila gjendet në Zvicër me burrin dhe dy fëmijët. Kurse djali i madh Blerimi, është në SHBA, i martuar dhe ka tre djem. Edhe pse është aq larg, të them realitetin, s'ka ditë që të mos na paraqitet në telefon. Kurse djali tjetër Dritani është i martuar dhe ka tre fëmijë dhe siç thash punon profesor i artit figurativ në shkollën nëntëvjeçare në Dibër.



Këshilltari politik për komunitete nga Zyra e BE-së në Kosovë, Stefano Gnoci, tha se rekomandimet e Këshillit Konsultativ për Komunitete duhet të merren seriozisht. Ai tha se BE-ja mbështet punën e këshillit si një partner të rëndësishëm



Orët luksoze të gjykatësve shqiptarë

Nën artikullin me titull "Orët luksoze të gjykatësve" gazeta gjermane "Süddeutsche Zeitung" nënvizon se një diplomat amerikan kërkon të dekriminalizojë drejtësinë në Shqipëri. Fjala është në artikullin e medias gjermane për diplomatin amerikan, ambasadorin e SHBA-së në Shqipëri, Donald Lu. "Qeveria shqiptare duhet t'i shpallë luftë kriminalitetit të organizuar, kërkoi Lu. Pas kësaj, diplomati u bë më konkret. "Katër klane mafioze kontrollojnë sot Shqipërinë. Gazeta gjermane shkruan se Shqipëria është kthyer në vitet e fundit në prodhuesin më të madh të drogës në Evropë dhe se baronët e drogës fitojnë miliarda. "Me këto para ata mundën të korruptojnë parlamentarë, prokurorë dhe policë", shkruan Süddeutsche Zeitung. Pas mandatit të dytë, kryeministri shqiptar, Edi Rama premtan se do

të fitojë luftën kundër kanabisit. Por Süddeutsche Zeitung nënvizon se "për ambasadorin amerikan këto tingëllojnë si fraza boshe. Nga java e kaluar ndodhet nën presion ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri për shkak të lidhjeve të dyshuara me bandën e drogës, që u ndoq me vite nga policia italiane. Socialistët në qeveri refuzojnë heqjen e imunitetit të tij". Pavarësia e gjyqësorit, lufta kundër korrupsionit dhe bosëve të drogës janë kthyer në një detyrë të rëndësishme për ambasadorin amerikan, Lu, shkruan gazeta "Süddeutsche Zeitung" duke theksuar se ai flet shumë hapur në gjuhën shqipe që e flet rrjedhshëm. Në një takim me gjykatësit ambasadori Lu është shprehur. "Nëse mbani një orë dore më të shtrenjtë se automjeti im i punës i korruptuar. Në takimin tjetër gjykatësit erdhën pa aksesoret luksoze".

Në konferencë, përveç përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë nga Kosova, marrin pjesë edhe përfaqësues të komuniteteve joshumicë nga Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia. Thaçi këtë forum e cilësoi në shërbim të bashkëpunimit rajonal dhe dialogut, që sipas tij, promovon Kosova, si dhe në funksion të shkëmbimit të ideve dhe praktikave më të mira për krijimin dhe zbatimin e politikave afirmative

Në organizim të Këshillit Konsultativ për Komunitete, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së presidentit të Kosovës, sot filloi konferenca një javore rajonale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve joshumicë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në hapjen e konferencës tha se Kosova është e përkushtuar në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore me të gjitha vendet e rajonit. Ai porosi-ti se në nivel rajonal mund të arrihet shumë më shumë drejt përmirësimit të komunikimit dhe bashkëpunimit mes shteteve dhe theksoi disa nga çështjet që mund të avancohen, të tilla si mundësimi i qarkullimit të lirë të qytetarëve dhe mallrave nëpër vendet e rajonit. "Për shembull, qytetarët e Kosovës nuk mund lirishtëm të lëvizin nëpër Bosnjë e Hercegovinë dhe anasjelltas, ndërsa është absurde ajo se mund të lehtë të lëvizin nëpër terri-

Absurde lëvizja nëpër Serbi, e jo nëpër BeH



torin e Serbisë se sa nëpër Bosnjë e Hercegovinë. Këto pengesa duhet tejkaluar", theksoi Thaçi. Presidenti kosovar tha se as malli nga Kosova nuk mund të transportohet lirisht nëpër vendet e rajonit. Ai vlerësoi se këto pengesa nuk duhet të ekzistojnë dhe se as nuk duhet të ketë nevojë për të ndërmjetësuar faktori ndërkombëtar në zgjidhjen e këtyre çështjeve. Në konferencë, përveç përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë nga Kosova, marrin pjesë edhe përfaqësues të komuniteteve joshumicë nga Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia. Thaçi këtë forum e cilësoi në shërbim të bashkëpunimit rajonal dhe dialogut, që sipas tij, promovon Kosova, si dhe në funksion të shkëmbimit të ideve dhe praktikave më të mira për

krijimin dhe zbatimin e politikave afirmative. Ai konstatoi se ky forum duhet të shërbejë në "gjetjen e një zgjidhjeje për prishjen e mureve që ende i kemi midis nesh". Ai gjithashtu theksoi se Kosova është një shembull i mirë për afirmimin e komuniteteve joshumicë, sepse siç tha ai, Kosova është ndërtuar mbi parimet kushtetuese të përfshirjes, barazisë dhe lirisë së çdo individi. Ai poashtu shtoi se komunitetet joshumicë janë të përfaqësuar në institucionet politike në vend dhe se ato kanë mundësi të garantuara për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e tyre demokratike e politike. Sipas tij, në Kosovë ekziston kuota për punësimin e pakicave në institucionet publike, për regjistrimin e studentëve nga komuniteti pakicë në uni-

versitetet publike, si dhe legjislaturë kundër diskriminimit të qytetarëve kosovarë. Këshilltari politik për komunitete nga Zyra e BE-së në Kosovë, Stefano Gnoci, tha se rekomandimet e Këshillit Konsultativ për Komunitete duhet të merren seriozisht. Ai tha se BE-ja mbështet punën e këshillit si një partner të rëndësishëm, i cili është përfshirë në raportin mbi zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Duke kryesuar Këshillin Konsultativ për Komunitete të Kosovës, Gazman Salieviç, theksoi se ka hapa pozitive në integritimin e komuniteteve shqiptare në Kosovë. Mirëpo, ai shtoi se ende ka probleme dhe Këshilli Konsultativ ekziston për të promovuar dhe avokuar që të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligje të zbatohen.

Schmid ia rikujton Haradinajt demarkacionin

Schmid ka u ka bërë thirrje përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës që sa më par t'i kryejnë obligimet që kanë marrë përsipër, përfshi edhe reformat e nevojshme, në mënyrë që vendi të ecë drejt Bashkimit Evropian. Kosova është Evropë dhe e ardhmja e Kosovës është me Bashkimin Evropian, ka deklaruar ajo

Ratifikimi i Marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, mbetet kusht që duhet plotësuar sa më parë, në mënyrë që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet lëvizja pa viza në Zonën Shengen, ka deklaruar Sekretarja e Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Helga Schmid. Këto komente, ajo i ka bërë në Prishtinë gjatë një konference për media e shoqëruar nga kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj. Ajo,

përveç Haradinajt, ka takuar edhe presidentin Hashim Thaçi, kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli dhe përfaqësuesit politikë të opozitës. Schmid ka u ka bërë thirrje përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës që sa më par t'i kryejnë obligimet që kanë marrë përsipër, përfshi edhe reformat e nevojshme, në mënyrë që vendi të ecë drejt Bashkimit Evropian. Kosova është Evropë dhe e ardhmja e Kosovës është me Bashkimin Evropian, ka deklaruar ajo. "Mesazhi im i sotëm, si për përfaqësuesit në Qeveri ashtu edhe ata në opozitë është që të shfrytëzoni momentumin, mendoni në mënyrë strategjike dhe shfrytëzoni mundësitë që t'i bëni përparimet e duhura që të afroheni me BE-në sa më shpejt që është e mundur", tha Schmid. Ajo rikujtoi fjalët e komisionari Jean-Claude Juncker se dyert e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor janë të hapu-



ra kurdo që këto shtete t'i plotësojnë kushtet për anëtarësim. Schmid, u ndal edhe te procesi i liberalizimit të vizave, si një prej çështjeve që vazhdon të mbetet e pazgjidhur në raportet e Kosovës me vendet e Bashkimit Evropian. Ajo tha se Kosova, duhet t'i plotësojë kriteret, duke ratifikuar Demarkacionin me Malin e Zi. "Ne gjithashtu e dimë se sa i rëndësishëm është liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Prandaj, është esenciale që au-

toritetet të përmbushin kushtet e mbetura për liberalizimin e vizave dhe në veçanti në ecjen përpara me Marrëveshjen për demarkacionin të kufirit me Malin e Zi, që është absolutisht çështje kryesore, dhe po ashtu lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të vazhdojë", u shpreh Schmid. Ndërkaq në lidhje me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbinë, të lehtësuar nga BE-ja, ajo tha se të dyja vendet duhet të avancojnë për të

mirën e stabilitetit në rajon. "Dialogu po jep rezultatet e veta dhe ashtu siç e kemi parë këtë javë është zbatuar Marrëveshja për drejtësinë dhe ky ishte një hap i rëndësishëm përpara. Më lejoni që t'ju konfirmoj se përfaqësuesja e lartë e BE-së, Ferica Mogherini është plotësisht e përkushtuar për fazën e re të dialogut", tha Schmid. Ajo tha gjithashtu se edhe implementimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian ka një rëndësi të madhe dhe, sipas saj, absolutisht është e nevojshme që të zbatohet. Implementimi i kësaj marrëveshjeje ka të bëjë me ndryshimet pozitive për të ardhmen e Kosovës. "Kjo marrëveshjeje ka të bëjë veç tjerash me standardin e jetës, përmirësimin e jetës, çka nënkupton më shumë investime dhe me shumë vende pune", tha Schmid. Në anën tjetër, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se Kosova

është e vendosur në zbatimin e detyrave që i janë caktuar. "Dinamika e Kosovës me BE-në po intensifikohet. Mendoj se edhe takimi i sotëm me zonjën Schmid që është Sekretare e Përgjithshme vërteton edhe rëndësinë e kësaj dinamike, por është edhe një shtyrje për një punë më intensive me zbatimin e agjendës evropiane për Kosovën, që fokusohet në reforma të përgjithshme, forcimin e rendit dhe ligjit, pra që ka në fokus luftën kundër korrupsionit dhe krimit në vend, e njëkohësisht reformën ekonomike që e kemi si detyrë të përbashkët të dakorduar", tha Haradinaj. Sekretarja e Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Helga Schmid, është takuar me Presidentin e Kosovës Hashim Thaçi, kryetarin e Kuvendit Kadri Veseli, por edhe përfaqësuesit e partive politike opozitare të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje.



Indiferenca përballë gjenocidit

Javën e kaluar, një grua Rohingya u tha gazetarëve se si ushtarët e Mianmarit e kishin prerë me thikë në fytyrë, ia kishin marrë foshnjën që qante me dhunë nga krahët dhe e kishin hedhur në zjarr; ndërsa fëmija digjej, ata e përdhunonin në grup. Ne nuk mendojmë se ia vlen kostoja për të bërë ndërhyrje të tilla, kështu që nuk bëjmë asgjë. "Dhe kur bëjmë këtë zgjedhje, nxjerrim zbuluar "Kurrë më!", si gënjeshtër që ka qenë gjithmonë"

Pas holokaustit, pjesa më e madhe e botës perëndimore adoptoi sloganin "Kurrë më!" Por, zotimi ynë kolektiv për të ndaluar gjenocidet ka qenë gjithmonë, më shumë teorik se sa praktik, siç po e shohim edhe një herë në Mianmar (gjithashtu e njohur si Birmani). Dëbimi i dhunshëm i myslimanëve Rohingya nga atdheu i tyre ishte brutal, me mijëra njerëz të masakruar dhe qindra mijëra njerëz që iknin nga kufiri në kampet e mjerë në Bangladesh. Javën e kaluar, një grua Rohingya u tha gazetarëve se si ushtarët e Mianmarit e kishin prerë me thikë në fytyrë, ia kishin marrë foshnjën që qante me dhunë nga krahët dhe e kishin hedhur në zjarr; ndërsa fëmija digjej, ata e përdhunonin në grup. "Ka vetëm një mënyrë për të ndaluar vazhdimin e akteve të gjenocidit", siç është ky, të cilët përsëriten herë pas here në të gjithë botën: "zbatimi i forcës ushtarake amerikane". Por publiku amerikan ndihet i rrasëkaptur nga ndërhyrjet e kaluara jashtë vendit, dhe nuk ka interes në dërgimin e trupave ose shpenzimin e parave, për të ndaluar mizoritë masive në Azinë Juglindore, Afrikë ose Lindjen e Mesme. Ne nuk mendojmë se ia vlen kostoja për të bërë ndërhyrje të tilla, kështu që nuk bëjmë asgjë. "Dhe kur bëjmë këtë zgjedhje, nxjerrim zbuluar "Kurrë më!", si gënjeshtër që ka qenë gjithmonë". (bota.al)





Mark Zuckerbergu ka nisur një tur apolojish në një përpjekje për të rifituar besimin e publikut. Ai ka shpallur reforma që do të sigurojnë se platforma e tij nuk do të përdoret për të kompromentuar procesin demokratik

Mediat janë gjuhëzuar përballë incentivit ekonomik në përpjekje për të zgjidhur problemin e përhershëm të paaftësisë paguese, pa pasur mundësinë për të rritur numrin e lexuesve, mediat lokale dhe rajonale nuk arrijnë dot të gjenerojnë të ardhurat e mjaftueshme që të mbijetuar

Pas muajsh të tërë duke futur hundët në jetët e këshilltarëve të Donald Trumpit, hetimi i qeverisë federale për ndërhyrjen e rusëve në zgjedhjet amerikane të vitit që kaloi, tashmë ka vënë në shënjestër Facebook-un. Dy javë më parë, kompania e mediave sociale u dorëzoi më shumë se 3000 reklama investiguesve të Kongresit, pasi u zbulua në muajin shtator se persona të lidhur me Rusinë kishin blerë 150 mijë dollarë reklama, të cilat u shfaqën në platformën e Facebook në verën e vitit 2015.

Reklamat nuk mbështesnin apo i kundërviheshin kandidatëve specifikë, por ato gjithsesi përqipeshin të ndiznin më shumë debatet në lidhje me imigrimin, racën dhe seksualitetin. Në një reklamë shfaqej një grua me ngjyrë që qëllonte me pushkë, të tjera përfshinin ndjenja pro LGBT dhe anti muslimane.

Facebook thotë se të paktën 10 milionë amerikanë janë ekspozuar ndaj këtyre reklamave – ndonëse disa analistë të mediave sociale thonë se është shifër e mbivlerësuar – teksa qëllimisht ishin shënjestruar shtete të pasigurt për t'u fituar në zgjedhje, si Miçigani apo Uiskonsini.

Për shkak të natyrës politike të kësaj historie, si dhe grindjeve partiake që e kanë pasuar atë, detajet e këtij kapitulli të fundit duhet që të ndahen nga konteksti në të cilin ndodhën. E pranon apo e refuzon faktin se një fushatë e sponsorizuar nga Rusia në mediat sociale ndikoi në rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2016, mjetet e fuqishme që e bënë të mundur një fushatë të tillë, kanë ndikuar negativisht mbi të gjithë ne – dhe janë ogur i keq për të ardhmen.

Realiteti është kthjellues. Demografia në qytete dhe shtete të veçanta u synua sistematikisht nga një entitet i huaj. Kjo u realizua nëpërmjet përdorimit të mjetit të mikro-targetimit në reklama, nga ana e Facebook-it, një algoritëm i mundësuar përmes një thesari të dhënash, që gjenerohen nga aktiviteti personal i 200 milionë përdoruesve të Facebook-it në SHBA.

Veprime të tilla si faqet e vizituara, pëlqimi i postimeve dhe ndarja e artikujve të lajmeve ndihmojnë Facebook-un që të ndërtojë preferenca të hollësishme të profilit të përdoruesit. Kompania e mediave sociale e monetizon këtë informacion, duke

Realiteti i medias në ditët e sotme



Si e "vrau" Facebook-u gazetarinë cilësore



renditur përdoruesit në kategori që pastaj mund të vihen në shënjestër nga reklamuesit. Duke zgjedhur thjesht demografinë që dëshiron të arrijë – p.sh. "konservatorë", "pronarë shtëpish", "teksanë", një entitet mund të sigurojë që reklamat e tij të shihen nga audiencia që ka më shumë gjasa të ndërveprojë me përmbajtjen.

Një efikasitet i tillë nuk ka kaluar pa u vënë re nga komuniteti i biznesit, pasi që kompanitë e mëdha dhe të vogla janë bërë të varura nga ky mjet, për të promovuar produktet dhe shërbimet e tyre. Ndërsa fuqia dhe sofistikimi i algoritmit ka sjellë dominimin e Facebook-it në reklamat në celularë dhe mediat sociale, gjigandi teknologjik mbetet ende lojtari i dytë më i madh në tregun e reklamave dixhitale: Google, përmes reklamave në kërkime, siguron një pjesë edhe më të madhe. Të dy kompanitë kanë më shumë se 60 për qind të tregut të reklamave, prej 83 miliardë dollarësh këtë vit, duke përfshirë 99 për qind të të gjithë rritjes së reklamave digjitale.

E ndërkohë që ky dominim ka sjellë sasi të paimagjueshme të ar-

Veprime të tilla si faqet e vizituara, pëlqimi i postimeve dhe ndarja e artikujve të lajmeve ndihmojnë Facebook-un që të ndërtojë preferenca të hollësishme të profilit të përdoruesit. Kompania e mediave sociale e monetizon këtë informacion, duke renditur përdoruesit në kategori që pastaj mund të vihen në shënjestër nga reklamuesit. Duke zgjedhur thjesht demografinë që dëshiron të arrijë – p.sh. "konservatorë", "pronarë shtëpish", "teksanë", një entitet mund të sigurojë që reklamat e tij të shihen nga audiencia që ka më shumë gjasa të ndërveprojë me përmbajtjen.

hurash për Facebook-un, si dhe kompaninë-mëmë të Google, e quajtur "Alphabet", rritja e këtij duopoli të reklamave digjitale ka pasojë më të errëta për industrinë e medias. Duke "kruajtur" atë që mbetet nga një treg gjithnjë e më i tkurrur i reklamave, botue-

sit online, të privuar nga abonentët me pagesë, gjithnjë e më shumë janë të detyruar të bëjnë kompromis me bindjet e tyre editoriale, në ndjekje të pa-pushimtë të trafikut në internet. Klikimet dhe shikimet janë, në fund të fundit, malli më i vlerësuar

në ekonominë tonë të vëmendjes, e cila është e nxjitur prej reklamave. Dhe prioritizimi i këtyre qëllimeve ka ushqyer një mentalitet editorial, që po zvogëlon me shpejtësi cilësinë e "sheshit publik".

Kjo dinamikë mund të ilustron më qartë nga përvoja e kryeredaktorit Franklin Foer të "New Republic". E ngritur në krye të listës së revistave, pasi bashkë-themeluesi i Facebook, Chris Hughes, e bleu atë në vitin 2012, kjo ishte një revistë të cilën Foer, idealist për qëllimin e punës së tij, mezi priste ta drejtonte. Fatkeqësisht, ai zbuloi shumë shpejt se vizioni i tij nuk përputhej me modelin e biznesit që Hughes kërkonte të implementonte.

Duke devijuar tërësisht nga karakteri kritikues i revistës, "New Republic", nën vëzhgimin e ngushtë të Hughes, iu nënshtrua kërkesave të tregut dhe filloi të publikonte dozën ditore të "lajmeve sensacionale" në përpjekje për të rritur numrin e klikimeve dhe për të tërhequr vëmendjen e reklamuesve.

Foer, i cili tashmë shkruan për "The Atlantic" thotë: "Shefi im i vërtetë ishte Chartbeat, një faqe

që i tregon gazetarëve dhe redaktorëve rezultatet në kohë reale të trafikut të internetit, duke evidentuar lexueshmërinë për çdo artikull. Chartbeat dhe faqe të tjera si kjo, kanë marrë peng virtualisht çdo revistë, gazetë apo blog. Me njësitë matëse të tyre, asnjë artikull nuk kap trafikun e mjaftueshëm të internetit dhe mund të përmirësohet gjithmonë me një titull më të mirë, një qasje më të mirë ndaj rrjeteve sociale, subjekt më të mirë apo argumentim më të mirë. Si një menaxher që të qëndron mbi kokë me kronometër, Chartbeat qëndron tashmë mbi kokën e çdo newsroom-i". Foer zbuloi se kërkesa në internet favorizonte lajmet sensacionale, jo ato kritike, lajmet bombastike, jo analizat dhe komentet.

Me një shikim të shpejtë në newsfeed-in e çdokujt në Facebook mund të kuptohet se ky është realiteti i medias në ditët e sotme dhe ideologjive politike.

Ndërkohë që mediat janë gjuhëzuar përballë incentivit ekonomik në përpjekje për të zgjidhur problemin e përhershëm të paaftësisë paguese, pa pasur mundësinë për të rritur numrin e lexuesve, mediat lokale dhe rajonale nuk arrijnë dot të gjenerojnë të ardhurat e mjaftueshme që të mbijetuar.

Gazetari Jack Shafer, duke shfrytëzuar të dhënat e mbledhura nga kolegu i tij Tucker Doherty, eksploroj këtë dinamikë në një artikull të Politico dhe deklaroi se forcat që shtynjë tregun mediatik kanë krijuar "fluskën e medias".

Ashtu siç pritet, në një botë që e përdor letrën gjithmonë e më pak, gazetarët dhe shkruar duket e destinuar të zhduket.

Punësimi në gazetatat e përditshme dhe të përjavshme ka rënë me më shumë se 60 për qind në janar të vitit 2017.

Rritja e jashtëzakonshme e punësimit në gazetarinë dixhitale e ka eklipsuar plotësisht këtë rënie, por vetë gazetarët dixhitale është duke përjetuar një tjetër lloj vdekjeje, atë të substancës dhe etikës së gazetarisë.

Lufta për klikime po i kthen dalëngadalë gazetarët në "tregtarë" të lajmit.

Mes rritjes së trysnisë nga Kongresi, Mark Zuckerbergu ka nisur një tur apolojish në një përpjekje për të rifituar besimin e publikut. Ai ka shpallur reforma që do të sigurojnë se platforma e tij nuk do të përdoret për të kompromentuar procesin demokratik. Por Zuckerbergu nuk mund t'i shpëtojë faktit se efica dha dhe sofistikimi i mjetit që ai zhvilloi, ka kontribuar për denigrimin e medias sonë. Ndoshhta rreziku më thelbësor ndaj demokracisë nuk është thjesht "keqpërdorimi" i atij mjeti, por vetë ekzistenca e tij dhe pushteti që ka fituar. (THE AMERICAN CONSERVATIVE)





Në fillim, vrulli i krijuar prej Luterit vazhdon të shtohet. Me ndihmën e shtypshkrimit të lëvizshëm, i shpikur nga Johannes Gutenberg në vitin 1450, ai shpejt shkruan, kopjon dhe shpërndan këtë koleksion idesh, që sfidojnë indulgjencat në të katër anët e vendit

Gjermania dhe bota protestante janë në mesin e "Festivalit të Reformimit" më të madh të të gjitha kohërave. Që nga 31 tetori 2016, festimet kanë vazhduar pa ndalim, për të shënuar ngjarjet revolucionare që filluan në këtë ditë, në vitin 1517. Një mësim i vogël në histori: Murgu Martin Luter (1483 – 1546) është i zhgënjyer nga praktika e Kishës Katolike për shitjen e indulgjencave, që i lejon njerëzit të blejnë shpëtimin shpirtëror. Ai e konsideron praktikën krejtësisht të gabuar në aspektin teologjik. Studimi i Biblës i ka lënë bindjen e palëkundur, se një mëkatar që beson në një Perëndi të gjithëfuqishme dhe absolute, shpaguehet në sytë e Perëndisë vetëm nëpërmjet këtij besimi dhe mëshirës së Zotit – dhe jo përmes parave dhe veprave të mira. Luteri është i bindur se ky është thelbi i mesazhit të krishterë. Rrjedhimisht, besimtarët mund t'i drejtohen krijuesit të tyre drejtpërdrejt, nëpërmjet lutjes. Ata nuk kanë nevojë as për kishën, as për priftin si një ndërmjetës – një ide radikale që thyen fuqinë e Kishës Katolike, duke filluar me doktrinën e saj fetare.

E gjitha lidhet me pushtetin

Konkluzionet e Luterit hapin derën për liri të reja dhe të paimagjinueshme. Por dekadat që pasuan "Nëntëdhjetë e Pesë Tezat" e tij të famshme, që thuhet se u gozhduan në derën e Kishës së Vittenbergut më 31 tetor 1517, e bëjnë të qartë se Kisha nuk është në asnjë mënyrë, e gatshme të heqë dorë nga pushteti i saj, pa luftë. Në fillim, vrulli i krijuar prej Luterit vazhdon të shtohet. Me ndihmën e shtypshkrimit të lëvizshëm, i shpikur nga Johannes Gutenberg në vitin 1450, ai shpejt shkruan, kopjon dhe shpërndan këtë koleksion idesh, që sfidojnë indulgjencat në të katër anët e vendit. Përveç kësaj, piktori me banim në Vittenberg, Lucas Cranach i Madhi dhe djali i tij me të njëjtin emër, i japin Reformimit fytyrë, përmes portreteve të Martin Luterit, si dhe përmes përshkrimeve të bashkatdhetarëve të teologut. Vittenberg është epiqendra e një vale të mendimit të ri, ndikimet e të cilit arrijnë deri në Romë. Në qershor të vitit 1518, fillon një gjyq për herezi kundër Luterit dhe disa muaj më vonë në Augsburg, i dërguari papnor, Kardinali Thomas Cajetan merr në pyetje refor-

Histori

Revolucioni i guximshëm i Martin Luterit



matorin, i cili me këmbëngulje refuzon të heqë dorë nga idetë e tij. Vitin e ardhshëm Karli V (1500-1558) bëhet perandori i ri. Ai është një kundërshtar tjetër i Luterit, që e sheh veten si mbrojtës të Kishës ekzistuese.

Shkrime të rëndësishme

Murgu rebel, i cili ende mendon se mund të reformojë Kishën Katolike, harton tre tekste kryesore të reformimit në vitin 1520. Më i rëndësishmi, "Për lirinë e një të krishterit", është pak a shumë një ligj themeltar, e që ndonjëherë mund të lexohet si një nxitje për revolucion. Luteri përmbledh kuptimin e jetës së krishterë në dy teza: "Një i krishterë është zotëruar i lirë i çdo gjëje, dhe nuk i nënshtrohet askujt. Një i krishterë është një shërbëtor i të gjithëve, i nënshtroar ndaj të gjithëve". Këto fjalë e bindin një pjesë të madhe të popullatës që dëshiron lirinë: lirinë nga frika e vdekjes, nga indulgjencat dhe detyrimet e tjera financiare, lirinë nga represionet prej atyre që janë më lart. Por Luteri, i cili përdor termin "liri" në një kuptim thjesht teologjik, ka një kuptim krejtësisht të ndryshëm të lirisë. Ai buron nga Apostulli Pal në Bibël. Sjellja themelore e njeriut nuk është e lirë, por më së shumti ndikohet, ose nga Djalli dhe mëkati, ose nga Krishti dhe mirësia. Luteri dëshiron të emancipojë njerëzit duke i kthyer ato drejt Krishtit. Ai kundërshton radikalizimin politik dhe rebelimin e armatosur.

Kundërgoditja e Perandorisë

Tezat provokative, shkrimet e reformimit, re-

fuzimi kokëfortë për revokimin e ideve – është shumë për Papën Leoni X, i cili në janar 1521 shkëqsheron Luterin. Në prill të po atij viti, Luteri duhet të mbrohet para perandorit. Në fjalimin e tij të famshëm të 18 prillit, reformatori deklaroi se ai do të tërheqë mbrapsht ato fjalë, vetëm nëse faktet biblike mund t'i përgënjeshtrorë ato, dhe ai thekson se nuk mund të veprojë kundër ndërgjegjes së tij. "Ja ku jam, Perëndia më ndihmoftë, Amen", e përfundoi ai fjalën e tij. Perandori Karli V e shpall të jashtëligjshëm dhe ndalon shkrimet e Luterit.

Kohë produktive në Vartburg

Luteri nuk duhet të presë gjatë për ndihmë. Bashkatdhetari i tij Frederiku III, princ i Saksonisë, bën të mundur që i burgosuri të rrëmbehet gjatë kthimit nga Vorms dhe të sillet në Kështjellën e Vartburgut, ku shkruan nën një pseudonim. Luteri përdor këto 10 muaj për të hartuar shkrime të shumta, që përcaktojnë më tej çështjet e Reformimit. Ai gjithashtu bëhet personi i parë që përkthen Dhiatën e Re, nga greqishtja e lashtë, në gjermanisht. Deri në atë pikë, kishin ekzistuar më shumë se 70 versione, ku të gjitha ishin bazuar në tekstin latin, edhe ai vetë një përkthim i mbushur me pasaktësi. Përkthimi i Luterit, i shtypur në vitin 1522, është një kryevepër gjuhësore – dhe një bestseller.

Theske të reja

Pavarësisht statusit të tij të jashtëligjshëm, Luteri kthehet në Vittenberg në mars të vitit 1522, ku i hyn projekteve të

ndryshme dhe vazhdon të habisë bashkëkohësit. Në vitin 1525, murgu dikur celibat martohet me ish-murgeshën Katharina von Bora. Së bashku ata lindin gjashtë fëmijë dhe ngrënë famullinë e parë protestante, e cila shërben si model për qendrën shpirtërore dhe organizative të një famullie deri në shekullin e 20-të. Në vitin 1526, Kuvendi Perandorak në Speyer merr vendimin, për t'u lejuar princave dhe shteteve të vendosin vetë, nëse do të mbeten katolikë, apo do të konvertohen. Kjo çon në ndërtimin e kishave të para zyrtare luterane, si dhe shkollave protestante.

Bazat e besimit

Gjatë udhëtimeve të tij, Luteri e kupton se shumica e bashkatdhetarëve të tij, në fakt dinë shumë pak për besimin e krishterë. Kjo e nxit që në vitin 1529 të shkruajë "Katekizmin e Vogël" për njeriun e zakonshëm dhe "Katekizmin e Madh" për priftërinjtë, që së bashku janë vepra udhëzuese themelore, të besimit protestant edhe sot e kësaj dite. Në të njëjtit vit, princët e orientuar nga Reformimi në Kuvendin Perandorak të Speyer protestojnë kundër lënies në fuqi të Urdhërit që e shpallte të jashtëligjshëm Luterin. Veprimet e tyre i japin emrin "protestantizmit". Luteri më parë i referohej lëvizjes së tij si "Evangeliste".

Përpjekja e fundit për bashkim

Në fund të korrikut 1530 perandori Karli V bën thirrje për një Kuvend Perandorak në Augsburg. Perandoria rrezikon të shkatërrohet, pjesërisht

për shkak të ndarjeve fetare që ka sjellë Luteri. Ende fetarisht i ndaluar dhe politikisht i jashtëligjshëm, Luteri nuk mund të marrë pjesë, pa rrezikuar sigurinë e tij. Në vend të tij, shoku dhe bashkëpunëtori i tij fetar Philip Melanchton, e përfaqëson atë në Augsburg. Në seancat e gjata, Melanchton përpiqet të fitojë njohjen e emërtimit protestant nga pala katolike, duke argumentuar për botimin e "Rrëfimit të Augsburgut", që thotë se mësimet protestante bien ndesh me Kishën Katolike. Lufta e tij është e kotë.

Ndikimi i klimës politike

Megjithatë, perandori Karli V nuk mund t'i shtypë protestantët. Ushtria osmane kërcënon si Perëndimin e krishterë, ashtu edhe Perandorinë e Shenjtë Romake, duke bërë atë të varur nga çdo formë ndihme ushtarake. Për të siguruar unitetin e brendshëm, perandori u jep protestanëve lirinë fetare, në këmbim të pjesëmarrjes ushtarake në luftërat kundër otomanëve të Habsburgëve. Megjithatë, konfliktet midis katolikëve dhe protestantëve nuk zgjidhen deri në Paqen e Augsburgut, në vitin 1555.

Bibla e Luterit, një bestseller

Në vitin 1534, Luteri dhe bashkëpunëtorët përfunduan përkthimin e Dhiatës së Vjetër nga hebraishtja në gjermanisht. Gjuha e gjallë dhe e paharrueshme e reformatorit ndihmon edukimin e banorëve të Perandorisë së Shenjtë Romake në shkrim e këndim, si dhe nxit një ndjenjë të unitetit kombëtar. Qindra idioma

dhe thënie nga përkthimi i Biblës së Luterit mbeten të rrënjësura në gjuhën gjermane sot. Por rezultati më i rëndësishëm i përkthimeve të Luterit ishte se ai e bëri të lexuar Biblën, si dhe të arritshme për secilin individ – dhe jo vetëm për klasat e larta të arsimuara. Në dymbëdhjetë vitet e para, Bibla e Luterit e vitit 1534 u shit në më shumë se 100.000 kopje, duke e bërë përkthyesin e saj, publicistin më të qarkulluar të shekullit të 16-të.

Antisemitizmi i Luterit

Mendimi i Luterit mbi hebrenjtë dhe besimet e tyre nuk u ndikua aspak nga dashuria dhe toleranca e krishterë. Në këtë drejtim, ai është mishërim i kohës kur jetoi. Ai fillimisht këshilloi mirësjellje ndaj hebrenjve, duke pasur parasysh se vetë Jezusi u lind i tillë, dhe argumentoi në vitin 1523 se hebrenjtë që konverteshin në krishtërim duhet të lejoheshin të punonin në të gjitha llojet e tregtisë, dhe jo vetëm në huadhënie parash. Urrejtja e plotë e Luterit u zbulua rreth 20 vjet më vonë. Në tekstin e tij të vitit 1543, "Për hebrenjtë dhe lakminë e tyre", ai çoi një hap më tutje urrejtjen mesjetare për hebrenjtë, duke etiketuar ata si "vrasës të Krishtit" dhe duke bërë thirrje për shkatërrimin e sinagogave dhe shtëpive të tyre dhe, në fund, dëbimin e tyre. Disa studiues i quajnë deklaratat e Luterit si "antisemitizëm para-modern". Arsyet pse Luteri ndryshoi mendje mbeten thjesht spekulative. Ndryshimi mund të ketë rrjedhur nga zhgënjimi. Pretendohet se ai shpresonte që hebrenjtë të konvertoheshin në besimin e sapoformuar protestant – gjë që ata nuk e bënë. Cilado qoftë arsyeja, kjo anë e shëmtuar e Luterit mbetet pjesë e trashëgimisë së tij deri më sot.

Vepra e jetës

Kur Martin Luteri vdiq më 18 shkurt 1546 në qytetin e tij të lindjes të Eisleben, ai la pas një punë gjigante. Idetë e Reformimit ishin përhapur në të gjithë hapësirën e krishterë. Ndërsa ishin bekim për disa dhe mallkim për të tjerët, ndryshimet që ai vuri në lëvizje ishin të pandalshme dhe prekën të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe politike. Ato hapën derën për një epokë të re – megjithëse askush në atë kohë nuk mendonte se sa i dhunshëm do të ishte konflikti fetar që do të vinte. Deri në vitin 1999, Kisha Katolike nuk pranoi justifikimin doktrinor të Luterit. Ky ishte një moment historik në dialogun katolik-protestant, pasi që nënkuptonte pranimin e heshtur të besimit të palëkundur të Luterit, se të krishterët janë të shenjtë vetëm nëpërmjet mëshirës së Perëndisë dhe jo nëpërmjet akteve – sado të mëdha mund të jenë ato. (Deutsche Welle)



Fondit arkivor albanologjik tashmë i shtohen 22 tituj të botuar përgjatë viteve 1895-1948, të cilët përbëjnë një ndihmesë jo të vogël për studiuesit shqiptarë në thellimin dhe njohjen e mëtejshme të punës kërkimore shkencore të Antonio Baldaçit në Shqipëri

Biblioteka Kombëtare vazhdon të pasurohet

Dokumente të panjohura të albanologut italian mbi Shqipërinë

Alba ÇOBAJ

Drejtoresha e Institutit Italian të Kulturës, dr. Adriana Frisenna, i dhuroi Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në 150-vjetorin e lindjes së tij disa monografi dhe artikuj shkencorë, të panjohur më parë nga publiku shqiptar. Fondit arkivor albanologjik tashmë i shtohen 22 tituj të botuar përgjatë viteve 1895-1948, të cilët përbëjnë një ndihmesë jo të vogël për studiuesit shqiptarë në thellimin dhe njohjen e mëtejshme të punës kërkimore shkencore të Baldaçit në Shqipëri.


Artikujt shkencorë përfshijnë një gamë të gjerë studimore, duke nisur nga tema thelbësore, të cilat Baldaçi i njihje më së miri, si karakteri gjeografik, morfologjik dhe ekonomik i florës shqiptare, ngritja dhe zhvillimi i industrisë së kultivimit të orizit, industrisë së bimëve mjekësore, kultivimi dhe shfrytëzimi i bimëve karakteristike të vendit, por edhe çështje etno-kulturore si popullsia e Epirit, hartimi i një harte etnografike të rajonit të Ballkanit, marrëdhëniet e ngushta midis dy vendeve fqinje etj.

Njohja e thellë e traditës

Në të gjithë këta artikuj albanologu italian dëshmon edhe një herë njohjen e thellë të traditës, kulturës dhe popullit shqiptar, duke qenë një shkencëtar rigoroz në mbajtjen e të dhënave të hollësishme dhe të detajuara mbi vëzhgimet që kryen. Njëherazi, punimet e tij pasqyrojnë edhe njohjen e studimeve të realizuara më herët nga albanologë dhe studiues të tjerë, një bagazh i thellë dijesh e kulture.

Ndër to, nuk mungojnë polemikat me studiues apo albanologë, siç është edhe polemika me albanologun Martin Urban lidhur me studimin e këtij të fundit mbi Shqipërinë e Jugut. Në këtë artikull, botuar në "Rivista d'Albania" më 1940, Baldaçi analizon hollësisht studimet e albanologëve Martin Urban dhe baronit Franz Nopça, duke vënë në dukje aspekte të artikujve të tyre.

Sipas tij, "punimi i Urbanit synon të plotësojë studimet e hungarezit", dhe duke vlerësuar studimin që albanologu hungarez Nopça ka bërë për Shqipërinë e Veriut, Baldaçi shkruan: "Asnjë tjetër nuk e ka tejkaluar njohjen e tij të thellë, të cilën ai e kishte fituar duke jetuar gjatë midis



shqiptarëve të Veriut, duke arritur pothuajse të asimilojë çdo aspekt, madje edhe sekret, të jetës së tyre".

Sipas Baldaçit, "dallimi midis dy studiuesve është i madh, pasi nëse te Nopça mbizotëron koncepti shkencor dhe objektiv i konsideratave të tij, qëllimi i Urbanit është që të ofrojë vetëm një koncept politik të njëanshëm, që nuk është në një linjë me bashkëkombësit dhe miqtë e tij gjermanë dhe është e nevojshme të pranojmë që ai ka nxituar të paraqesë një çështje të keqkuptuar më shumë se ajo e drejta.

Urban paraqitet kështu si një 'partizan' krejtësisht ndryshe nga kolegët e tij gjermanë, të cilët për vite të tëra i kanë kushtuar mendjen dhe zemrën çështjes shqiptare". Gjatë gjithë artikullit të tij, albanologu italian shpreh vazhdueshëm "admirimin" për shqiptarët, kulturën dhe karakterin e tyre, duke i mbrojtur me forcë.

"Ne, si miq prej mbi gjysmë shekulli me popullin shqiptar dhe që i kemi studiuar shpirtin patriotik dhe zhgënjimet e tmerrshme që kanë pasur në përballjen e tyre me të gjithë propagandën e jashtme politike të Fuqive të Mëdha si dhe vendeve fqinje, duhet të refuzojmë

me forcë kriteret e Urbanit, i cili kërkon që gjeologu me çdo kusht të bëjë historianin, por jo vetëm që i mungon temperamentit, por edhe njohja e duhur dhe e thellë e historisë". Duke vënë theksin në rëndësinë shkencore që kanë të gjitha studimet e kryera në Shqipëri prej studiuesve italianë dhe meritën e tyre në njohjen e vendit, Baldaçi "i kundërvihet" albanologut Martin Urban: "nuk mund të mohohet që opinioni i tij ndikon në vendosjen në një plan më inferior të vëzhgimeve serioze me karakter shkencor të realizuara në Shqipëri".

Shqipëria në revistat italiane


Interesi për të njohur Shqipërinë, por edhe për ta bërë atë të njohur në Europë, gjeti një "dritare" komunikimi të rëndësishme në revistat dhe gazetatat, të cilat në Itali ishin konsoliduar dhe kishin një ndikim të madh të studiuesit dhe publiku. Në fund të shekullit XIX ato shërbyen më së miri për të përcjellë informacionet e para mbi vendin e panjohur, në atë periudhë ende pjesë e Perandorisë Osmane.

Studiues, gazetarë, udhëtarë dhe diplomatë, që kishin përshkuar

Shqipërinë, kujtimet e tyre së pari i publikuan si artikuj në këto revista. Janë një sërë revistash, me një spektër të ndryshëm nga njëra-tjetra, të cilat përcillnin për publikun italian dhe më gjerë të dhëna të rëndësishme shkencore, por edhe përshkruese, mbi aspekte të ndryshme të Shqipërisë, nga historia, kultura, gjuha, tradita dhe zakonet, gjeografia, botanika, arkeologjia, bujqësia dhe ekonomia, jeta sociale, etj. Pjesa më e madhe e këtyre artikujve lidheshin me studimet e zbulimet shkencore të realizuara nga studiuesit italianë në hapësirat ku jetonte popullsia e quajtur shqiptare.

Këto informacione pasqyroheshin në buletinet më të rëndësishme shkencorë, duke shtuar edhe më shumë interesin për Shqipërinë. Për vite me radhë eksplorimi i kësaj toke "të panjohur" u shndërrua në qëllimin kryesor të shkencëtarëve të huaj, mes tyre edhe gjeografi dhe botanisti Antonio Baldaçi. Shkencëtari italian, përgjatë dy shekujve, fundshekulli XIX dhe fillimshekulli XX, ka vizituar, hulumtuar dhe publikuar studime të shumta shkencore mbi Shqipërinë.

Siç kujton edhe miku dhe bashkëpunëtori i tij i ngushtë, gjeografi gjerman



Kurt Hassert, "vëmendja dhe interesi i Baldaçit për Shqipërinë nisi më 1888". Udhëtimi i parë i Antonio Baldaçit, në vitin 1892, drejt një vendi të panjohur si dhe kërkimet shkencore të realizuara gjatë vizitës së tij në Malin e Tomorrit, e shtynë atë të eksploronte dhe të thellonte më tej studimet në trojet shqiptare.

Kujtimet e para ai i botoi në vitin 1893 në një nga revistat shkencore më të zë në Itali, "Bolletino della Societa Botanica Italiana". Ndërkohë, vetëm pak vite më pas, ai fillon të publikojë kujtimet e tij mbi Shqipërisë, "Itinerari albanesi", që është edhe një nga veprat e tij më voluminoze dhe thelbësore. Për herë të parë "Itinerari albanesi" u botua në "Memorie della Societa Geografica Italiana" në vitin 1897.


Këtë vepër themelare e pasojnë "Nel paese del Cem: viaggi di esplorazione nel Montenegro Orientale e sulle Alpi Albanesi" (1903), "Nuovo Stato di Albania" (1913), "Romeni dell'Albania" (1914), "L'Albania" (1929) veprën në 3 vëllime "Studi speciali albanesi" (1932), "Scritti Adriatici" (1943), si dhe një tërësi botimesh e studimesh shkencore e monografi mbi botanikën, hartografinë, historinë, studime sociale, etj. Ekspeditat e tij shkencore të realizuara fillimisht në Mal të Zi, e më pas në Shqipëri dhe Kretë, përgjatë viteve 1885 dhe 1904, kanë krijuar një fond të pasur të vëzhgimeve dhe studimeve të detajuara, që tregojnë punën e tij të jashtëzakonshme si hulumtues skrupuloz, i pasionuar me çdo gjë shqiptare, por njëherazi shfaqin qartazi mendimin e tij për interesin ekonomik, politik dhe ushtarak të qeverisë italiane në zonën e Ballkanit.

Përgjatë këtyre udhëtimeve, Baldaçi jo pak herë

u përball me situata të vështira dhe të rrezikshme, madje nga arrestimi i tij deri në një atentat me armë zjarri, si pasojë jo vetëm e natyrës së egër dhe ende të panjohur të atyre zonave, por edhe të përplasjeve midis fiseve rivale, sidomos në zonat në kufi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi; armiqësia e autoriteteve osmane ndaj të huajve që tentonin të përshkonin territoret shqiptare. Udhëtimi i vitit 1902 në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi konsiderohet edhe si misioni i parë shkencor italian në këtë rajon.

Gjatë ekspeditave të tij, Baldaçi ia doli të mbledhë mbi 100 mijë ekzemplarë bimësh, disa specie të panjohura më parë dhe që kanë marrë edhe emrin e tij. Puna e tij shkencore dhe publikimet e shumta në revistat më të zë kanë ndikuar edhe në njohjen e Shqipërisë. Punën kërkimore shkencore Baldaçi e vazhdoi deri në vitet e fundit të jetës, duke analizuar me shumë kujdes materialet dhe arkivin e tij dokumentar të mbledhur gjatë gjithë qëndrimit dhe ekspeditave të tij në Shqipëri.

Janë rreth 250 monografi dhe artikuj shkencorë që dëshmojnë veprimtarinë e tij të gjerë akademike, një pjesë e konsiderueshme e tyre gjenden në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Megjithatë një nga studiuesit dhe kontribuuesit më të rëndësishëm në fushën e albanologjisë, botanikës dhe shkencës, Antonio Baldaçi dhe vepra e tij voluminoze vijon të mbetet ende e panjohur plotësisht për publikun e gjerë. Ekspozita në nder të 150-vjetorit të tij të lindjes në Bibliotekën Kombëtare synon jo vetëm të nderojë këtë albanolog të çmuar, por edhe të tërheqë vëmendjen e studiuesve të rinj mbi veprën e tij. (Panorama)





Cana, ambasador i Shqipërisë në programin “Grassroots”

Në krah të presidentit Armand Duka, Loriku është shprehur i lumtur dhe entuziast me këtë mision të ri, që në thelb është i ngjashëm me fondacionin e tij

Lorik Cana, ish-kapiteni i kombëtares kuqezi, me më shumë ndeshje se askush tjetër në ekipin tonë përfaqësues, është prezantuar dje në mjediset e FSHF-së si ambasador i Shqipërisë në programin “Grassroots”, që udhëhiqet nga FIFA dhe UEFA. Në krah të presidentit Armand Duka, Loriku është shprehur i lumtur dhe entuziast me këtë mision të ri, që në thelb është i ngjashëm me fondacionin e tij. “Kur jam prezent në ambientet e federatës, ndihem mirë. Këtu jemi si një trup i vetëm, të gjithë bashkë synojmë të punojmë për ngritjen e cilësisë. Gjithsecili mundohet të japë vlerat e veta profesionale. Unë e ndiej për detyrë të kontribuoj në futbollin e vendit tonë. Ne si shoqëri kemi përfitur shumë nga sporti. Vitet e fundit është demonstruar që, nëse punojmë, mund të jemi të suksesshëm. Jemi një vend në zhvillim e sipër dhe futblli ndihmon në këtë pjesë. Unë mendoj që për të pasur një pjesëmarrje të madhe, kjo nuk vjen brenda një dite.

Në vendin tonë nuk e di a kemi pasur më parë, por unë do të vazhdoj të jap stimuj, t'i nxis njerëzit të merren me futboll”, u



shpreh në fillim Cana, “Edhe “Grassroots” është një program për të marrë pjesë në futboll. Unë tani bëj pjesë të veteranët dhe kam vendosur të vazhdoj me projektet e federatës, për t'i bindur dhe nxitur të gjithë të mbajnë frymën e sportit, të futbollit. Nuk do të jetë një detyre e përditshme, por që kërkon një punë të madhe. Rezultatet i presim pas disa vitesh. Duam që të gjithë ish-futbollistët të na ndihmojnë me këtë projekt. Është diçka e vështirë, por kjo e bën dhe më të bukur. Brenda këtij viti do të hapim një degë në Kosovë të fondacionit tim. Vitin tjetër do t'i kërkoj një bashkëpunim edhe Fadil Vokrri në Kosovë. Dëshira ime është të jap kontributin personal në futbollin tonë, në të gjithë vendin

tonë. Kur them vendi ynë, nuk kam parasysh vetëm Shqipërinë, por kombin tonë”, tha në vazhdim ish-kapiteni i Shqipërisë. Ndërkohë, “Grassroots” është futblli i bazës është i gjithë futblli që është joprofesional dhe joelitit. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në futbollin e fëmijëve, shkollat dhe futbollin e të rinjve, futbollin amator, futbollin për lojtarët me aftësi të kufizuara, futbollin për veteranët. Me pak fjalë, baza është futblli i luajtur nga masat në një nivel ku pjesëmarrja dhe dashuria e lojës janë forcat lëvizëse. Futblli sjell përfitime për shoqërinë në tërësi, pasi nuk është vetëm për lojën, por edhe futjen e vlerave, duke përfshirë punën në grup, zhvillimin shoqëror, shëndetin, aftësinë

dhe përbushjen personale. Kjo lojë është një mjet për zhvillimin arsimor, social dhe sportiv dhe si e tillë, UEFA investon shumë në futbollin bazë për të siguruar që të gjithë të kenë mundësinë të përfshihen në lojë, pavarësisht moshës, aftësisë, përkatësisë etnike, racës, fesë apo seksit. Programi bazë i UEFA-s inkurajon federatat kombëtare për të siguruar të ardhmen e lojës. Përmes “Grassroots”, UEFA mbështet dhe stimulon zhvillimin e futbollit bazë në nivel kombëtar, duke vendosur standarde dhe duke ofruar ndihmë të përshtatur. Përveç kësaj, çdo federatë kombëtare merr fonde vjetore të përcaktuara për të zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht aktivitetet e tyre bazë.



Osmani i pakënaqur me lojën e futbollistëve të tij dhe arbitrat

Shkup, 26 tetor – Skuadra e Shkëndijës ka humbur një mundësi tjetër të mirë për tu shpëputur edhe më shumë nga përcjellësi i saj Vardari në garën për titull. Djemtë e trajnerit Qatip Osmani kanë humbur me rezultatit 3:2 në Strumicë nga skuadra e Akademia Pandev, duke mos arritur të shfrytëzojnë humbjen e Vardarit nga Rabotniçki me rezultatit 3:1. Si rezultat i kësaj trajneri Osmani ka mbetur i pakënaqur me qasjen e futbollistëve të tij në fillim të ndeshjes kur u gjetën në negativë prej 2:0, derisa ai kishte edhe vërejtje për arbitrat e takimit. “Na kushtoi shumë hyrja në fillim të ndeshjes, ku deri sa e morën golin nuk luajtëm ashtu si duhesh të luajmë. Lojën e stabilizua vetëm pas golit, kur edhe morëm iniciativën që rezultoi me dy gola të barazimit. Dua të theksoj se në ndeshje të këtylla Federata e Futbollit duhet të delegojë arbitra kualitativ, të cilët ndoshta nuk ndikuan direkt në rezultat, mirëpo në lojë apo mos dija e atyre bëri të veten që na futi në një nervoz, të cilën nuk e dëshironim, veçanërisht në këto ndeshje” deklaroi pas përfundimit të ndeshjes Qatip Osmani. Pas kësaj humbje Shkëndija kryeson me 28 pikë, shtatë më shumë se Akademia Pandev, ndërsa Vardari ka 19 pikë dhe dy ndeshje me pak. Në xhiron e ardhshme kuqezinjët do të përballen me Pobodën në Prilep, derisa Akademia Pandev do të jetë mysafir i Renovës në stadiumin e qytetit në Tetovë. (B.K.)



Komandojnë në Itali



Napoli dhe Lacio fituan mbrëmjen e së mërkurës në dy transfertat tepër të vështira respektivisht ndaj Xhenoas dhe Bolonjës. Thomas Strakosha dhe Elseid Hysaj janë duke kaluar një formë mjaft të mirë në Serinë A italiane, kjo edhe falë ecurisë pozitive të klubeve të tyre në javët e para të kampionatit. Napoli dhe Lacio fituan në dy transfertat tepër të vështira respektivisht ndaj Xhenoas dhe Bolonjës. Kur lamë pas javën e 10-të, Napoli i Hysajt kryeson renditjen me 28 pikë, ndërsa Lacio e Strakoshës ndodhet në vendin e katërt me tre pikë më pak. “Tuttomercatoweb” bëri edhe vlerësimin e lojtarëve për ndeshjet e sotme, ku Hysaj u vlerësua me notën 6 ndërsa Strakosha 6.5.

Urime për futbollistët dhe “Shvercerat”

Shkup, 26 tetor – Alen Jasharovski është heroi i skuadrës së Shkupit. Në përballjen e së mërkurës ndaj Pobodës, sulmuesi shtatlartë në minutën e 85-të të ndeshjes shënoi golin e fitores, duke i sjell kështu skuadrës së tij tre pikë të mëdha. Kjo fitore e ka gëzuar shumë trajnerin Ardian Nuhiu, i cili pas përfundimit të ndeshjes uroj djemtë e tij për paraqitjen dhe fitoren e arritur derisa nuk harroi ti përmend edhe tifozët “Shvercerat” për përkrahjen që ia dhanë gjatë 90-të minutave. “Mendoj që dominoam si pjesën e parë ashtu edhe në të dytën. Kishim shumë raste, mendoj që duhej të fitonim me rezultat më të thellë. Sido që të jetë, i uroj futbollistët e mi të cilët luftuan



si ‘luana’, i uroj për tri pikët dhe të vazhdojnë me këtë rritëm. Dua t'i falënderoj edhe ‘Shvercerat’ të cilët që gjatë gjithë ndeshjes i kanë përkrahur futbollistët dhe ja

më në fund i shpërblyen”, deklaroi Ardian Nuhiu. Ndërkohë, ndeshjen e ardhshme Shkupi do ta luan në arenën “Filipi i dytë” ndaj Rabotniçkit. (B.K.)

Tre shqiptar në botërorin e kik-boksit në Hungari

Shkup, 26 tetor – Më tre nëntor të këtij viti në Budapest të Hungarisë do të mbahet Kampionati Botëror në kik boks. Në këtë eveniment ku pritet të marrin pjesë 1.300 kik-boksierë nga 54 shtete, do të merr pjesë edhe Maqedonia, e cila do të përfaqësohet me nëntë garues nga ku pritet të fitojnë katër deri pesë medalje. Ndryshe, trajneri i përfaqësueses së Maqedonisë Dejan Mitro-

- LISTA E KIK-BOKSIERËVE DHE DISIPLINAT:**
- Hadis Ramadani – Iou kik – 67 kg.
 - Petre Vellkov – K1 – 67 kg.
 - Boban Ilievski – Iou kik – 75 kg.
 - Jetmir Emruli – K1 – 75 kg.
 - Enver Rexhepovski K1 – 81 kg.
 - Miki Ivanovski – K1 – 86 kg.
 - Nenad Manojlovski – Kik lajt – 69 kg.
 - Dimitar Georgiev – Kik lajt – 74 kg.
 - Millan Kubin – Kik lajt – 89 kg.

vski ka ftuar siç thamë nëntë kik-boksierë, në mesin e tyre tre kik-boksier shqiptar, Hadis Ramadani, Enver Rexhepovski dhe Jetmir Emruli. Ramadani do të merr pjesë në Iou-kik në kategorinë -67 kg, ndërsa Emruli në KE -75 kg, derisa Rexhepovski K1 -81 kg. Pikërisht medalje në këtë eveniment pritet të fitojnë kik-boksierët shqiptar si dhe Millan Kubin në kik-lajt -89 kg.





Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPLL

A – leje të integruar ekologjike për Shoqatën
Për riciklimin e letrës dhe mbetjet nga letra
"PEJPAR MILL" SHPK Koçanë

Në përputhje me nenin 95 pika 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë nr. UP1 -11/3 461/2017 nga 30.03.2017 për marrjen e A –lejes të integruar ekologjike, si edhe Procesverbalin i vizitës përfundimtare në instalacion nr. UP1 -11/3 461/2017 nga 12.10. 2017.

Drejtoria e Mjedisit Jetësor pranë MMJPH përgatiti
**A – Leje të integruar ekologjike për Shoqatën
Për riciklimin e letrës dhe mbetjet nga letra
"PEJPAR MILL" SHPK Koçanë**

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:

- T-1: 41°54'49,57"N 22°25'49,25"E
- T-2: 41°54'48,04"N 22°26'06,12"E
- T-3: 41°54'45,33"N 22°26'05,54"E
- T-4: 41°54'46,06"N 22°25'55,71"E
- T-5: 41°54'44,64"N 22°25'55,64"E
- T-6: 41°54'44,84"N 22°25'53,52"E

- T-7: 41°54'43,22"N 22°25'53,05"E
- T-8: 41°54'43,62"N 22°25'51,16"E
- T-9: 41°54'46,21"N 22°25'51,56"E
- T-10: 41°54'46,50"N 22°25'49,00"E

Instalacioni bien nën aktivitetet nga Shtojca 1, Pika 6, Nën-pika 6.1
Reparte industriale për prodhimin e letrës dhe kartonit, me kapacitet prodhues mbi 20t/ditë.
Kapaciteti i projektuar: 40t/ditë.

Lloji i aktivitetit:

Prodhimi i tri llojeve të letrës që përdoren për prodhimin e kutive të letrës

Leja do të jetë e shpallur në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moep.gov.mk

Ankesa kundër vendimit për lejen mund të dorëzohet nga ana e personave juridik dhe fizik, si edhe nga ana e shoqatave të qytetarëve të themeluara për përparimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, deri te Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në procedurën administrative dhe procedurën e marrëdhënies së punës në shkallën e dytë, brenda 15 ditëve nga data e publikimit të Lejes në shtypin ditor.

NBA

Klivelnd humb sërish, fitojnë Hjuston dhe Golden Stejt

Shumë ndeshje dhe surpriza në takimet e luajtura mëngjesin e sotëm në NBA, me Klivelnd që u mund 112-107 nga Bruklin në fushën e këtij të fundit



Konfirmohet starti i vështirë i sezonit për Klivelnd Kavalirs. Në ndeshjen e pestë sezonale nënkampionët e NBA u mposhtën me rezultatin 112-107 në "Barclays Center" nga Bruklin Nets, pavarësisht paraqitjes së zakonshme të LeBron Xhejms, që shënoi 29 pikë, dha 13 asistime dhe kontrollonoi 10 topa nën tabelë. Korver shtoi edhe 22 pikë të tjerë për Kavs, por nuk mjaftoi përballë Netsave, që u shfaqën më skuadër, sidomos në pjesën e dytë, teksa vetëm në pak minuta në çerekun e fundit i lanë avantazhin kundërshtarit. Detroit Pistons kthehet te fitorja pas humbjes me Filadelfian dy ditë më parë. E gjithë meritë e Tobias Harris, që "shtypi" thaujse i vetëm Minnesota Timberwolves, duke shënuar plot 34 pikë në fitoren 122-101 të Pistons. Fitore e vështirë e Golden Stejt Uarriors

ndaj Toronto Raptors në "Oracle Arena", në prani të thaujse 20 mijë spektatorëve. Vetëm tre pikë më shumë realizuan vendasit në këtë sfidë plot rivalitet, kur palët ndryshuan disa herë rolet, duke i marrë kryesimin njëri-tjetrit. Erik Gordon dhe Xhejms Harden, respektivisht me 29 dhe 27 pikë, rezultuan vendimtarë me lojën e tyre në suksesin e ngushtë 104-105 të Hjuston Rokets në parketin e Filadelfia 76ers. Harden ishte gjithashtu autor i 13 asistimeve në një sfidë përgjithësisht të ekuilibruar, ku diferenca maksimale gjatë lojës shkoi +11 pikë për vendasit në periodën e dytë. Për Indiana Pejsers forma e jashtëzakonshme e Oladipo, që realizoi plot 35 pikë ndaj Oklahoma Siti Thunder, nuk mjaftoi për t'i befusuar vendasit, që falë dyshes Uestbruk-Antoni (realizuan nga 28 pikë), fituan 114-96. Në fakt "ylli" i Thunder, përveçse me pikët e shënuara, pati një kontribut të jashtëzakonshëm me 16 asistime dhe 10 rikuperime. Në takimet e tjera Charlotte Hornets fitoi 110-93 me Denver Nugets, Majami Hit iu kthye humbjes në shtëpi 100-117 ndaj San Antonio Spars, Dallas Mavericks – Memfis Grizzlies përfundoi 103-94, Foeniks Sans – Jutah Xhez 97-88, ndërsa Los Anxhelos Lejkers arriti të fitonte vetëm në shtesë ndaj Uashington Uizards 102-99.

Publicitet

ZBRITJE DERI NE **30%**

MICHELIN DUNLOP VIKING SPORTIVA

CENTAR ZA GUMI

NË RRUGEN E PLASTIKAVE PËRBALL MARMARIS.
Kontakt Tel: 070-222-388, 071-263-723 dhe në facebook CentarZaGumiHR



Agjencia për rini dhe sport

KONKURS PËR POETË TË RINJ

Agjencia për rini dhe sport publikon Konkurs për **Poetë të rinj**, në të cilin fton të gjithë të rinjtë të parashtrorinë punimet e tyre autoriale, në pajtim me kriteret e përcaktuara të cilat përmbajnë pikat në vijim:

1. Të jenë të moshës prej 15 deri në 29 vjet
2. Të mos kenë të botuar përmbledhje poezish.
3. Të parashtrorinë më së shumti dy punime poetike.

Konkursi për **Poetë të rinj** realizohet për të katërtën herë, ndërsa ka për qëllim të mbështesë dhe nxisë të rinjtë kreativ.

Në konkurs do të ndahen tri çmime për punimin më të mirë edhe atë për çmimin e parë janë paraparë 20.000 denarë, për çmimin e dytë 15.000 denarë, ndërsa për çmimin e tretë 10.000 denarë.

Agjencia për rini dhe sport inkurajon të gjithë të rinjtë e moshës prej 15 deri 29 vjet, të cilët shkruajnë poezi të parashtrorinë veprat e tyre në konkurs. Të njëjtat do të vlerësohen nga ana e komisionit të përbërë nga anëtarët e Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë. Secili autor do të përfaqësohet në përmbledhjen e cila do të botohet nga fundi i vitit 2017.

Kandidatët veprat e tyre duhet t'i parashtrorinë në zarf të mbyllur në të cilin në këndin e epërm të majtë duhet të qëndrojë shënimi "mos hap", ndërsa në mesë duhet të qëndrojë adresa e saktë e pranuesit. Pjesa e jashtme e zarfit nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë të dërguesit. Në zarfin e mbyllur duhet të ketë edhe dy zarfe të mbyllura dhe të vulosura, prej të cilëve njëri me shënimi "punimet" në të cilin do të gjenden punimet e nënshkruara me shifër, ndërsa në tjetrin duhet të gjendet dokumentacioni për identifikim të dërguesit si dhe shifra.

Adresa në të cilin duhet të dërgohen veprat autoriale është:
Agjencia për rini dhe sport
Sektori të rinjtë
Rr. Maqedonia 38, 1000 Shkup (Pallati "Panko Brashnarov")
Me shënimi "për Konkursin poetët e rinj"
Ose personalisht në arkivin e Agjencisë për rini dhe sport.

Për informacione shtesë të interesuarit mund të drejtohen në e-mail: gordana@ams.gov.mk çdo ditë pune prej ora 8.30 deri në ora 16.30, ose në lokalet e Agjencisë për rini dhe sport, Sektori të rinjtë.

Konkursi zgjatë 30 ditë, duke konsideruar nga dita e publikimit, gjegjësisht deri më **25 nëntor 2017**.



Agjencia për rini dhe sport

KONKURS PËR ARTISTË TË RINJ

Agjencia për rini dhe sport publikon Konkurs për ekspozitën **Young art 2017** në të cilën Agjencia fton të gjithë artistët e rinj dhe grupet vizuale të parashtrorinë veprat e tyre autoriale, në pajtim me kriteret e përcaktuara, të cilat përmbajnë pikat në vijim:

1. Autorët të jenë të moshës prej 15 deri në 29 vjet
2. Veprat e parashtrorinë të jenë nga disiplina në vijim:

- ~ Piktura (me dimensionet jo më të mëdha se 200x200 cm)
- ~ Skulptura (me dimensionet jo më të mëdha se 200x200x200 cm)
- ~ Grafika (me dimensionet jo më të mëdha se 100x70)
- ~ Dizajn grafik (afishe)
- ~ Fotografia (me dimensionet jo më të mëdha se 100x70 cm)

3. Veprat duhet të korrespondojnë me praktikën bashkëkohore të artit figurativ, ndërsa përmbajtjet tematike dhe ideore janë të hapura dhe kanë të bëjnë me krijimtarinë individuale recensuese të autorëve të dy viteve të fundit. Veprat duhet të kenë nënshkrim pasqyruar, individual, figurativ dhe kreativ.

Ekspozita për herë të katërt do të realizohet këtë vit, ndërsa ka për qëllim të mbështesë dhe stimulojë të rinjtë në produksion të krijimtarisë së artit figurativ bashkëkohor, por të bëjë edhe mesatare të produksionit të artit figurativ bashkëkohor të gjeneratës më të re të artistëve vizual.

Agjencia për rini dhe sport inkurajon të gjithë autorët e rinj dhe grupet të moshës prej 15 deri në 29 vjet, të parashtrorinë veprat e tyre në konkurs. Secili kandidat merr pjesë me nga një vepër. Ekspozita është selektive, ndërsa juria do të ndajë nga një çmim për arritje artistike për të pesë disiplinat, në shumë prej 40,000 denarë.

Ekspozita **Young art 2017** do të hapet pas përfundimit të konkursit.

Secili autorë veprën e vet duhet ta parashtrorinë të pajisur në mënyrë përkatëse (në mënyrë pa u vërejtur nënshkrimi i tij) së bashku me zarfin të bashkangjitur ku do të ketë të dhënat e autorit dhe veprës, ndërsa në këndin e epërm të majtë duhet të qëndrojë shënimi "mos hap", në mes të shënohet adresa e saktë e pranuesit.

Pjesa e jashtme e zarfit nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë për dërguesin.

Adresa në të cilin duhet të dërgohen veprat autoriale është:
Agjencia për rini dhe sport
Sektori të rinjtë
Rr. Maqedonia 38, (Pallati "Panko Brashnarov") 1000 Shkup
Me shënimi "për Konkursin artistë të rinj"
Ose personalisht në arkivin e Agjencisë për rini dhe sport.

Për informacione shtesë të interesuarit mund të drejtohen në e-mail: gordana@ams.gov.mk ose nasuf@ams.gov.mk çdo ditë pune prej ora 8.30 deri në ora 16.30, ose në lokalet e Agjencisë për rini dhe sport, Sektori të rinjtë.

Afati për parashtrimin e veprave është 30 ditë, duke konsideruar nga dita e publikimit të konkursit, gjegjësisht deri më **25 nëntor 2017**.



ME REALIN FITOHET GJITHÇKA

Kristiano Ronaldo u kurorëzua lojtari më i mirë i vitit nga FIFA për të dytin vit radhazi në Londër dhe portugezi lëshoi intervistën tradicionale për FIFA-n një ditë më pas.

Kristiano, ky është sezoni i dytë që ju triumfoi në "The Best FIFA Football Awards". Si ndiheni?

- Është një vlerësim i mrekullueshëm. Dua të falënderoj shokët e skuadrës. Është një gjurmë në karrierën time, një moment që përfshin emocione të mëdha.

Kjo është hera e pestë që ju shpallenit futbollisti më i mirë në botë (bashkë me formatin kur ishte i shkrirë me "Topin e Artë"). A ju vendos kjo mes lojtarëve më të mirë në historinë e futbollit?

- Jam i lumtur që e kam fituar këtë çmim,

por ajo që unë dëshiroja fillimisht ishte që të isha i suksesshëm në karrierën time si futbollist dhe mendoj se e kam arritur këtë. Sigurisht që fitimi i trofeve dhe të qenit një prej lojtarëve që ka fituar më shumë trofe individualë në histori është një burim i madh krenarie. Është një moment i paharrueshëm në jetën time dhe më motivon për të vazhduar të luaj në nivelin më të lartë.

Dhe të vazhdoni të ngrini trofe me Realin?

- Sigurisht. Botërori i Klubeve është në prag dhe ai është një trofe që duam ta fitojmë. Kemi fituar Superkupën e Evropës dhe të Spanjës kundër Mançester Junajted dhe Barcelonës. Te Real i ke shansin për të fituar gjithçka.

Për më tepër, kohët e fundit keni nisur të arrini gjëra të mëdha edhe me Portugalinë.

- Po. Fitorja në Evropianin e 2016-ës ishte shumë e rëndësishme. Sigurisht që një trofe me kombëtaren ishte diçka që më mungonte dhe falë Zotit arritëm ta fitojmë një. Ky vit ka qenë gjithashtu pozitiv. Kualifikueset ishin pak të ndërlikuara, por në fund gjithçka shkoi mirë. Të gjithë, lojtarët, trajneri dhe stafi e dinin që duhet t'u qaseshin eliminatorëve me seriozitetin më të madh dhe ne ia dolëm të kualifikoheshim në Botëror pasi fituam ndeshjen e fundit kundër Zvicrës.

Le të flasim pak për Rusinë, një vend që e keni vizituar më herët këtë vit gjatë Kupës së Konfederatave.

- Kam luajtur shumë herë atje. Kam fituar Çampionsin dhe është një vend që më ka sjellë fat. Nuk ndodhi kështu herën e fundit me Portugalinë, por edhe Kupa e Konfed-

Sigurisht. Botërori i Klubeve është në prag dhe ai është një trofe që duam ta fitojmë. Kemi fituar Superkupën e Evropës dhe të Spanjës kundër Mançester Junajted dhe Barcelonës. Te Real i ke shansin për të fituar gjithçka.



Kulibali në "radarët" e Barcelonës

Barcelona po planifikon t'i rrembejë Napolit mbrojtësin senegalez Kalidou Kulibali. E përditshmja "Sport", një media shumë pranë klubit katalanas, në shkrimin kryesor të ditës së sotme zbulon se drejtuesit e "blaugranave", në fakt, po kërkojnë dy qendërmbrojtës, por më kryesor mbetet 26-vjaci që po shkëlqen nën urdhrat e Sarrit. Te Barcelona e kanë të qartë se për ta shkëputur futbollistin nga

Seria A duhet të shpenzojnë mbi 50 milionë euro. Kulibali ka rinovuar kontratën me napolitanët deri në vitin 2021, por në marrëveshje nuk është përcaktuar asnjë klauzolë largimi. Emra të tjerë për mbrojtjen e Barcës janë Zagadou i Borussia të Dortmundit dhe Diakhaby i Lionit, të cilët më shumë se përforsime të momentit konsiderohen investime për të ardhmen, pasi janë vetëm 18 dhe 20 vjeç.

Paue zyrtarisht trajner i ri i Leicester Sitit



Klod Paue është zyrtarisht trajner i Leicester Sitit në Premier Ligë. Klubi anglez, nëpërmjet një njoftimi për shtyp, zyrtarizoi në krye të "dhelprave" trajnerin francez, i cili vitin e kaluar ka drejtuar Sautemptonin. 56-vjeçari do ta marrë menjëherë detyrën, teksa do të debutojë të dielën, në transfertë me Evertonin. Para se të niste eksperiencën në Angli. Paue ka drejtuar emra të rëndësishëm të futbollit francez si: Monaco, Lill, Lion dhe Nica.

Klubi i Leicesterit njofton gjithashtu se Mihael Apoleon do të vazhdojë ta mbajë pozicionin e ndihmëstrajnerit. "Është privilegj i madh për mua detyra si trajner i Leicester Sitit, skuadër, ambiciet e së cilës janë edhe të miat. Jam i ekzaltuar nga fakti që më duhet punoj në një klub që vetëm pak kohë më parë ka fituar titullin në Premier Ligë por që synon të arrijë suksese të mëtejshme në këtë nivel", deklaroi Paue pas marrjes së detyrës së re.



Në Itali më e vështirë se në Gjermani

Rikardo Rodriguez ishte një nga afrimet e shumta të Milanit, gjatë merkatos së verës. Mbrojtësi zviceran erdhi nga Wolfsburgu, për t'iu bashkuar projektit të Montellës, ndërsa ka gjetur edhe një fanellë titullari te kuqezinjët. Fillimi i tij te Milani ishte premtues, por penalltia e shkaktuar në derbi, në minutat shtesë, duket se ua ka prishur humorin tifozëve kuqezinj. Rodriguez ka folur

për aventurën e tij italiane, teksa ka zbuluar se ka qenë pranë transferimit në pjesën tjetër të Milanos, atë zikaltër, por edhe ka pranuar se të luash në Itali është shumë më e vështirë se në Gjermani. "Prej më tepër se një viti Inter kishte bërë hapa konkretë drejt transferimit tim, por në fund erdhi Milani dhe jam i lumtur që jam pjesë e kuqezinjve. Nuk e kemi nisur aspak mirë se-

zonin, por kam besim se do t'ia dalim. Është thjesht çështje kohe, sepse ne e njihim shumë pak njëri-tjetrin dhe për më tepër disa prej nesh nuk e njihim as Serinë A më përpara. Më duhet ta pranoj se këtu është shumë më e vështirë se në Gjermani, sepse sfida përgatiten në detaje dhe është shumë e vështirë të gesh hapësira", tha mbrojtësi zviceran i Milanit.



Nuk është e vërtetë që pa Bonuçin luajmë më mirë. Secili prej nesh ka përgjegjësitë e tij dhe në këto orë kanë dalë gjëra të pavërteta. Shpresoj që Juventusit të na nënvlerësojë. Tani dua të shikoj këtë sjellje edhe në "San Siro" kundër Zonjës së Vjetër"

Guardiola fajësoi topin se ishte i lehtë Panuçi çorapet

Dhjetë justifikimet më qesharake në futboll

Duke marrë shkas nga kjo deklaratë, sajti britanik "Daily Mail" listoi 10 justifikimet më qesharake në futboll, ku mes tyre ishte dhe ankesa e çuditshme e trajnerit të Kombëtares shqiptare Kristian Panuçi, i cili u ankua për çorapet në Evropianin e vitit 2014, pas barazimit pa gola të Italisë ndaj Danimarkës



Trajneri i Manchester Siti, Pep Guardiola u justifikua mbrëmjen e djeshme se skuadra e tij nuk gjeti dot golin, për shkak se topat ishin të lehtë dhe kjo ishte e papranueshme për një kompeticion të nivelit të lartë. Duke marrë shkas nga kjo deklaratë, sajti britanik "Daily Mail" listoi 10 justifikimet më qesharake në futboll, ku mes tyre ishte dhe ankesa e çuditshme e trajnerit të Kombëtares shqiptare Kristian Panuçi, i cili u ankua për çorapet në Evropianin e vitit 2014, pas barazimit pa gola të Italisë ndaj Danimarkës.

1. Çorapet e ashpra

Thonë që një punëtor i mirë asnjëherë nuk fajëson mjetet e tij por kjo është diçka që nuk vlen për futbollistët, dhe sidomos për trajnerin aktual të përfaqësueses shqiptare Kristian Panuçi. Pas barazimit pa gola të Italisë ndaj Danimarkës në ndeshjen hapëse të Euro 2004, Panuçi fajësoi çorapet. "Kisha plagë në thembër pas ndeshjes," shprehet Panuçi. "Materiali me të cilin janë prod-

huar këto çorape është shumë i ashpër." Por shoku i ekipit Gatusso nuk e pëlqeu aspak këtë justifikim. "Mos më bëj të qesh me këto idiotësiat e çorapeve. Kenianët vrapojnë qindra kilometra zbatuar".

2. "Tekken II" dhe "Tomb Raider"

Pas tre gabimeve të tij i kushtuan goxha Liverpoolit ndaj Njukasëll në 1997, Dejvid Xhejms gjeti një justifikim tepër qesharak. Xhejms citoi varësinë ndaj lojërave kompjuterike si arsye e paraqitjes skandaloze ndaj Njukasëll, duke thënë se kalonte shumë kohë duke luajtur "PlayStation". "Jam shpërqendruar duke luajtur 'Tekken II' dhe 'Tomb Raider' për orë të tëra," shprehet Xhejms. Fatkeqësisht ky justifikim nuk mjaftonte për Xhejms dhe ai u la jashtë Kupës së Botës në Francë 1998.

3. Heqja e statujës së Majkëll Xheksonit

Kur Shahid Khan mori drejtimin e Fulham një nga vendimet e tij të para ishte të zhvendoste statu-

jën e panevojshme të Majkëll Xhekson që ishte vendosur nga ish-pronari Mohamed Al-Fajed jashtë stadiumit. Por, pas një sezoni zhgënjyes, Al-Fayed, i cili ishte një mik i ngushtë i Xhekson dhe madje e kishte ftuar të shikonte një ndeshje në "Craven Cottage", e dinte përse kishte ndodhur. "Statuja sillte fat dhe ne e hoqëm fatin nga klubi dhe tani duhet të paguajmë çmimin. U habita kur Khan më tha se donte ta hiqte. Dhe tani ai ka paguar çmimin duke rënë nga kategoria. Më telefonoi duke më thënë se donte ta rivendoste statujën. I thashë 'në asnjë mënyrë'".

4. Mungesa e kapësve të topave

Hoze Mourinjo është mjeshtri i devijimit të vëmendjes nga paraqitja e skuadrës së tij pas një rezultati negativ dhe justifikimet janë nga më të ndryshmet. Por në 2011, kur një gol në fund të takimit nga Lionel Messi i dha trofeun Barcelonas në Superkupën spanjolle ndaj Real Madridit, trajneri portugez shpiku një justifikim tepër original.

"Ajo që po them nuk është një kritikë, por një fakt. Nuk kishte kapës topash në pjesën e dytë", u shprehe Murinjo. "Kjo është diçka tipik e skuadrave të vogla që kanë vështirësi," shton ai në referencë për ekipin që ka mesatarisht 80,000 tifozë në ndeshjet brenda.

5. Ngjyrat përreth fushës

Forma e dobët e Uest Hemit është e mirë-dokumentuar tashmë pasi kanë ndryshuar stadium. Rezultatet e këqija janë justifikuar me praninë e tifozëve shumë larg fushës, apo çështje ambientimi. Por tani Biliç ka deklaruar se duhet të ndryshohet ngjyra që rrethon fushë, pasi lojtarët e kanë të vështirë të dallojnë limitet e saj. "Nuk është e lehtë për një lojtar që të shohë mirë fushën kur edhe përtej saj vazhdon e njëjta ngjyrë. Është diçka që ndikon psikologjikisht te lojtarët".

6. Fanellat e dyta ngjyrë gri

Kur Manchester Junajted ishte në disavantazh 3-0 ndaj Soutemptonit pas pushimit të pjesës së parë

në prill të 1996, Sër Aleks Ferguson fajësoi fanellat e dytë të skuadrës së tij që ishin ngjyrë gri. Gjatë pushimit Ferguson kërkoi që Junajted të ndryshonte fanellë dhe ashtu ndodhi. "Lojtarëve nuk u pëlqen fanella gri. Ata e kanë të vështirë të dallojnë njëri-tjetrin. Na duhej të ndryshonim fanellat". Skuadra e tij humbi gjithsesi, megjithëse paraqitja e lojtarëve të tij u përmirësua, me Rajan Gigs që shënoi golin e nderit për "Djajtë" me ndeshjen që përfundoi 3-1.

7. Topat ishin të lehtë

Volves u bë ekipi i parë që mban rrjetën të paprekur këtë sezon ndaj Manchester Sittit teksa kryesuesit e Championship kanë blinduar portën për 120 minuta përpara se të humbin me penalti. Por Guardiola nuk i thuri elozhe mbrojtjes kundërshtare, duke fajësuar topat e përdorur. "Topi ishte i papranueshëm për një kompeticion të nivelit të lartë," shprehet Pep pas ndeshjes. "Ishte shumë i lehtë, lëvizte kudo në fushë. Nuk ishte një top i mirë. Ishte pamundur të shënoje me atë top. "Nuk po justifikohem. Por të gjithë lojtarët më thanë që ishte i papranueshëm. Më vjen keq, por nuk është një top serioz për një kompeticion serioz."

8. Top me gunga

Mbrëmja e së martës nuk ishte e vetmja herë që një trajner fajëson topin për një rezultat zhgënjyes. Por teksta topi ishte shumë i lehtë për të besuarit e Guardiolas ndaj Volves, Keni Daglish i Njukasëll e

ka cilësuar si të pakontrollueshëm kur përplasej në tokë ndaj Stevenage në FA Cup të vitit 1998. Gjithsesi Njukastell e ktheu rezultatin negativ një javë më vonë dhe me sa duket topat do të kenë qenë në rregull.

9. Bretkosat bëjnë shumë zhurmë

Në Kupën e Botës 2006, sulmi i frikshëm spanjoll bëri me makthe Ukrainën tek La Roja shënoi katër herë në fitoren e thjeshtë të fazës së grupeve. Në mbrojtje të paraqitjes së dobët të skuadrës së tij, qendërmbrojtësi ukrainas Vladislav Vasçuk i vuri fajin mungesës së gjumit një natë më parë për shkak të bretkosave që kishin bërë shumë zhurmë jashtë hotelit. "Jashtë hotelit ka edhe shumë zogj," është shprehur një zëdhënës i hotelit. "Sipas jush duhet të dalim t'i kapim të gjithë në mëngjes që të mos bëjnë zhurmë?"

10. Gjenet skoceze

Trajneri i Skocisë Gordon Strahan është sjellë si një Çarls Dauin i vërtetë kur detyrohet të shpjegojë dështimin e vendit të tij për t'u kualifikuar në Kupën e Botës që zhvillohet verën tjetër në Rusi. "Jemi mbrapa gjenetikisht," është shprehur Strahan pasi barazimit 2-2 ndaj Sllovenisë që i dha fund shpresave të skocezëve për të shkuar në Rusi. "Gjenetikisht ne duhet të punojmë për të përmirësuar gjendjen, mbase duhet të bashkojmë femrat dhe meshkuj të gjatë dhe të fortë dhe të shohim se ç'do të ndodhë".

Klubet anglezë dëshirojnë shumicën e parave nga të ardhurat televizive



Klubet e mëdha të Ligës Premier kanë propozuar që ndarja e barabartë e parave të fituara nga të drejtat televizive jashtë shtetit, duhet të ndryshojë. Ndërkaq, ky propozim nuk ka marrë mbështetjen e shumicës së klubeve të Ligës Premier. Gjashtë klubet më të pasura, Çellsit, Manchester Siti, Manchester Junajted, Totenhem, Arsenal dhe Liverpool, dëshirojnë që të përfitojnë më shumë nga transmetimi i të drejtave televizive, por që kërkesa e tyre nuk ka gjetur kompromis tek klubet angleze. Gjashtë klubet kërkuar që të braktiset ndarja e parave

në mënyrë të barabartë, ndërsa kanë kërkuar që 35 për qind e të hyrave nga transmetimi i TV-ve, t'u takojë atyre. "Është bërë e qartë se aktualisht nuk ka konsensus për ndryshim, që do të thotë se takimi i nesërm i klubeve nuk është i nevojshëm", ka njoftuar Liga Premier. Klubet në Ligën Premier i ndajnë paratë në mënyrë të barabartë dhe kjo bën që disa klube të vogla të përfitojnë shumë të mëdha. Madje shumica e klubeve nga përfitimet televizive në Ligën Premier ua kalojnë edhe tyreve të mëdha në Serie A dhe Bundesligë.



S'e braktisi ndeshjen edhe pas dëmtimit në vetull

Hose María Gimenez fitoi lavdërimet e fansave të "roji-blancos" për guximin e treguar në ndeshjen kundër Elçes, në "Copa del Rey". Qendra e bardhekuqe luajti deri në minutën e fundit të ndeshjes me një fashë të madhe, për të mbuluar një të çarë të vetull, që ndodhi gjatë një përplasjeje të pavullneshme me Sori, në minutën e 68-të. Uruguaiani tregoi pas takimit, në rrjetet sociale, çarjen e thellë, që prodhoi hemorragjinë dhe fashën e tij të mëvonshme. "Vetëm një prerje e vogël, unë jam mirë", - shkroi Gimenez në një fotografi të varur në "Instagram".

Raiola rrëfen vështirësitë e Lukikut si "futbollist i zi"

Mino Raiola dha një intervistë për suedezin "Expressen", në të cilën zbuloi episodet e racizmit që ka jetuar në futboll, që kur ishte i vogël, Romelu Lukaku. "Njerëzit thonë se nuk ka diskriminim, por lojtarët e zinj gjithmonë kanë një trajtim të tillë", - tha ai. Raiola tregon për anekdotat që duhej të jetonin Lukaku dhe nëna e tij në fillimet e tij në fushën e lojës. "Futbolli është

sporti më demokratik i të gjithëve, sepse duhet të jetë i njëjtë për të gjithë. Njerëzit thonë se nuk ka diskriminim, por lojtarët e zinj gjithmonë kanë një trajtim ndryshe. Lojtarët e zinj, gjithmonë janë vënë mënjanë.

Për Lukakun ka qenë gjithmonë një problem. Mos harroni se nëna e tij më tha se kam për të shkuar në ndeshje me certifikatën e lindjes.

Prindërit e lojtarëve të tjerë nuk besonin se ai kishte 12 apo 14 vite mbi supe, kjo ka qenë gjithmonë një problem, sidomos kur shënoi tre, ose katër gola. Ai ishte i madh dhe i fortë fizikisht, çka bëri që bashkëlojtarët ta konsideronin atë më të vjetër, që nuk ka lindur në Belgjikë etj. Në këtë situatë paragjykimi, nëna e tij u detyrua të tregojë certifikatën e lindjes", - deklaroi Raiola.



DASHI (20/III-20/IV)



Ende jeni të fokusuar për të ardhmen tuaj! Ndoshta, keni disa qëllime në mendjen tuaj, apo ndoshta ju vetëm dëshironi që të shtyni disa gjëra më përpara. Kjo mund të ndodh, por duhet të keni kujdes!

DEMI (21/IV-20/V)



Natyra e juaj konservative që do ju drejtoj në drejtimin e duhur – edhe pse kjo nuk ka të bëjë asgjë me politikën! Duhet që t'i shikoni më sy pozitiv ndryshimet e reja edhe pse po frikësoheni se ato do të ecin ngadalë!

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Zakonisht po ndryshoni mendje shumë por nëse bëni kështu sot atëherë do të jetë e pakuptimtë! Ju nuk jeni edhe të pavendosur por disa lajme të reja do vazhdojnë që t'ia ndryshojnë opinionet e juaja!

GAFORRIA (21/VI-22/VII)



Paratë sjellin probleme sidomos gjatë kësaj dite – por në të vërtetë ju nuk jeni fajtor! Ju ende do të përballeni me disa konsekuenca të cilët do ju sjellin në një nivel mesatar gjatë ditës. Ngadalë sepse gjërat do të përmirësohen së shpejti.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Duhet që të ushtroni që të bëni disa kufizime në shpenzime! Pak qetësi po ashtu ju nevojitet! Është njëra nga ato ditë ku ju do të përballeni me një problem bukur të madh!

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Keni gjetur një metodë interesante për të organizuar jetën tuaj. Këtë e bëni qoftë në kuzhinë, kompjuter apo diku në shtëpi. Vazhdoni kështu dhe sigurohuni që të merrni këshilla edhe nga ndonjë ekspert!

PESHORJA (23/IX-22/X)



Jeni në mes të arritjes të një marrëveshje edhe pse nuk keni parë rezultate deri me sot! Një lidhje e fort është krijuar duke falënderuar shkëmbimin e interesave apo realitetit por ka ardhur koha që të përballeni më të!

AKREPI (22/X-21/XII)



Skepticizmi i juaj nuk do të vije në shprehje sot! Kështu që parapërgatituni që të përqaftoni diçka për të cilën ndiheni të qet! Është një ditë e mirë për të bërë parashikime!

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Duhet që të përballeni me disa ide të reja! Flisni para se këtë ta bëjnë shokët dhe kolegët e juaj por sigurohuni që edhe ata t'ju këshillojnë ju. Debat është i mirë sidomos gjatë ditës së sotme!

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Keni kujdes nga mendimet e të tjerëve sot. Veçanërisht nga ata të cilët thonë se po flasin të vërtetën! Skepticizmi i juaj i lindur mund t'ju shpëtoj juve nga më e keqja por çfarë mund të ndodh më të tjerët e familjes?

UJORI (20/I-19/II)



Është pothuajse një ditë perfekte për të mbajtur atmosferën në nivel sidomos në vendin e punës! Keni ide të mirë – realizoni ato dhe për këtë nuk keni nevojë për ndonjë pushim!

PESHQIT (20/II-19/III)



Duhet që të bëni ndryshime në mënyrën tuaj të jetesës. Normalisht, edhe pse keni paksa negativitet në dukje prapë duhet që të jeni më e gëzuar në pamje. Është një ditë e mirë për të praktikuar durimin!



NE KETE DATE

Mensur Mamuti	VIRTUOZI ITALIAN NE FOTO	BANORI I SHBA-VE	VENDLINDIA E KOMPOZITORIT NE FOTO	BEBEZA E SYRIT, IRIDA
PIKTORI YNE, BAKALLI				
ISH POLITIKANI, SELMANI				
KËNGËTARI AMERIKAN, ROXHERS				
PERSONIFIKIM I FATIT TE KEQ TE GREKET				
M				
HISTORIANI I ROMES SE LASHTE, TIT				
NUESIA E VJETER E PESHES				E NDREQ, E EMREMETON
PASKALI			SPANJA	
QENGI I BUTE			STEME	

KOHA	R	MUSKULI I PARAKRAHUT	KOMIKU ANGLEZ, ATKINSON	QYTET NE GJERMANI	MËNYRË SJELLJEJE (HUAJ)
ART PIKTURIMI NE UJE					ZBARDHJA E DITES MBRETI ASIRIAN, SIN
INSTRUMENTI I AUTORIT NE FOTO					
VEPER E AUTORIT NE FOTO (ZILIA), (ORIGJ)					BERNARDIN PALAJ LAKOHET, PERKULET
L					
PJESË E LIGJIT				INFEKSION GJENITAL, GONOREA RENIUMI	
INTERNET PROTOCOL			RADIUMI TEMPO		KAPITENI I ZHYLVERNIT KALIUMI
AKTOR AMERIKAN I FILMAVE PAZE					
B					

ZGJIDHJET: NAXHI, IMER, KENI, MOROS, LIVI, OKA, PA, E, R, MANER, EBRU, AGIMI, VIOLINA, BR, LA CAMPANELA, NEN, TRIPER, IP, RA, NEMO, BASTER KITËN.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

	8		1		2															
3					4	8														
1					6		8													6
5	1																		4	
	9	3						5	2											5
7									1	3										2
			5		1						8									1
					4	8						9								6
					5			9		3										

Shumë i lehtë: 687192345, 359748162, 124365897, 512936784, 493871526, 768254913, 945613278, 231487659, 876529431. Mesatar: 436189527, 827635914, 519472386, 275863149, 364291875, 981547632, 698324751, 752918463, 143756298.



Këndon në automobil, dënohet me 150 dollarë

Policia në Montreal të Kanadasë ka dënuar një vozitës, pasi që sipas tyre, kishte kënduar me zë të lartë gjatë vozitjes. Sipas CTV News Montreal, Taoufik Moalla derisa po këndonte kishte dëgjuar sirenën e policisë prapa tij. Kur ka ndaluar automjetin, i janë afruar katër policë, të cilët e kanë pyetur nëse ai ka bërë turr derisa ishte duke vozitur. Taoufik është përgjigjur se



vetëm po këndonte këngët nga radio, pas të cilës njëri nga policët i kërkoi dokumentet dhe e dënoi me 149 dollarë për shkak se kishte "bërë turr në automobil".

Trangujt, ilaçi i ri i Alzheimerit



Një vaksinë e bazuar në tranguj, raportohet se mbron njerëzit nga sëmundja e Alzheimerit. Përveç sëmundjes së Alzheimerit, kjo vaksinë mund të jetë kurë ndaj alergjive ndaj maces po ashtu. Trangujt kanë funksion anti-inflamator dhe kanë rol të rëndësishëm në shëndetin e trurit. Në mënyrë që të ta përmirësoni memorien dhe t'i mbron qelizat e trurit nga plakja, konsumoni tranguj. Shkencëtarët madje përshëndetën rezultatet e hulumtimeve të tyre si një zbulim i madh që mund të çonte në shërim të "qindra mijëra njerëz të prekur nga sëmundjet kronike".

Djali i kinezit më të pasur i bleu qenit tetë iPhone të rinj

Wang Sicong, djali i kinezit më të pasur, miliardarit Wang Jianlin i ka blerë qenit të tij tetë iPhone 8 një ditë pasi linja më e re e telefonave u lëshua në përdorim.

Kompania Apple para disa ditëve lëshoi në përdorim iPhone-t e rinj të cilët kushtojnë 6.988 yuan, gjegjësisht 1.050 dollarë amerikan. Sin-



cong tërhoqi vëmendjen e opinionit pasi në rrjetet sociale publikoi një foto të kafshës së tij shtëpiake, Coco, me tetë iPhone 8. Wang vitin e kaluar tërhoi opinionin kinez kur publikoi fotografinë në të cilën Coco mban dy orë më të reja të Apple në vlerë prej 37.000 dollarë, si dhe me shtatë iPhone 7.

KALENDARI HISTORIK 27 TETOR

- 312 - Konstantini i Madh thuhet të ketë pranuar Vegimin e tij të njohur në lidhje me Kryqin.
- 1492 - Kristofor Kolombo zbulon Kubën.
- 1523 - Trupat angleze okupojnë Montalidier Francë.
- 1644 - Beteja e dytë e Njuberit: Mbreti Çarls I mund ushtritë parlamentare.
- 1676 - Polonia dhe Turqia nënshkruajnë marrëveshje të paqes në Varshavë.
- 1682 - Themelohet qyteti i Filadelfisë në Pensilvani.
- 1806 - Ushtria franceze futet në Berlin.
- 1867 - Garibaldi marshon në Romë.
- 1913 - Presidenti Uilson thotë se SHBA asnjëherë nuk do të sulmojë asnjë shtet.
- 1941 - Nazistët formojnë geton e jevgjeve në Beograd.
- 1944 - Tito arrinë në Beogradin e lirë.
- 1971 - Republika e Kongo-Kinshasa do të quhet Republika e Zairit
- 1982 - Kina shpallë se popullsia e saj ka aritur në 1 miliard banorë.
- 2005 - Fillojnë protestat në Paris pas vdekjes së dy tinxherëve mysliman.

A E DINI SE...



Paris është qyteti më elegant në botë sipas një vlerësimi të bërë nga aplikacioni Zalando. Kryeqyteti francez renditet në krye të 100 vendeve më të kulturuar me Londrën që ka qenë gjithmonë në krye të vendeve më me stil. Në renditje janë vlerësuar disa faktorë si bukuria arkitekturore si dhe nga vendasit, ata që punonin dhe vizitorë, pastërtia, kultura dhe stili janë vlerësuar nga një grup ekspertësh, arkitektësh etj. Përveç Nju Jorkut, çdo qytet tjetër në dhjetëshe ka qenë në Evropë me Italinë që ka katër prej tyre dhe Franca dy, Parisin dhe Bordonë. Vjena vjen e treta dhe Barcelona e gjashta.



BARSOLETA



PLAKU DHE TAKSISTI

Njëherë një plak i cili i kishte dy valixhe të rënda në dorë, shkon e pyet një taksist se sa kushtonte për ta dërguar atë deri në vendin e caktuar!

Taksisti i thotë: 10 euro.

Plaku: Po valixhet?!

Taksisti: Valixhet janë pa pagesë.

Plaku ia kthen: Mirë, merri t'i valixhet se unë vij në këmbë!"

THËNIA E DITËS

Gjyshi im thoshte se për të ndryshuar botën mjafton pak, tre gjëra: të edukosh mirë fëmijët, të jesh i ndershëm, e nëse është e mundur, kur na ndodh, të ndihmojmë dikë që ka nevojë. Kjo është e gjitha. (Lorenzo Licalzi)

